
**INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP**

**DASMA NË TREVAT
SHQIPTARE**

(Konferencë shkencore – 03.05.2019, Shkup)

26



Shkup, 2019

Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Vëllimi 26 – 2019
Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Prof. dr. Skender Asani

Kryeredaktor:
Prof. dr. Sefer Tahiri

Këshilli redaktues:
Prof. dr. Skender Asani
Prof. dr. Izaim Murtezani
Prof. dr. Sevdail Demiri
Doc. dr. Hidajete Azizi
Mr.sc. Rini Useini
Mr.sc. Besnik Rameti
Mr.sc. Isamet Bakiu

Copyright©ITSHKSH, 2019
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN: 978-608-4653-97-4

www.itsh.edu.mk

Ky botim financohet nga:



**INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP**

**DASMA NË TREVAT
SHQIPTARE**

(Konferencë shkencore – 03.05.2019)

26

SCUPI
Shkup, 2019

TRYEZA E LËNDËS:

Tryeza e lëndës:.....	5
Hyrje	7
Dr. Izaim MURTEZANI	11
SIMBOLIKA E PJELLORISË.....	11
Dr. Bukurije MUSTAFA.....	33
DISA ELEMENTE KANUNORE DHE ETNOLEKSEMA TË DASMËS	33
Dr. Vebi BEXHETI.....	42
DASMA NË VESHALLË TË TETOVËS.....	42
Dr. Nebi Dervishi	56
DASMAT STRUGANE DIKUR DHE SOT	56
Dr. Mustafa Ibrahimii.....	75
KËNGË DHE RITE NË DASMAT E RAJONIT TË PRILEPIT DHE KRUSHOVËS.....	75
Dr. Nexhat Çoçaj.....	87
dasma dhe DISA specifika TË saj në krahinën e Hasit	87
Doc.dr. Minir ADEMI.....	104
Doc.dr. Avni AVDIU	104
RITET E DASMËS TRADICIONALE SHQIPTARE NË KARADAKUN E KUMANOVËS	104
PhD.Cand. Ismet BEXHETI	119
KËNGËT DHE VALLET NË DASMAT E RAJONIT TË KARADAKUT	119
Prof. Dr. Nevrije BISLIMI-ISMAILI.....	135
DASMA NË SHTËPINË E VAJZËS	135
Kosovare KRASNIQI	142

RITET DHE CEREMONITË E DASMËS NË RAJONIN E ANAMORAVËS.....	142
Dr. Mustafë Haziri	157
Ritet e dasmës tradicionale në Drenicë të Kosovës	157
PhD.Cand. Besnik RAMETI.....	167
RITET DHE CEREMONITË E DASMAVE NË RAÇE TË SHKUPIT	167
PhD.Cand. Rini USEINI	176
VËSHTRIM ANTROPOLOGJIK I ÇËSHTJEVE EKONOMIKE TË DASMAVE BASHKËKOHORE SHQIPTARE.....	176
Dr. Bekim RAMADANI	182
AHENGU I BRISHTË I DASMAVE TË SOTME SHQIPTARE	182

HYRJE

Dasma shqiptare, në kuptimin e saj tradicional, paraqet në vetvete njëfarë tërësie e cila përfshin sistemin e rregullave dhe përdorimin e disa ritualeve të caktuara, duke e bërë organizim të vetëm gazmor dhe familjar, pasi në vetvete ngërthen përmbajtje të shumta. Natyrisht se gjatë ritit të dasmës demonstrohet gjuha e ritualeve të nduarduarshme, që me nuanca dallojnë në rajone të ndryshme. Forma e ritualeve nuk ndahet nga domethëniet e tyre, ato të gjitha janë të fiksuara dhe në rrjedhën e gjatë të shekujve praktikisht asnjëherë nuk u janë nënshtruar ndryshimeve.

Dasma në hapësirat shqiptare është, thuajse ceremonia më publike dhe se, ndryshe nga të gjitha llojet e komunikimit masiv, përfshin në vetvete një numër rreptësisht të kufizuar modelesh ritualore.

Fazat dhe karakteristikat e organizmit të dasmës tradicionale shqiptare janë:

-Faza përgatitore: në këtë fazë hyjnë të gjitha punët derisa të fillojë dasma.

-Fillimi i dasmës: dita e kulaçit dhe fillimi i tëhollimit të petëve të gatimit që shoqërohet më vallëzime;

-Nata e dasmës: ardhja e dasmorëve, e miqve, dhe të ftuarve shënon fillimin e natës së dasmës në shtëpinë e dhëndrit;

-Dita e dasmës: dita kur merret nusja.

Nata e martesës përmbyll ceremoninë tradicionale të dasmës, e cila përbëhej, sikundër e kemi kuptuar, prej një radhe njësisht të pavarura shenjore, të lidhura me rrugë lidhshmërie në një sistem që reflekton mentalitetin e shqiptarëve dhe, nga ana e përkundërt,

korrekton përfytyrimet tradicionale të shqiptarëve mbi të moralshmen dhe të shenjtën përgjatë shumë shekujsh.

Duke konsideruar se dasma është njëri nga momentet më të gëzuara në jetën familjare, mbi të cilën ndërtohet ngrehina bashkëshortore, ku do të lidhet përjetësisht jeta e dy të rinjve, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup iu qas në mënyrë shkencore organizimit të saj dhe dimensioneve të shumta që ndërlidhen me të. Të vetëdijshëm se dasma ka veçoritë e saj në rajone të ndryshme në hapësirën gjithëkombëtare shqiptare, konstatuam se nevojitet organizimi i një konference shkencore me pjesëmarrjen e studiuesve nga institute dhe qendra universitare të ndryshme shqiptare.

Më 3 maj të vitit 2019, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore e Shqiptarëve- Shkup organizuan konferencën shkencore me temë "Dasma në trevat shqiptare", në të cilën kontributet e tyre shkencore i prezantuan profesorë universitarë dhe studiues të kësaj fushe nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve- Shkup, Universiteti i Tetovës, Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë, Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup, Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Instituti i Folklorit në Shkup.

Këshilli organizues/redaktues



*Koordinatori i konferencës, Sefer Tahiri, dhe
drejtori i Institutit, Skender Asani*



*Referimet e studiuesve në sallën e Institutit
(në foltore – Izaim Murtezani)*



Foto e përbashkët me studiuesit

IZAIM MURTEZANI*Instituti i Folklorit - Shkup*

SIMBOLIKA E PJELLORISË

(Sipas shembujve të ritualit dasmor *lypja e pulave*)

Shkurtore: Struktura përmbajtësore e dasmës përfshin brenda saj një numër të madh të aktiviteteve me prapavijë rituale, magjike e kështu me radhë. Megjithatë, në këtë kontekst, vlen të veçohet riti i lypjes së pulave i cili është tejet i veçantë, por edhe i një karakteri tejet arkaik. Dihet se dasma në esencën e saj ngërthen ndjelljen e pjellorisë së çiftit të ri martesor, andaj ajo afirmon kryesisht një logjikë të kësaj natyre, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo të tërthortë. Riti i lypjes së pulave në mënyrë të tërthortë, apo simbo- like bart mesazhin e pjellorisë dhe i dedikohet nuses së re. Ky akti- vitet ritual ekzekutohet në shtëpinë e djalit, por që përkon me natën kur vajza bëhet nuse.

Njëkohësisht, riti në fjalë që ekzekutohet diku kah mesnata dhe në kohën kur vajza bëhet nuse ndërlihet edhe me përfundimin e be- qarisë së vajzës. Në të vërtetë, pulat e grumbulluara theken dhe në mëngjes hahet ushqimi i përgatitur prej tyre. Me këtë rast thuhet se “hahet” beqaria e vajzës. Ky rit ndoshta në cilësinë e flijimit të pulës mund t’i jetë dedikuar edhe ndonjë hyjnie pagane nga e cila mund të jetë kërkuar që të ndikojë në pjellorinë e çiftit të ri marte- sor. Ndërkaq, dukuria e transvestizmit apo veshja me rroba meshkujsh e vajzave që ekzekutojnë ritin në fjalë me siguri se ndërlihet me ritualet e kalimit, përkatësisht me fazën e liminalite- tit kur braktiset periudha e vajzërisë dhe kur aderohet në periudhën e nusërisë

1. Përshkrimi i ritualit dasmor lypja e pulave

Që në hyrje, apo prologun e kësaj trajtесе shkencore duhet theksuar se pothuajse e gjithë struktura përmbajtёsore e dasmёs afirmon kryesisht logjikёn e pjellorisё, pasi edhe synimi i saj pёrfundimtar ёshtё krijimi i nёj familje tё re, nёnkuptohet nёpёrmjet lindjes sё fёmijёve. Nёj ritual i kёsaj natyre gjithsesi se ёshtё edhe rituali dasmor, i njohur me sintagmёn *lypja e pulave* i cili si version i tillё ka mbijetuar nё nёj areal hapёsinor, jo edhe aq tё madh. Epiqendra e mbijetesёs sё kёtij rituali ёshtё zona e Dervenit tё Shkupit, por edhe ajo e Pollogut, nёnkuptohet edhe ndonёj zonё tjetёr, me ndonёj pёrjashtim tё rrallё. Pra, ky ritual si i tillё, nё vija tё pёrgjithshme, mund tё identifikohet kryesisht me shqiptarёt e Maqedonisё sё Veriut, ndonёse e hasim edhe nё vise tjera shqiptare me sintagmёn *nata e pulave*, por me ndonёj version tjetёr.

Rituali nё fjalё ёshtё disi i veçantё dhe ushtrohet nё natёn e tretё tё fillimit tё dasmёs. Nё mёnyrё mё tё precizuar dhe tё detajuar, ritualin nё fjalё e ka pёrshkruar Fadil Sulejmani nё librin e tij tё njohur me titull *Lindja, martesа dhe mortja nё malёsitё e Tetovёs*. Duke qenё se rituali nё fjalё qё ёshtё pёrshkruar nga autori i sipёrpёrmendur ёshtё tejet arkaik dhe pёrmban shumё elemente tё lashta, atёherё ai do tё shёrbejё edhe si bazё mbi tё cilin do tё zhvillohet interpretimi teorik, por kjo nuk do tё thotё se nuk do tё ofrohet edhe ndonёj e dhёnё tjetёr, nёnkuptohet nga ndonёj trevё tjetёr. Rituali i lypjes sё pulёs qё sot pothuajse ka humbur praktikimin e tij, me ndonёj pёrjashtim tё rrallё, ka qenё nё tё kaluarёn nёj pjesё tejet e rёndёsishme e strukturёs pёrmbajtёsore tё dasmёs. Ai ka qenё i ndёrlidhur kryekёput me botёn femёrore, veçmas me vajzat e reja tё cilat kanё ditur tё argёtohen tejmase me mundёsitё e ritualit nё fjalё, i cili ёshtё praktikuar jashta shtёpisё sё dasmorit. Nё ambiente tё dominimit tё konditave patriarkale, vajzat e reja mezi

kanë pritur që të ekzekutojnë një ritual të kësaj natyre në ndonjë lagje tjetër, por madje edhe jashta fshatit të tyre.

Kjo praktikë zakonore ekzekutohej të premten gjatë natës poqese zhvillohej dasma ditën e diel, apo ditën kur merrej nusja. Në të vërtetë, kjo natë, në fshatrat e Dervenit të Poshtëm ishte e pagëzuar si natë e dimijave, por njëkohësisht edhe si nata e pulave pasi të dy aktivitetet në fjalë realizoheshin brenda një nate të njëjtë. Në të vërtetë, po në këtë natë, në trevën në fjalë, paraprakisht zhvillohej aktiviteti që ndërlidhej, veçmas me nuset e reja. Kjo natë, siç cekëm më sipër, cilësohej si nata e dimijave, pasi të gjitha gratë që merrnin pjesë në dasmë, sidomos nuset e reja duhej të ishin të veshura në mënyrë të njëjtë, përkatësisht me dimija. Kjo veshje, më konkretisht, nënkuptonte dimija të bardha, jelek të punuar me fije ari, këmisha të mëndafshta, të endura në vek, si dhe stoli ari, të vendosura në qafë dhe duar. Pjesë përbërëse të veshmbathjes ishin edhe pështjellakët, të quajtur në këtë anë si *skutaçe me shishe*, të cilat po ashtu ishin të endura në vek. Ky aktivitet, nën tingujt e dajreve dhe këngës, shoqërohej me luajtje të valleve, kurse këtyre u prinin nuset e reja. Për t'i prirë valles i ftonte kënga me vargje adekuate (Murtezani, 108: 109). Pasi përfundonte ky aktivitet, atëherë, diku kah mesnata, apo pas saj, niste aktiviteti i lypjes së pulave i cili zhvillohej nga vajzat e reja, të pranishme në dasmë. Ky aktivitet i lypjes së pulave, në fshatrat e Dervenit të Shkupit përkonte me natën kur vajza bëhej nuse. Ajo në aspektin formal i jepte fund fazës së beqarisë pasi atë natë vishte rrobat e nusërisë pas një refuzimi dramatik se kinse nuk i preferonte këto rroba që e ndanin nga familja, por detyrohej që të pajtohej me fatin e tillë.

Rituali i lypjes së pulave që ushtrohej në shtëpinë e dasmorit zhvillohej në këtë mënyrë: të gjitha vajzat që ndodhen në dasmë në krye me dajrexhijet dalin dhe lypin një pulë të afërmit, apo farefisi i dhëndrit, apo të dasmorit. Ato shkojnë e lypin pulën nëpër

shtëpitë e lagjes së dasmorit, por edhe nëpër shtëpi të tjera të lagjeve më të afërta që janë farefis me të. Madje edhe nëse shtëpitë e farefisit të dasmorit ndodhen në lagje më të largëta të katundit ose në ndonjë katund tjetër më të afërt, atëherë vajzat shkojnë deri atje për të ushtruar ritualin në fjalë. Me vajzat dalin edhe nja dy-tri gra me moshë mesatare dhe një mashkull i farefisit të tyre, por munden edhe më shumë, por që duhet të jenë të shkathët për t'i ruajtur ato që të mos u ndodh diçka gjatë rrugës që duhet ta bënin. Vajzat më parë merrnin një gjel nga shtëpia e dasmorit. Atë e stolisin me tela e me lule, duke i vënë edhe para dhe duke e mbajtur ndër sqetull shkojnë në çdo shtëpi të lagjes e të farefisit të dasmorit dhe lypin një pulë. Natyrisht të gjitha shtëpitë atyre s'u japin pula: këtë shpend ua japin kryesisht ato shtëpi që kanë lidhje të ngushta gjaku me dasmorin, përkatësisht me dhëndrin, si: daja i tij, mixha, motra etj. Vajzat kanë të drejtë dhe nuk merret për turp që ta vjedhin pulën prej asaj shtëpie që s'e jep, prandaj pulat i fshehin dhe i ruajnë mirë atë natë. Ato shtëpi që s'u japin pulë, duhet t'u japin diçka tjetër vajzave: mish (pastërma), vezë, djathë, tëlyer, fasule, sheqer, gështenja, kunguj, bonboniera, pemë, perime, të holla etj.

Në këtë kontekst duhet veçuar veçmas faktin se me rastin e lypjes së pulës disa nga vajzat vishen me rroba burrash: me tirq, me lurkë, me kësulë të bardhë etj. Njëkohësisht edhe vënë mustaqe duke marrë edhe një shkop në dorë. Disa nga vajzat e tjera bëhen xhinde të ndryshme: duke u nxirë kah fytyra e duke u veshur me rroba të llojllojshme burrash e femrash dhe në mënyra të ndryshme: vënë edhe këmborë nëpër trup dhe kështu u ngjasojnë karnavalistëve të mirëfilltë. Derisa disa vajza u bien dajreve e këndojnë, të tjerat që janë veshur si burra e janë bërë xhinde, bërtasin e piskasin tmerreshëm vazhdimisht (Sulejmani, 2005: 283). Ky ritual si i tillë e që është përshkruar nga Fadil Sulejmani në librin e apostrofuat, u

dedikohet fshatrave të Malësisë së Sharrit, por edhe fshatrave të Dervenit të Tetovës.

Një ritual i tillë është pothuajse i ngjashëm edhe me fshatrat e Dervenit të Poshtëm që gravitojnë aktualisht në Komunën e Sarajit. Edhe në fshatrat e Dervenit të Poshtëm, vajzat përderisa lypin pula te farefisi i dasmorit, nëpër oborret e shtëpive të tyre këndojnë me defa dhe luajnë valle nën ritmin e tyre. Nëpërmjet vargjeve të këngës, fillimisht i bëhet thirrje zonjës së shtëpisë si vijon: *Hajde Lulije merre udhën o / hajt shko n'koshare merre pulën / nauk pulën nauk se do m'voje, o, / nauk gjelin nauk se do m'këndoje, o, / herët në sabah do më m'çoje, / çarap birit derrit do i mbaroje*. Në kohën kur vajzave u ofrohet peshqeshi, qoftë në trajtë të pulës ose diçka tjetër, atëherë vajzat në shenjë kompenzimi këndojnë ndonjë këngë falenderuese duke i dëshiruar zonjës së shtëpisë që sa më shpejt të përfjetojë martesën ose synetinë e djalit të tyre, varësisht nga ajo se cila nga këto ndodhi familjare do të jenë më afër në aspektin kohor. P. sh.: *Ene taj dahiren na e sajdisë, / ta kthefshim n'Kujtim fidanin, / ma frajk ja bafshin donamin, / ene do ja bajm hiç pa rrena, / llafet e majra i kena*. Po ashtu, nëse fëmija ende nuk është bërë synet, atëherë dëshirohet një gjë e tillë, si vijon: *Ene taj dahiren na e sajdisë, / ta kthefshim n' Kujtim siretin, / ma frajk ja bafshin sinetin, / ene do ta bojme me lodra, / do t'i ulurojm male e kodra*¹. Këngë dhe vargje të kësaj natyre, ka ofruar paraprakisht edhe Fadil Sulejmani, nënkuptohet për fshatrat e rrethinës së Tetovës. Një ritual i kësaj natyre, por i një versioni tjetër, është zhvilluar edhe në fshatrat e Rekës së Epërme. Në të vërtetë, kërceshin valle me gjelin në dorë në mbrëmjen kur arrinin tupanat në fshat, apo në shtëpinë e dasmorit. Ritual i tillë është paraqitur

¹ Të gjitha vargjet, apo këngët e prezantuara u kënduan dhe recituan nga amvisja Vafire Halimi (1931-2013) nga f. Kopanicë e Shkupit. Shënoi dhe regjistroi: Izaim Murtezani

edhe në skenë gjatë mbajtjes së manifestimit kulturor “Takimet e Rekës së Epërme” – Rimnicë – 2018 (fig. 1 dhe 2).



Fig. 1



Fig. 2

Në kontekst të ritualit në fjalë duhet theksuar se vajzat pasi kthehen në shtëpinë e dasmorit, ia nisin valles me pulat në dorë duke i kënduar ato. Autori Fadil Sulejmani (2005: 285) i ka regjistruar edhe vargjet e këngëve të tilla: *He more taj gjel me papuçe, / do ta bajna çafën e kuçe, / he more taj gjel pajka-pajka, / a të sreditet thajka?! apo: He mori taj pul lara-lara, / a të sreditet hanxharja? / He mori taj pul me kaçajtël, / xhi e kije mishin e shajshët!* etj. Pra, këtë natë, vajzat nuk flejnë fare, por u bien dajreve, këndojnë, vallëzojnë dhe argëtohen në pafundësi. Në disa fshatra të Dervenit të Poshtëm, pas përfundimit të ritualit të lypjes së pulës ekzekutohen edhe lojëra të ndryshme të përmasave humoristike me ç’rast vajzat vishen me rroba të burrave, me plis të bardhë si dhe vendosin mustaqe të vizatuara dhe me vete marrin një shkop, kurse edhe djemtë në këtë natë bëhen nuse. Pra, kemi të bëjmë me zhvendosjen e kësaj pjese të ritualit në ambientin shtëpiak të dasmorit. Dikur para mëngjesit i shtrojnë sofrat dhe i hanë pulat e përgatitura me këtë rast. Nënkuptohej se mishi i këtyre shpendëve (pulave dhe gjelit) shërben për të përgatitur ushqimin me oriz, ose diçka tjetër, varësisht nga peshqeshet në trajta ushqimore që kanë marr paraprakisht gjatë ushtrimit të ritualit në fjalë. “Përgatitja e banketit dhe ngrënia e pulave mu atë natë kur

vajza bëhet nuse, kur mbaron beqaria e saj, është e lidhur pikërisht me këtë moment të hidhur të jetës së vajzës e cila i jep fund jetës së beqarisë, të cilën e hanë vajzat në banket bashkë me pulat: "Hahet beqarjja e caucës, ajo maron, vdes ma" thonë vajzat tona (Sulejmani, 2005: 285).

Pra, siç mund të vërehet nga rituali i përshkruar, ai brenda tij ngërthen edhe këngën, apo edhe anasjelltas – kënga ngërthen ritin. Dihet se "këngët që paraqiten të lidhura me ritin janë këngë me funksione ceremoniale-urdhëruese, të cilat nëpërmjet shoqërimit të fjalës artistike, detajojnë dhe pohojnë veprimin ritual. Në këtë mënyrë, riti kushtëzohet artistikisht nëpërmjet këngës, përmes fjalës poetike dhe sinkretizimit me komponentët e tjerë ritualë, shoqërimin muzikor, lëvizjen koreografike, veprimin ritual, pjesëmarrjen e objekteve riuale, dekorin etnografik funksional etj. Kënga në atë moment është përbërëse sinkretike e riti; të dyja bashkë, kënga dhe riti, krijojnë organizmin poetiko – ritual. Funkzioni i këtij organizmi nuk ka të bëjë vetëm me synimin pragmatik të suksesit ritual. Asociacionet e veçanta që krijojnë kënga (në bashkëshoqërimin tekst, muzikë, valle) i japin vlerë këtij funksioni dhe në nivelin estetik të lidhur me ndjesitë njerëzore, me përfshirjen në emocionalitet dhe në përjetime të të gjithë bashkësisë që merr pjesë në nyjat më thelbësore të festimit, që veçohen si *kremtim ceremonial*" (Velianj, 2012: 40).

Në vija të përgjithshme, në kuadër të përmbajtjes së ritualit në fjalë që me siguri se mund të jetë i pranishëm edhe jashta trevave të apostrofuara, rezulton se disa njësi, apo kode semantike të tij paraqiten si tejet arkaike dhe njëkohësisht tejet motivuese për të depërtuar në fshehtësinë e interpretimit të tyre, nënkuptohet në bazë të të arriturave të deritanishme etnologjike dhe çdoherë në përjasje me materiale të njëjta që i kanë poseduar popujt të cilët kanë një traditë shkrimi më të gjatë apo më të hershme.

2. Interpretimi i ritualit dasmor lypja e pulave

Përmbajtja e ritualit dasmor që e përshkruam më sipër ngërthen një numër të madh të segmenteve që tërheqin vëmendjen e studiuesit, pasi kuptimësia e tyre është harruar nga pjesëmarrësit dhe ato nuk janë në gjendje të japin shpjegime adekuate. Në të vërtetë, ato (vajzat e reja) e përcjellin dhe praktikojnë ritin por nuk mund të japin interpretime adekuate, pasi kuptimësia parake e ritualit ka humbur gjatë bartjes së tij nëpër kohë, nënkuptohet që mund të ketë zgjatur me qindra e mijëra vjet. Në të vërtetë kemi të bëjmë me një ritual, apo praktikë zakonore me prapavijë kryekëput pagane. Në kontekst të strukturës përmbajtësore të ritit në fjalë duhet interpretuar kohën e ekzekutimit të tij që ndërlidhet me mesnatën, pastaj dukurinë e transvestizmit, përkatësisht veshjen e vajzave me rroba burrash, zhurmën që prodhojnë pjesëmarrësit, por edhe simbolikën e pulës dhe gjelit si kode tejet të rëndësishme me prapavijë zoomorfe.

Në kontekst të *kohës* së ushtrimit të ritualit në fjalë duhet theksuar se ai përkon me mesnatën, apo me intervalin edhe pas saj. Dihet se sipas përfytyrimit popullor, mesnata, apo koha pas saj perceptohet si interval gjatë të cilit e shtrijnë aktivitetin e tyre forcat me prapavijë demoniake. Këto forca me atribute të mbinatyrshme është pretenduar se kanë mundur ta dëmtojnë njeriun, andaj ka qenë e preferueshme që bota njerëzore të privohet nga aktivitetet e saj, veçmas pas mesnate. Duke e pasur parasysh këtë fakt, atëherë bota femërore, përkatësisht vajzat e reja që ushtrojnë ritualin në fjalë pikërisht pas mesnate është dashur që të gjejnë mekanizëm adekuat për të shmangur rrezikun nga forcat e liga. Një mekanizëm i tillë ka qenë maskimi, apo identifikimi me fuqitë me prapavijë demoniake. Maskimi i tyre, siç theksuam më sipër, bëhet duke e lyer fytyrën me ngjyrë të zezë, përkatësisht me thëngjill, gjë që ndikon ato t'u ngjasojnë qenieve të natyrës demoniake.

Dihet se fuqitë demoniake si krijesa ktonike, apo nëntokësore, fytyrën e kanë po ashtu me ngjyrë të zezë. Ekziston një numër i madh i hyjnive ktonike me ngjyrë të zezë, pothuajse në të gjitha mitologjitë e botës. Kështu te misirët e lashtë, me ngjyrë të zezë kanë qenë hyjnitë më të rëndësishëm si Ozirisi, Izida, por edhe disa hyjni tjera, te të cilat ngjyra e zezë nuk ka qenë edhe aq e theksuar. Edhe te babilonasit e lashtë janë të njohura hyjnitë dhe demonët me ngjyrë të zezë, por me numër më të vogël krahasuar me misirët. Edhe te indoarianët e lashtë përmenden shumë hyjni me ngjyrë të zezë. Madje në Vedat e njohura indiane përmenden dendur qenie lemeritëse dhe të errëta kundër të cilave lufton dhe fiton hyu indias i dritës Indra, mbrojtës i arianëve. Edhe te persianët përmenden demonë me ngjyrë të zezë.

Edhe te grekët e lashtë, si fqinj të parë të paraardhësve tanë – ilirëve, kanë ekzistuar shumë hyjni me ngjyrë të zezë që kanë qenë të ndërlidhur kryesisht me botën e vdekjes, apo botën e poshtme (nëntokësore). Hyjni, apo perëndi të kësaj natyre, në mitologjinë e lashtë greke, paraqiten ëndrra dhe vdekja, përkatësisht Hipnosi dhe Thanatosi. Ky i fundit në gjuhën greke kishte edhe kuptimin e natës së zezë. Që të dy janë vëllezër bineq me ç’rast vdekja krahasohet me ëndrrën – ëndërr në varr, por edhe anasjelltas, pasi gjumi konsiderohet si vëllai i vdekjes. Edhe Hadi, hyjni supreme greke i botës nëntokësore, apo i shpirtrave të vdekur, e kishte ngjyrën e zezë. Madje, Adi është emri i botës së poshtme. Erebi dhe Tartari janë emra të lokaliteteve të botës së poshtme. Tartari paraqet pjesën më të ulët të botës nëntokësore ku janë degdisur Titanët dhe demonët tjerë të cilët i janë kundërvënë Zeusit. Po ashtu, Aheronti, Stiksi, Kokiti dhe Flegeroni janë lumenjtë e njohur të botës nëntokësore, pronari i të cilëve është Hadi, përkatësisht Plutoni që sundon me shpirtrat e të vdekurve. Persefoni është bashkëshortja e tij, hyjnesha dhe mbretëresha e botës nëntokësore, përkatësisht

vajza e Dhemetrës - hyjneshës më të madhe ktonike në Greqinë e Lashtë, apo Nëna-Tokë ku është lokalizuar bota e poshtme. Kerberi, i përfytyruar si qen me tri koka, është roja e botës së poshtme. Karoni ishte lundërtari i cili me lundrën e vet i bart të vdekurit nëpërmjet lumit të harresës - Aheront. Njëkohësisht, Erinitë janë hyjnesha të hakmarrjes dhe vdekjes që qëndrojnë në botën e poshtme. Pra, të gjithë këto hyjni dhe fuqi demoniake janë me ngjyrë të zezë dhe i përkasin botës së poshtme. Ekzistojnë edhe shumë hyjni tjera të kësaj natyre si Hekata - një ndër hyjneshat më të fuqishme të botës nëntokësore që sundonte mbi hijet, shpirtrat dhe demonët e këqinj. Me shpirtrat e të vdekurve, ajo shkonte në kryqëzimin e rrugëve dhe pranë varreve. Të një natyre të tillë ishin edhe fuqitë demoniake si moirat, titanët, gjigantët, kentaurët, Hidra, Gorgona, Meduza, si dhe shumë të tjera. Edhe Dionisi paraqitet me epitete që e përcaktojnë si perëndi me ngjyrë të zezë, Afërdita po ashtu paraqitet me fustane të zeza si Izida e kështu me radhë. Edhe te romakët, gjermanët e lashtë, keltët e kështu me radhë ekzistojnë fuqi të mbinatyrshme me ngjyrë të zezë. Në vija të përgjithshme, të gjithë këto perëndi dhe hyjni, apo edhe fuqi demoniake me ngjyrë të zezë ndërlidhen me botën nëntokësore, përkatësisht me botën e të vdekurve (sipas, FM, 1988; Kun, 2000)

Në të vërtetë, rituali i lypjes së pulave flet me gjuhën metaforike, apo simbolike. Ai ekzekutohet në shtëpinë e dhëndrit, por i referohet vajzës - nuse, pasi ajo atë natë, paraprakisht bëhet nuse në aspektin formal, nënkuptohet duke veshur rrobat e parapara të nusërisë dhe njëkohësisht duke mbuluar fytyrën e saj. Ajo, me këtë rast, njëherë e përgjithmonë lë prapa saj fazën e beqarisë dhe aderon në një periudhë të re kohore që me termin etnologjik është e pagëzuar si fazë liminale, apo si fazë kur ajo ndodhet në një periudhë kalimtare, apo tranzicioni. Në të vërtetë, ajo bëhet nuse formalisht, por realisht nuk është e tillë, pasi ndodhet në një fazë të

ndërmjetme. Ajo në aspektin formal braktis statusin e beqarisë, por realisht statusi i saj shoqëror ndërron vetëm pas natës së gjerdekut. Pikërisht, kjo fazë liminale, apo e ndërmjetme, karakterizohet me një numër të caktuar të simboleve që i referohen vdekjes, më konkretisht “vdekjes” së beqarisë, por njëkohësisht edhe “lindjes”, përkatësisht përfitimit të statusit të ri të të posamartuarës. Rrjedhimisht edhe rituali i lypjes së pulave, përkatësisht segmenti i tij konkret që i dedikohet kohës së ekzekutimit pas mesnate, por edhe imitimi i qenieve demoniake nga ana e vajzave nënkupton në aspektin simbolik ndërlidhjen me “vdekjen”, apo më mirë thënë, me “vdekjen” e beqarisë së vajzës - nuse.

Njëkohësisht, qeniet demoniake apo ktonike, sipas logjikës arkaike, përveç se ndërlidhen me vdekjen, ato ndërlidhen edhe me lindjen e re. Dihet se bimët mugullojnë nga sipërfaqja tokësore, apo nëntokësore e cila është nën pushtetin e hyjnive ktonike, përkatësisht Hadit, sipas mitologjisë greke. Njëkohësisht edhe lindja e fëmijëve, si synim kryesor i dasmës, është e ndërlidhur gjithsesi me hyjnitë ktonike. Në të vërtetë, mitra e tokës, në mitologjitë arkaike të popujve të lashtë, krahasohet me mitrën e gruas. Si rrjedhojë, segmentet e përmendura të ritit në fjalë afirmojnë logjikën simbolike të vdekjes, por njëkohësisht edhe atë të pjellorisë, apo lindjes që gjithsesi ndërlidhet me ambivalencën e qenieve ktonike.

Një element tjetër i rëndësishëm i ritualit të lypjes së pulave është edhe transvestizmi, përkatësisht veshja e vajzave me rroba të burrave. Një paradoks i rëndësishëm i riteve të kalimit, apo më konkretisht fazës së liminalitetit është edhe tendenca për të mos pasur një status të përcaktuar shoqëror, apo për të qenë edhe *ky* edhe *ajo*. Edhe vajza-nuse, prej momentit kur vishet me rrobat e nusërisë e deri në mbylljen në natën e gjerdekut nuk posedon ndonjë status të definuar shoqëror. Ajo nuk është as vajzë, as grua, por posedon një

status të ndërmjetëm, njëkohësisht i posedon edhe dy statuset në fjalë. Pra, edhe vajzat që vishen si djem gjatë ritualit të lypjes së pulave nuk posedojnë ndonjë status të përcaktuar gjinor, andaj loja e tyre me përkatësinë gjinore i referohet kryepersonazhit të dasmës, përkatësisht vajzës-nuse. Në ritet liminale dalin në skenë pështjellimi, kaosi, apo siç thotë Barbara Majerhof, antistruktura, ashtu siç ndodh edhe me transvestizmin në fjalë (Myerhoff, 1982).

Në të vërtetë, faza liminale e riteve të kalimit operon me dukurinë e ambiguitetit gjinor që nënkupton tërësinë e padiferencuar të gjërave. Më konkretisht bëhet fjalë për një rend kaotik, apo Kaosin, si një materje e padiferencuar dhe pa trajtë të caktuar. Dihet se në shumë mitologji të popujve të lashtë, Kaosi paraqitet si trajtë e padiferencuar në aspektin e përkatësisë gjinore, pasi njëkohësisht i posedonte të dy gjinitë në vetvete. Si rrjedhojë e një logjike të tillë, në shumë mitologji të botës, është i pranishëm miti i androgjinit. Ndërkaq, Kozmosi, apo krijimi primordial i Botës, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, pasoi kur u bë diferencimi i gjinisë. Në mitologjinë greke, nga veza që identifikohet me Kaosin primordial u krijua Toka si diferencim i gjinisë femërore dhe njëkohësisht Qielli si diferencim i gjinisë mashkullore. Pra, dasma, sipas studiuesit të njohur Eliade (2019) imiton modele, apo gjedhe kozmike, andaj kthimi në një status të padiferencuar gjinor i përgjigjet statusit të padiferencuar të vajzës-nuse e cila ndodhet diku në mes, apo duhet të “rrënojë” statusin e mëparshëm të beqarisë dhe të “krijojë”, apo aderojë në statusin e ri shoqëror të nusërisë, nënkuptohet që fillon me natën e gjerdekut.

Një tjetër element i rëndësishëm i ritualit të lypjes së pulave i dedikohet edhe pranisë së gjelit, por edhe pulës, përkatësisht statusit të tyre simbolik, nënkuptohet në sferën e konotacionit mitologjik. Dihet se gjeli është një qenie që posedon elemente edhe solare, por njëkohësisht edhe elemente lunare, apo ktonike, demoniake. Në të

vërtetë, kënga e tij në mëngjes, paralajmëron fuqitë demoniake se duhet të largohen nga aktiviteti i tyre, pasi fillon periudha ditore që është e rezervuar për aktivitete të botës njerëzore. Si rrjedhojë, këndimi i tij në mëngjes paraqet kufirin kohor midis ditës dhe natës. Pra, gjeli si një qenie që shënon kufirin kohor midis ditës dhe natës, në aspektin mitologjik, ndan kufirin midis Kaosit që identifikohet me natën dhe Kozmosit që identifikohet me ditën, apo energjinë e dritës, apo diellore. Në të vërtetë, ai ndodhet mes këtyre dy gjendjeve apo statuseve, përkatësisht ditës dhe natës, ashtu siç është edhe vajza-nuse në një gjendje të ndërmjetme, ajo nuk është as beqare, por as nuse në plotëkuptimin e fjalës, ajo është pa një status të diferencuar. Njëkohësisht, ajo i posedon edhe dy statutet shoqërore, është njëkohësisht edhe beqare, pasi ende nuk ka shkuar te bashkëshorti, por është edhe nuse, pasi është rregulluar si e tillë. Edhe gjeli duke qenë në pozicionin e ndërmjetëm, është njëkohësisht qenie që paraqitet si atribut edhe i hyjnive të konotacionit solar, por edhe hyjnive të konotacionit lunar, apo ktonik. Ai paraqet atribut të hyjnive solare greke, si Zeusi, Apoloni, etj., por njëkohësisht edhe të hyjnive ktonike, apo lunare, veçmas të larëve romakë. Ai njëkohësisht është edhe atribut i hyjnive solare-lunare, si Persefoni, Hermesi etj. Po ashtu gjeli paraqitet si atribut edhe i hyjnisë së njohur greke – Asklepit. Dihet nga mitologjia se Asklepi si hyjni i mjekimit mund t'i shëronte të sëmurët, por njëkohësisht mund edhe të ngjallte të vdekurit. Në të vërtetë, ai e ringjallte të vdekurin ose nëpërmjet gjakut të Meduzës, ose nëpërmjet një lloji të bimës që ia kishte mësuar, apo treguar gjarpri. Hyjnesha e njohur, Atena, i kishte dhënë Asklepit dy lloje të gjakut të Meduzës; gjaku nga vena e saj e majtë asgjësonte çdo lloj jete, kurse gjaku nga vena e saj e djathtë – i ringjallte të vdekurit (RGRM, 1979: 57).

Gjeli po ashtu ishte atribut edhe i perëndisë, Atis, hyjni e lashtë frigjiane e bimësë. Kjo hyjni simbolizonte ringjalljen dhe vdekjen e perëndisë. Pra, në përgjithësi, kemi të bëjmë me një shpend i cili ndërlidhet me të dy botët, edhe atë të vdekjes, por edhe të ringjalljes. Si figurë e tillë me siguri se gjeli ndërlidhet edhe me dhëndrin dhe nusen, pasi kemi të bëjmë me pozicionin e tyre të ndërmjetëm. Në të vërtetë, edhe dhëndri, por edhe nusja lënë prapa tyre statusin e beqarisë, pra një botë që po u “vdes” në aspektin simbolik dhe njëkohësisht një botë tjetër që u hapet, apo një status i ri që përfitohet me fazën e burrisë dhe nusërisë në të cilën duhet të ade-rojnë. Pra, nëpërmjet figurës së gjelit, në aspektin simbolik, ndje-llet një periudhë e re kohore apo një lindje e re, njëkohësisht dëbohen fuqitë e liga, pasi kënga e gjelit në mëngjes, sipas besimit popullor, paralajmëron ardhjen e një dite të re. Në drejtim të një konstatimi të tillë shkon edhe e dhëna se meqenëse gjeli me këndimin e tij në mëngjes i largon demonët e natës, atëherë te shumë popuj të lashtë të botës shembëlltyra e tij është shfrytëzuar si apo-tropeion me të cilin njeriu mund të mbrohet jo vetëm nga demonët e natës, por edhe nga të ligat e tjera. Për shkak të këtyre besimeve edhe shumë popuj të tjerë i kanë bartur figurat e gjelit si amulete, ose i kanë vënë në kulme të shtëpive etj (Stipçeviq, 1990: 341). Ndoshta, figura e gjelit që e kemi hasur në sfondin e çorapëve të grave të Malit të Thatë (fig. 3), përkatësisht në fshatrat Sallarevë dhe Gurguricë mund të jetë në cilësinë e ndonjë apotropeioni apo mbrojtësi nga fuqitë e liga apo edhe ndonjë lloj i magjisë për ndje-lljen e pjellorisë.



Fig. 3

Në sfondin e çorapëve mund të vërehet se figura e gjelit është me ngjyrë të kuqe në pjesën e poshtme, kurse në pjesën e sipërme me ngjyrë të kaltërt dhe ngjyrë të kuqe. Po ashtu mund të vërehet farë qartë se figurat e gjelave shtrihen përballë njëri tjetrit. Në të vërtetë, në pjesën e poshtme hasen dy gjela përballë njëri-tjetrit, kurse në pjesën e sipërme katër gjela, të ndarë dy nga dy, por po ashtu përballë njëri – tjetrit. Në këtë kontekst duhet theksuar se gjeli ndërlidhet edhe me Hyjneshën Dardane. Sipas arkeologes së njohur, Edi Shukriu, që i referohet një të dhëne të studiuesit Vukanoviq, “figura më e hershme e këndesit në trojet dardane është figura realiste nga Fafosi i Mitrovicës (Kosovë). Kjo figurë, sipas saj, i takon epokës së neolitit (Shukriu, 2014: 84). Autorja e njëjtë thekson se “prezenca e këndesit pranë Hyjneshës Dardane, shihet në funksionin e tij apotropeik, në veçanti si mbrojtës i qetësisë së të vdekurve. Në këtë rast mbase duhet pasur parasysh edhe simbolizmin e tij lidhur me rrugëtimin diellor kur krahasohet me funksionin e psikopompit mortal të hyjneshës në fjalë (Shukriu, 2014: 85). Megjithatë, siç theksuam më sipër, nuk mund të përjashtohet edhe mundësia tjetër, përkatësisht prania e gjelit të jetë

në funksion të ndjelljes së pjellorisë, pasi çorapët ku evidentohet një ikonografi e kësaj natyre, janë të nuses së re nga e cila kërkohet që të lindë fëmijë apo të jetë e frytshme. Në kuadër të mjedisëve patriarkale, sidomos është kërkuar lindja e djemve, andaj ndoshta prania e gjelit si metaforë e parimit mashkullor ndërlidhet edhe me një logjikë të tillë. Në ikonografinë e veshjeve popullore haset edhe motivi i ashtuquajtur "këmbë pulash" që i referohet me siguri ndjelljes së pjellorisë. Dihet se ky shpend paraqet një simbol të riprodhimit, apo pjellorisë tejet dinamike.

Ngrënia në mëngjes e mishit të gjelit, por edhe pulës nga vajzat që marrin pjesë në ritualin në fjalë nuk është e rastësishme, pasi kënga, veçmas e gjelit është e ndërlidhur, siç theksuam më sipër, me mëngjesin. Ngrënia e mishit të tyre bëhet me qëllime të natyrës magjike, por mund të jetë e ndërlidhur edhe me flijimin që u destinohet qenieve me fuqi ktonike, madje edhe paraardhësve tanë të vdekur, përkatësisht shpirtave të tyre. Një logjikë e kësaj natyre vërehet më së miri në një praktikë rituale që vjen nga treva e Korçës. Në të vërtetë: "ndër ortodoksët shqiptarë të trevës së Korçës, *E Shtuna e Pulave*, që quhet edhe si *E Shtuna e Shpirtave*, ishte e shtuna një javë para të dielës së karnavaleve ortodokse dhe fillimit të kreshmëve. Herët në mëngjes therej një pulë dhe, me gjakun e saj, të gjithë anëtarët e familjes bënin një kryq në krahëror e në ballë. Pas meshës, besimtarët e kishin zakon të mblidheshin në hajatin e kishës për t'u shtrirë e për të marrë një sy gjumë, me mendimin se, në ëndërr, do të shihnin shpirtat e të vdekurve" (Elisie, 2005: 198). Pra, siç mund të vërehet kontakti me pulën shkaktonte ëndërrën në të cilën paraqiten shpirtat e të vdekurve. Pra, pula si qenie flijuese ndërlidhet me kultin e të parëve, apo shpirtave të tyre të cilët, po ashtu, sipas botëkuptimit mitologjik, në cilësinë e qenieve ktonike, janë përgjegjës për pjellorinë, qoftë të rendimenteve bujqësore, por njëkohësisht edhe pjellorinë e çiftit të ri marte-

sor. Si rrjedhojë e një logjike të tillë, ngrënia e mishit të ri nënkupton ndjelljen e pjellorisë që sipas mendimit arkaik është e ndërlidhur me fuqitë e karakterit ktonik.

Duhet shtuar edhe faktin se prania e gjelit dhe pulës ndërlidhet edhe me praninë njerëzore. Në të vërtetë, atje ku ekzistojnë shpendët e tillë, ekziston edhe harmonia, mirëqenia, pjelloria e kështu me radhë. Këto shpendë janë shumë të socializuar, andaj atje ku nuk janë të pranishëm, konsiderohet se nuk ka edhe jetë. Në shumë recitime të karakterit magjik, apo më mirë thënë, në shumë formula për shërimin e sëmundjeve të ndryshme që mund të identifikohen me ndonjë fuqi demoniake që ka depërtuar në trupin e sëmurë, kërkohet që kjo e lig ta braktis trupin si vijon: *T'shkoqshin t'ligat n'mal të shkretë, / Ku s'knon as pulë, as gjel, / Ku s'kullot as ka, as edh, / Ku nuk bin bar i njomë, / Ku nuk bje drapën me korrë!* (Nin., 1982: 33). Pra, si antipod i shtëpisë që identifikohet me jetën, përkatësisht me praninë e shpendëve të tillë, si pula dhe gjeli, kemi hapësirën pyjore apo malore në të cilën mbizotëron një botë krejtësisht tjetër apo e vdekur. Pra, shpendët në fjalë apo prania e tyre është e ndërlidhur me praninë e botës njerëzore.

Njëkohësisht, prania e gjelit dhe pulës nënkupton edhe simbolikën e parimit mashkullor dhe femëror nga kryqëzimi i të cilave buron pjelloria apo jeta e re. Pra, siç mund të vërehet: “semantika mbizotëruese e ritualit në fjalë, por edhe e gjithë ceremonialit të dasmës është padyshim ideja e pjellorisë, prandaj, shumica e simboleve të pranishme në to lidhen me bashkimin e parimit solar - mashkullit dhe parimit lunar - femrës, përkatësisht rrafshimin e kontradiktës opozicionale që qëndron në bazë të ceremonialit, si shprehje e mendimit të lashtë arkaik që funksionon mbi bazën e dikotomive, apo të kundërtave semantike” (Velianj, 2012: 159-160). Ndonjëherë, rituali, apo praktika magjike, sidomos në kushte të shoqërisë patriarakale, merr edhe rolin e dominimit të mashkullit ndaj

gruas, nënkuptohet nëpërmjet simbolikës së parimit mashkullor që identifikohet me gjelin. Një gjë të kësaj natyre e reflekton “një rit që është praktikuar deri vonë në Dibrën e Madhe, (aty-këtu e ndeshim edhe sot): dy vetë nga ana e dhëndrit, marrin një gjel dhe vendosen njëri para dhe tjetri prapa nuses. Gjelin e hedhin tri herë mbi kokën e nuses, hidh njëri e prit tjetri, si adet që dhëndri ta sundojë nusen, ta zotërojë atë dhe ta mbajë të nënshtuar, si për t’i thënë se mbi kokën tënde do të këndojë gjithmonë një gjel (autoriteti i burrit). Ky gjel ka një natë të caktuar për t’u therur pas dasmës dhe quhet “gjeli i nuses” (Shqefni, 2015: 147). Pra, siç mund të vërehet, gjeli përdoret edhe në funksion të simbolit, por që në rastin konkret, merr edhe përmasa të një veprimi me prapavijë magjike nëpërmjet të cilit kërkohet që të ushtrohet superioriteti i botës mashkullore ndaj asaj femërore.

3. Përfundim

Në vija të përgjithshme, rituali paraqet një praktikë shoqërore që komponohet nga një varg aktiviteteve simbolike në trajtë të lojës, këngës, ligjërimit, gjestikulimit etj. Duke i poseduar të gjitha këto veprime që zhvillohen njëkohësisht, rituali ka karakter sinkretik. Rituali po ashtu paraqet një veprim jashta rutinës shoqërore të jetës së përditshme. Në të vërtetë, ai zhvillohet në kohë dhe hapësirë të caktuar.

Ritualit paraqet një instrument të rëndësishëm në aspekt të veprimeve simbolike nëpërmjet të cilave realizohet një transformim i caktuar, qoftë në baza individuale, qoftë në baza grupore. Shumica e ritualeve të kalimit, sipas Lincolnit “i transformojnë njerëzit dhe i zëvendësojnë rolet, statuset dhe identitetet e vjetra me të reja” (Bowie, 2009: 158). Sipas Malinovskit, “nëpërmjet funksionit simbolik një realitet i caktuar fizik ose një sjellje merr një vlerë konvencionale, apo më mirë thënë, impulset fiziologjike transferohen

në një sistem të caktuar semiotik, apo shenjësor. Ky komunikim simbolik përçohet nëpërmjet integritit të mendimit mitik në ritet dhe strukturën përmbajtësore të këngëve rituale. Në themel të ceremonialit qëndrojnë dikotomitë, opozicionet binare dhe shndrimet si cilësi të mentalitetit mitologjik, përmes së cilave lëviz jeta. Dasma paraqitet si një fenomen *sui generis* që bart simbolikën mitike të rrënimit dhe të krijimit, të vdekjes e të ringjalljes, të shtimit e riprodhimit" (Velianj, 2012: 23).

Edhe në ritualin e *lypjes së pulave* që zhvillohet gjatë ceremonisë së dasmës mund të hetohen elemente të një komunikimi simbolik, veçanërisht të përmasave magjike apo mitike. Rituali çdoherë praktikohet në periudha kalimtare kur duhet të ndryshojë diçka, apo të fillojë një periudhë e re kohore. Siç cekëm më sipër, në këtë kontekst, veçmas e rëndësishme paraqitet faza e liminalitetit. Në gjuhën latine *limen*, *liminis* shënon prapësinë, derën hyrëse të shtëpisë; në planin figurativ nënkupton fillimin, madje edhe barrierën. Individët që janë në gjendje liminale ndodhen në gjendje të dyfishtë; ata janë njerëz të pragut, apo, as plotësisht jashtë, as plotësisht brenda, as këtu e as atje, por ndërmjet këtyre dy gjendjeve. Edhe rituali i *lypjes së pulave* ekzekutohet në një fazë të tillë të ndërmjetme, apo në kohën kur vajza bëhet nuse. Në të vërtetë, edhe djali edhe nusja, në kohën kur zhvillohen ritualet e dasmës ndodhen ndërmjet beqarisë dhe burrërisë, apo vajzërisë dhe nusërisë. Pra, ndodhen në prag të përfitimit të një statusi të ri dhe braktisjes së statusit të vjetër, përkatësisht beqarisë së tyre. Në të vërtetë, edhe gjeli, apo këndesi, por edhe pula, ndodhen në një status të ndërmjetëm, pasi sipas botëkuptimit mitik, shpendët e tillë, kanë lidhje edhe me natën (fuqitë demoniake), por njëkohësisht edhe me ditën (fuqitë solare). Me fjalë të tjera, në aspektin mitik, shpendët e tillë paraqesin një urë ndërlidhëse midis jetës që mishërohet me ditën dhe vdekjes që mishërohet me natën.

Poqese venerohet statusi simbolik, apo funksioni ritual që posedojnë kafshët në modelin e botës, do të vërejmë se gjeli dhe pula kanë pozicion të ndërmjetëm. Kriteri themelor, sipas të cilit përcaktohet statusi simbolik është vendosja vertikale e kafshëve sipas klasifikuesit universal simbolik – *druri i botës* dhe vendosja horizontale sipas vlerës rituale, e bazuar në distancën e ndryshme fizike që kafshët kanë në raport me njeriun. Sipas kriterit të parë, në bazën e të cilit qëndron kundërvënia *lartë / poshtë, në / nën, thatë / lagështi*, në kulturat e popujve indoevropianë, në majën e drurit të botës qëndrojnë shpendët që fluturojnë, kurse në mes, në nivelin e kërcellit, janë vendosur kafshët thundrore – kuajt, demat, lopët, dhentë, dhitë. Në nivelin e njëjtë, pra në nivelin e kërcellit, por kundruall kafshëve të buta qëndrojnë kafshët e egra, kurse në pjesën e poshtme të drurit të botës, pra në rrënjë janë të vendosur gjarpinjtë, bretkosat, peshqit, kurse mund të jetë edhe ariu. Në raport me vendosjen vertikale, në kuadër të “drurit të botës”, pula dhe gjeli janë vendosur në mes, përkatësisht në nivelin e kërcellit. Ky pozicion i vendosjes përkon edhe me rolin e tyre në cilësinë e ndërmjetësit (mediatorit) në mes dy botëve. Në kuadër të vendosjes horizontale, pula dhe gjeli, në raport me njeriun janë më larg, dhe ato paraqiten si ndërmjetës midis kafshëve të buta dhe të egra. Duke e veneruar statusin simbolik të pulës dhe gjelit, si në vendosjen vertikale, po ashtu edhe në atë horizontale, mund të evidentohet e dhëna se ato kanë rol kufitar ose ndërmjetës (mediator), andaj jorastësisht paraqiten në ritet e kalimit. Një ndër karakteristikat e këtyre ritualeve është shoqërimi, ose përcjellja e tyre me simbole të pjellorisë, por njëkohësisht edhe me praninë e elementeve ktonike. E gjithë kjo të bën të gjykosh se shpendët e kësaj natyre janë ndërmjetës, apo një urë e karakterit magjik dhe ritual për të kaluar nga statusi i beqarisë që në aspektin figurativ vdes dhe lindjes së një statusi të ri social, siç është faza e burrërisë dhe nusërisë. Pra, shpendët e këtillë në aspektin magjik duke qenë si ndërmjetës posedojnë cilësitë e dy

botëve, andaj nëpërmjet tyre bëhet më i lehtë kalimi në një status të ri shoqëror, përkatësisht në fazën e nusërisë dhe burrërisë kur kërkohet pjelloria, përkatësisht lindja e fëmijëve. Nënkuptohet se prania e këtyre shpendëve e bën më të lehtë këtë ndryshim të gjendjes së dy të rinjve duke i ndihmuar në aspektin magjik në rrugën drejt sendërtimit të idealit të tyre – lindjes së pasardhësve të tyre.

Studiuesit e ritualeve, si etnologët, antropologët, por edhe të tjerët, kanë vërejtur se sistemi i ritualit ndërlidhet me simbolet të cilat kanë karakter sintetizimi duke ngërthyer në vetvete kode me prapavijë të rëndësishme mitike. Në të vërtetë, mendësia arkaike nëpërmjet riteve, apo sjelljes rituale, mëton të bart modele mitike primordiale, por që janë harruar gjatë ecejakeve kohore. Antropologu i njohur Levi-Strauss, ka vërejtur si vijon: “sistemi mitik dhe përfytyrimet e rrjedhura prej tij shërbejnë për të vendosur raporte ngjashmërie midis gjendjes natyrore dhe gjendjeve shoqërore, ose më saktësisht, për të përcaktuar një ligj ngjashmërie midis disa llojeve të kundërvënieve semantike, të vendosura në rrafsh të ndryshme sociale, rituale, religjioze e filozofike” (Velianj, 2012: 159). Përmbajtja e dasmës ndërtohet mbi logjikën e kundërvënies gjinore, por integrimi i kundërvënieve të tilla duhet të rezultojë me pjellorinë e një jete të re që e mban të gjallë gjininë njerëzore nëpër verikalitetin e saj kohor. Një numër i caktuar i etnologëve dhe antropologëve me të drejtë theksojnë se njeriu është *homo ritualis*. Ai nëpërmjet ritualit ia jep kuptimësinë jetës duke ndjellur veçmas pjellorinë në të gjitha segmentet e jetës individuale, shoqërore por edhe më gjerë.

Bibliografia dhe shkurtesat:

Bowie, Fiona (2009): *Antropologjia e religjionit*. Hyrje. “Tabernakul”. Shkup.

Eliade, Mircea (2019): *Miti dhe realiteti*. “Pika pa sipërfaqe”. Tiranë.

- Elsie, Robert (2005): *Leksiku i kulturës popullore shqiptare. Besime, mitologji, fe, doke, rite, festa dhe veçori kulturore*. Skanderbeg books. Tiranë.
- FM (1988): *Fjalor i mitologjisë*. Hartuar nga Doc. Todi Dhama. Redaksia e botimeve "Rilindja" – Prishtinë.
- Kun, A. N (2000): *Mite dhe legjenda të Greqisë së Lashtë*. "Horizont". Tiranë.
- Myerhoff, Barbara (1982): Rites of Pasage: Process and Paradox. *Celebration. Studies in Festivity and Ritual*. Washington.
- Murtezani, Izaim (2017): *Rite dhe praktika magjike të ciklit jetësor (Treva e Dervenit të Shkupit)*. Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve. Shkup.
- Myerhoff, Barbara (1982): Rites of Pasage: Process and Paradox. *Celebration. Studies in Festivity and Ritual*. Washington.
- Nin. (1982): *Ninulla*. Përgatitur nga Sadri Fetiu. Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë.
- RGRM (1979): *Rečnik grčke i rimske mitologije*. Dragosllav Srejšović – Aleksandrina Cermanović-Kuzmanović. Beograd.
- Stipčević, Aleksandër (1990): *Ilirët. Historia, jeta, kultura, simbolet e kultit*. "Rilindja". Prishtinë.
- Sulejmani, Fadil (2005): *Lindja, martesja dhe mortja në malësitë e Tetovës*. SHB "Çabej". Tetovë.
- Shqefni, Mimoza (2015): *Dasma në Dibër*. (Punim i doktoraturës, i mbrojtur në Qendrën e Studimeve Albanologjike në Tiranë në vitin 1912).
- Shukriu, Edi (2014): *Hyjnesha Dardane*. Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës. Prishtinë.
- Velianj, Albana (2012): *Rite e simbole në ceremonialin e dasmës tradicionale*. (Punim i doktoraturës, i mbrojtur në Qendrën e Studimeve Albanologjike në Tiranë në vitin 1912).

BUKURIJE MUSTAFA

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore
të Shqiptarëve - Shkup*

DISA ELEMENTE KANUNORE DHE ETNOLEKSEMA TË DASMËS

Çdo njeri si individ kalon nëpër cikle të caktuara të jetës, të cilat si të tilla, përcillen me ceremoni nga një shoqëri e tërë, duke festuar lindjen e martesën, krahas përfundimit të jetës, që shkakton një emocion ndryshe në jetën e çdokujt. Shoqëria njerëzore si një njësi e organizuar, funksionon sipas normave të caktuara për të shënuar këto cikle të jetës. Secila nga këto paraqet një stad të caktuar të ndryshimit në jetën e një individ, mirëpo vështrimi brenda kësaj shoqërie parasheh veprime të ndryshme dhe thuajse universale. Mjafton të kërkohe brenda leksematikës së martesës, e cila si e tillë kalon nëpër faza të caktuara, atë të fejesës dhe të dasmës, që në shoqërinë shqiptare mendohet si një nga manifestimet kryesore në jetën e dikujt, duke përfshirë këtu edhe familjen e ngushtë a të gjerë. Vendosur në një mikrosistem, një nga ngjarjet kryesore në një fshat, pa dyshim janë dasmat dhe kjo kalon përmasat e organizimit të ngushtë e të thjeshtë, duke marrë pjesë të gjithë, si mysafirë të ahengut, por edhe të participimit në çfarëdo qoftë ndihme ndaj të zotit të shtëpisë, kryefamiljarit. Edhe pse çdo krahinë apo fshat ka zakonet e veta, në përgjithësi disa nga rregullat janë të përgjithshme.

1. Çdo gjë fillon nga *msiti* (mesiti) a *shkuesi*,² që në pjesë më të madhe të të folmeve të shqipes përdoret e që shënon njeriun, i cili

² P. Skoku, Hulumtime gjuhësore te popullsitë joslave të luginës së Shkupit, Studime gjuhësore I, Prishtinë, 101.

është ndërmjetës dhe zhvillon bisedat në mes dy familjeve, zakonisht për të bindur familjen e vajzës, që të japin pajtueshmërinë për të lidhur *miqësi* a *krushqi* me familjen e djalit. Për shkuesin në Kanun është paraparë një palë këpucë, që duhet t'ia sigurojë ana e djalit,³ por sot peshqesh për shkuesin është këmisha. Pas arritjes së marrëveshjes në mes dy familjeve, bëhet *fejesa*, e cila shoqërohet me ndonjë peshqesh për vajzën e djalit, e që zakonisht shënohet me unazë dhe kësaj i thonë “*ndërrojnë unazat*”.⁴ Në popull e quajnë *nishan*, që është një leksemë turke, por që ka depërtuar në gjuhën popullore shqiptare, ngase ka një përhapje gjithandej. Në të folmen popullore përdoret edhe fjala *shekernicë/sheqernicë*, e që ka të bëjë me momentin kur vjen lajmi i mirë se familja e vajzës ka pranuar ta fejojë atë për djalit për të cilin e kanë kërkuar.

Procesi i kësaj ceremonie është paraparë edhe në normat kanunore të Lekë Dukagjinit e që elemente të saja, ka pasur deri vonë. Koncepti kanunor mbi martesën është: “*M’u martue me kanun do me thane m’u ba shpi, me i a shtue shpis një rob ma teper sa per krah të punve, sa per të shtuem të fmive*”.⁵

Në fshatra të rajonit të Karshiakës, martesë brenda fshatit nuk janë bërë,⁶ përkundrazi martesat janë kryer me fshatrat përreth, këtu

³ Vjet. Pagesa që i jepej kapucarit, ndërmjetësit, mblesit etj., si shpërblim për punën e bërë. Fjalori Elektronik Shpjegues.

⁴ “Vënia e unazave quhet “*kunoza*”. Me këtë rast shërbehen gota me verë ku vihen para si dhuratë vajzës. E fejuara ecën e mbuluar me shami, dhe nuk del para të huajve”. Тома Смиљанић, Насеља и порекло становишта, „Мијаци, Горна Река и мавроско Поље”, Српски Етнографски Зборник, књ. XXXV, Београд, 1925. 84-85.

⁵ https://gruppostudentescoalbanesemilosao.files.wordpress.com/2014/12/kanuni_i_leke_dukagjinit.pdf, 11.2.2019.

⁶ Për këtë lidhje flet edhe Jovan Trifunoski, i cili në kontekst të sqarimit të lidhjeve të gjakut e fisit dhe martesave thotë: “Në kuptim të *gjinis* nënkuptohet më shumë familje të një paraardhësi. Për *gjinin* ka emërtime të ndryshme: *gjaku*, *kabile*, *xhins*, *fis* etj. Anëtarët e gjinisë nuk martohen në mes vete derisa të ekzistojë vetëdija për farefisnin e përbashkët. Kur jetojnë në një fshat, atëherë

edhe qëndron e ashtuquajtura *martesa me t'ndrrume*⁷ edhe pse më vonë ka edhe martesa brenda fshatit.⁸ Kjo përsëri është e Kanunit, ku dalin normat e ndalesës e që janë emëruar: “*Të ndaluemt e martesës me Kanun*” dhe në këtë kontekst thuhet: *të mos jetë gjak a gjini, të mos jetë të njëj fisi* dhe ndër këto thuhet edhe *të mos ketë kumari*.⁹ Në funksionet kuptimore të ndryshme të fjalës *kumbar*, e diku të përdorur si *nun*, është ruajtur ai i shoqëruesit të dhëndrit: *...fjalë e moçme, kur martoheshin mirrte një shak/shok i thoshin nun*.¹⁰

Gjeneratat më të vjetra, e mbajnë mend procesin e zhvillimit të dasmës dhe të përcjelljes,¹¹ përkatësisht të dorëzimit të vajzës te familja e burrit. Sipas zakonit, nusja përcillet hipur mbi kalë të bardhë nga burrat e familjes së saj e që i thonë *përcjellsh*. Ata kanë një vendtakim me burrat e familjes së dhëndrit, zakonisht në mes të rrugës. Në momentin e dorëzimit, zakonisht më i afërmi i familjes,

pjesëtarët e një *gjinie*, zakonisht janë të përqendruar/ të mbledhur, ndërkaq shtëpitë e tyre paraqesin mëhalla të veçanta apo një mëhallë të tërë. Se si nga këto *gjini* janë formuara mëhalla, më mirë shihet në Sata Petkë, Gaber, Cernivor etj.” Jован Трифуноски, Слив Маркове Реке, Скопје, 1958, 89.

⁷ *Martesa me t'ndrrume* është akt i një martese të ndërsjellë të një çifti dhe si akt këmbimi, motra e dhëndrit martohet me vëllanë e nuses. Kështu vendoset një miqësi e dyfishtë në mes dy familjeve, në mënyrë që në këto fshatra malorë, përveç moslejimit të martesave brenda fshatit, nuk kanë realizuar as martesa me etnitë tjera, që kanë qenë në rrethinën e tyre më të afërt. Një lloj tjetër i martesave në këto anë ka qenë edhe *martesa me nder*, e që ka qenë më e rrallë, duke marrë parasysh se është paguar nderi i vajzës dhe këtë e kanë bërë vetëm familjet e pasura. Naif Mustafa (1941-2008), f. Gaber-Karshiakë.

⁸ Duhet të përmendet se në idenë e përbashkët, që të gjithë janë të ardhur nga Shqipëria e që e jep Trifunoski, është edhe fakti se Shqiptarët e f. Gaber martohen jashtë gjinisë, e që për Trifunoskin qenka tregues që paraardhësit e tyre nuk paskan qenë fis. Jован Трифуноски, Слив Маркове Реке, Скопје, 1958, 160.

⁹ https://gruppostudentescoalbanesemilosao.files.wordpress.com/2014/12/kanuni_i_leke_dukaginit.pdf, 11.2.2019.

¹⁰ Zeqir Zeqiri, i lindur më 1953, i f. Patishkë. Intervista u zhvillua më 21.01.2012 nga Ibe Mustafa dhe Bukurie Mustafa.

¹¹ Bëhet fjalë për gjeneratat që kanë lindur më vitet e ‘30-ta a ‘40-ta të shekullit të kaluar.

thotë: “*Gjaku jonë, robi juaj*”. Kjo tregon, së pari se sipas kanunit, në aspekt të hakmarrjes, “Gruaja nuk bie në gjakmarrje” - “Gjaku i lihet prindit”.¹² Togfjalëshi tjetër: “*robi juaj*”, ka kuptimin e pjesëtarit të familjes, njeri i shtëpisë, frymë (si njësi numërimi).¹³ Normat kanunore kanë qëndruar fuqishëm në jetën e fshatarëve malësorë, kështu që në momentin sa zhvillohet dasma, po që se ndodhë vdekje në familje, nuk ndalet asnjëri nga këto proceset; “*I dekni në shpi, krushqt do të nisen, nusja hinë në shpi, i dekni del shpijet*”.¹⁴ Në njërën anë përcillet kufoma e të vdekurit, e në anën tjetër, krushqit shkojnë e marrin nusen dhe e sjellin në shtëpinë e dhëndrit, e që ka kuptimin simbolik, atë të përfundimit të një jete, përballë rinisjes së jetës së re, që bartet te çifti i ri.

Dasma tradicionale zgjat shtatë ditë, thuhet se fillon “të martën *“kur shoshëm grunët*”, të mërkurën “*t’ollim*” (të hollojmë), të enjten “*lidhim unaz*”, të premten “*e therim kaun*”, ditën e shtunë “*vin lodrat*”, të dielën “*e marrëm nusen*” dhe të hënë “*i përcjellim zhypt*”.¹⁵ Mjaft i përhapur është zakoni i zënies së bukës me fillimin e dasmës e që e quajnë *Nata e kulaçit* dhe në esencë ka kuptimin pagan në vete, mbasi në brendi të saj vihen monedha. Në këtë kontekst janë leksemat, që lidhen me ritin, si: *kalaçtore-ja* (f. etnogr. ajo që e zë kulaçin), që zhvillohet zakonisht natën e mërkurë dhe *kalaçtorja* duhet të jetë e pamartuar. Ajo zë tri kulaçe dhe brenda brumit fut monedha.

Gjatë këtij riti këndojnë:

¹² Nye i njizetetetët: “Gruaja s’bjen në gjak” – “Grueja lëshon në gjak prinden”. https://gruppostudentescoalbanesemilosao.files.wordpress.com/2014/12/kanuni_i_leke_dukagjinit.pdf, 11.2.2019.

¹³ Fjalori elektronik shpjegues.

¹⁴ https://gruppostudentescoalbanesemilosao.files.wordpress.com/2014/12/kanuni_i_leke_dukagjinit.pdf, 11.2.2019.

¹⁵ H. Ymeri ka regjistruar këto rite të dasmës dhe ka dhënë disa vargje të këngëve që këndohen enkas për çdo ditë të caktuar. Haki Ymeri, E folmja e Karshiakës, Shkup, 1998, 23/24.

Kush ta zore kalaçin

Burr da marre kovaçin 2x

Tri bukët i ndanë nusja me dhëndrin dhe *kalaçtorja* qëndron në mes.¹⁶ Si t'i godasin tri pare a dy djalit, e fiton djali, ai bëhet *domaçin*, a si t'i bie nuses ajo fiton. Interpretimi lidhur me këtë zakon ndryshon, për një pjesë është interpretimi ekonomik i familjes, e në disa të tjerë lidhet me trashëgiminë në kuptim që nëse i bie paraja dhëndrit, do të lind djalë nusja apo vajzë nëse te ajo bie paraja.

Koha e dasmës, përkatësisht vendosja e datës dhe orës, përcaktohet me marrëveshje dhe këtë e quajnë *vade*; “me e nda *vaden*” dhe nuk guxon në asnjë mënyrë, askush ta ndryshojë, ashtu si thuhet edhe në Kanun.

Gjatë dasmës, e cila zakonisht fillon nga e marta dhe vazhdon deri ditën e diel, kur merret nusja, bashkëfshatarët e ndihmojnë dasmorin ekonomikisht. Bashkëfshatarët i ndihmojnë dasmorit edhe me një dash, që ia sjellin, e që është paraparë edhe në kanun: “*Asht kanun, qi mikut t'i shkohet në darsëm me dash*”.¹⁷ Por, në disa fshatra ka ditë të posaçme kur bashkëfshatarët i çojnë dru dasmorit dhe këta quhen *druarë*;¹⁸ ...edhe ja çonin ka një kal dru dasmorit.

Nisja për të marrë nusen, familjarët e dhëndrit i thonë: *krushq; krushqnjët u thon em me kval kush osht, em pa kval...*¹⁹ Rol të rëndësishëm në vendosjen e rregullit në dasmë e ka *çaush-i* që e ka

¹⁶ Hanife Ymeri (1972), Patishkë. Intervistë e zhvilluar: maj 2016.

¹⁷ https://gruppostudentescoalbanesemilosao.files.wordpress.com/2014/12/kanuni_i_leke_dukagjinit.pdf, 11.2.2019.

¹⁸ Kryes. sh. etnogr. pjesë e zakonit të dasmës, ku të afërmit i çojnë drurë të zotit të shtëpisë që bën dasme, e këtyre u thonë *druar*.

¹⁹ *Krushk/krushka/krushku* – ka dy kuptime, duke marrë parasysh se në disa të folme, kjo do të thotë: 1. të afërmit e familja e ngushtë e dy të martuarve; 2. njerëzit që shkojnë të marrin nusen.

kuptimin e krushkëparit;²⁰ (në këtë përdorim e kuptim, e gjejmë edhe në serbishte, por jo edhe në gjuhën bullgare a maqedonase).²¹

Një rol të rëndësishëm kanë edhe *petkaxhit*, *petkarët a stroynik*, *petkallar* (kryes. sh. etnogr. që nënkupton një grup burrash më të afërt nga ana e djalit, që ia çojnë rrobat nuses):²² "...sikur te na qi shkojn petkar, petkaxhi petkar i thirnjim dhe strajnik me kal...; thoshin vijn petkat i mirnjin petkat e vinjin n'duçi petkat me një kal..."²³

Në kuadër të dasmës, janë net të shumta e që lidhen me veprime të caktuara, kështu janë edhe *natë kane*, e që dikur ka qenë një ritual i tërë i vënies së kënasë dhe jo rrallëherë në natyrë e kanë gjetur kënanë, që e quajnë *gur kane*. Dasma nuk bëhet pa *bajrakët: tri bajrake* dhe atyre që mbajnë bajrakun u thonë *bajraktar*. Në majë të *bajrakut* vihen "*ja peshkir, ja maica, ja çarap*", mirëpo patjetër vihet edhe një mollë, në të cilën vendosen edhe monedha. Molla

²⁰ Emër m. etnog. "njeri i caktuar për të mbajtur rendin gjatë dasmës".

²¹ Emërtimi *çauš*, në fjalorët e shumë definohet si historizëm ballkanik, në kuptim "rreshter" dhe nuk njeh një përdorim tjetër, por po kjo leksemë në të folmet popullore ka përfutur një kuptim të ri. P. Skoku në *Etimologijski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika* i vitit 1971, vëren bartje kuptimore të të njëjtës fjalë *čauš* në terminologjinë dasmore të gjuhës kroate a serbe, që arrin deri edhe në Bosnje. Po i njëjti kuptim, në fjalorët e ndryshëm të gjuhës shqipe nuk është i regjistruar, mirëpo për gjuhën popullore ky emërtim në kuptim "*krushkëparë*" është mirë i njohur dhe ka shtrirje gjithandej. Është vështirë për të konkretizuar kohën e bartjes të kuptimit etnografik dhe përdorimit të këtij emërtimi, sepse edhe turqishtja nuk e njeh këtë kuptim, porse ajo ka depërtuar në kuptimet "nënoficer" a "ushtarak" dhe si e këtillë ka depërtuar edhe në gjuhët tjera. Në kuptim të "*krushkëparit*" nuk e ka as bullgarishtja e as maqedonishtja. Ekziston mundësia që të ketë ndryshuar kuptimin më vonë, por se si është përhapur kjo gjithandej në gjuhën popullore dhe deri ku ka arritur si e tillë mund të mbështetemi vetëm në të dhëna terreni (në të folmet shqipe të Maqedonisë, është i përhapur ky emërtim me po këtë kuptim; *çauš*- njeri që vendos rendin e krushqve dhe u prinë atyre).

²² P. Skoku, Hulumtime gjuhësore te popullsitë josllave të luginës së Shkupit, Studime gjuhësore I, Prishtinë, 101.

²³ Intervista u zhvillua më 28.01.2012. Intervistën e realizuan: Ibe Mustafa dhe Bukurie Mustafa. I intervistuari: Avdyl Halili, i lindur më 1955 në Patishkë.

vihet te dhoma e nuses deri të dielën, priten në gjysmë mollët dhe u jepet beqarëve e beqareve për t’u dalë kësmeti.²⁴

Dasma, si shumë rite e zakone tjera në vazhdimësi ka pësuar ndryshime dhe ka pranuar mjaft zakone e tradita të huaja, kryesisht të kulturës orientale dhe disa nga këto praktikohen edhe sot e kësaj dite, kryesisht në fshatra apo familje tradicionale, kështu dalin edhe “*natë e dimive*”, “*natë e pulave*” etj. Mirëpo, shumë nga këto janë reduktuar edhe ajo që e quajnë “*natë kane*”, ka kaluar në një formalitet, zakonisht festohet në lokale të ndryshme, por duhet theksuar se me këtë traditë, janë zhdukur edhe këngët që janë kënduar nga gratë enkas për vënien e kënase apo ndonjë rit tjetër.

2. Ritet e ciklit të martesës e të dasmës janë edhe një burim i gjerë informacionesh, që kanë të bëjnë me pjesën e gjuhës dhe asaj që e quajmë leksema kulturore dhe etnoleksikografi. Duke marrë parasysh të folmet e gjuhës shqipe, do të shqyrtojmë vetëm disa nga këto, mbasi në pjesë të madhe janë ruajtur dhe krijojnë një thesar shtesë të gjuhësisë. Kështu, etnoleksemat *mik*, *krushka*, *shkuesi*, por edhe *msiti* janë shqipe dhe në lidhje me këtë P. Skoku shprehet: “Meqenëse shprehjet e dasmës (*dars(z)ma*, *kraushk*), si edhe shprehjet e farestisnisë janë kryesisht joslave, po e shënojmë fjalën *stojniki* në Jabollcë, për të cilën shqiptarët e tjerë thonë *shkus*, rrjedhojë e foljes *me shku*, e në Shkup i thonë *misit*, fjalë me prejardhje greke”.²⁵ Po qe se marrim aspektin kuptimor të kësaj fjale *misit* (*msit*) del se është shqipe. Edhe në kuptimin e fjalës *misi-ti/msit*, fjala mbi të cilën ndërtohet kjo leksemë është parafjala “mes”, nga e cila dalin edhe: *mesiti/mesës/mesitni/mestari*,²⁶ që vije nga kuptimi i ndërmjetësitë, që hynë në fjalorin e fjalëve të

²⁴ Hanife Ymeri (1972), Patishkë. Intervistë e zhvilluar: maj 2016.

²⁵ P. Skoku, Hulumtime gjuhësore te popullsitë joslave të luginës së Shkupit, Studime gjuhësore I, Prishtinë, 101

²⁶ *Mesitni* etnograf. Të qenit mesit a mesës; puna që bën mesiti: pjesëtar i mesitnisë. Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006.

vjetra të etnografisë. Në këtë mënyrë janë ndërtuar edhe leksemat kulturore: *përcjellsh* nga “përcjellë”, *petkaxhit*, *petkarët*, *petkallar* nga “petka”,²⁷ apo *kalaçtorja/kulaçtorja*, që vije nga “kulaç” (kulaç-tore), e që është e mbarë shqipes.²⁸ Këto shembuj tregojnë se gjuha e folur popullore është mjaft e pastër në aspekt të përdorimit të leksemave të veçanta të ciklit të martesës dhe të dasmës dhe është prodhimtare, sa i përket krijimit të formave të prejardhura apo mënyra tjera fjalëformuese, që e rritë numrin e fjalëve, por që qëndrojnë në fondin leksikor dialektor.

Leksemat e këtyre cikleve, por edhe shumë të tjera të riteve e të zakoneve, janë të rëndësishme, ngase sqarojnë mënyrën e krijimit të tyre, duke dhënë edhe informacione për prejardhjen e fjalëve, që për gjuhësinë shqiptare kanë vlerë, por edhe e sqarojnë aspektin etnokulturor të vetë shqiptarëve.

Persona të intervistuar:

Avdyl Halili (1955-2015), f. Patishkë.

Zeqir Zeqiri, (1953), f. Patishkë

Hanife Ymeri (1972), f. Patishkë.

Naif Mustafa (1941-2008), f. Gaber-Karshiakë.

²⁷ Skoku fjalët *petka* dhe *brez* i jep si iliro trakase. P. Skoku. Po aty, f. 101

²⁸ Kulaç *m.* “bukë e ngjeshur e rrumbullakët”. Fjalë e mbarë shqipes duke përfshirë edhe arb. e Italisë e Greqisë. Huazim prej sll. (skr.) *kôlač*, (bullg.) *koláč*. Geg. veriore ka *kuleç* me ndërrimin dialektor –a-> -e- (khs. Tesh, nelt). Emri *kulaçe* për “topa brumi, që vihen një mbi një, shtypen e ngjishen si kulaç dhe tëhollen së bashku për të bërë petë lakrori” me formantine emrave të gjinisë femërore dhe të shumës të tyre duke qenë fjala shumës i singularizuar. Prej arb. së Italisë ka depërtuar në dialektet italiane të Kalabrisë. Kolec Topalli, Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe, Tiranë, 2017.

Bibliografi

Skoku, Petar. *Hulumtime gjuhësore te popullsitë josllave të luginës së Shkupit*, Studime gjuhësore I, Prishtinë, 1978.

Skoku, Petar. *Etimologijski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika*, Zagreb, 1971.

Смиљанић, Тома. *Насеља и порекло становишта*, „Мијаци, Горна Река и мавроско Поље“ , Српски Етнографски Зборник, књ. XXXV, Београд, 1925.

Topalli, Kolec. *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2017.

Трифуноски, Јован. *Слив Маркове Реке*, Скопје, 1958.

Ymeri, Haki. *E folmja e Karshiakës*, Shkup, 1998.

https://gruppostudentescoalbanesemilosao.files.wordpress.com/2014/12/anuni_i_leke_dukagjinit.pdf , 11.2.2019.

Fjalori Elektronik Shpjegues.

Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006.

VEBI BEXHETI

Universiteti i Evropës Juglindore - Tetovë

DASMA NË VESHALLË TË TETOVËS

Që nga dita e fejesës, kur nusja llogaritet "nër nishane", e deri në dasëm, kur edhe merret nusja, në familjen e djalit, në katundin Veshallë, zhvillohen një sërë ceremonish, por momentet që llogariten si fillimi i dasmës janë: Qërimi i drithit, Dërgimi i teshave (petkave) dhe Zënia e kulaçit.

Dita e drithit është një segment shumë i rëndësishëm i dasmës së këtij katundi, që në mënyrë solemne e zyrtarizon fillimin e Dasmës së martesës. Nga kjo ditë, një javë para ditës së marrjes së nuses, të gjithë anëtarët e familjes, fqinjët dhe më të afërmit i marrin detyrat e veta, bëjnë mbledhje të vazhdueshme dhe sjellin vendime se si do zhvillohet ecuria e dasmës. Gjatë periudhës kohore nga "drithi" e deri dy ditë pasi të merret nusja, në shtëpinë e dhëndrit, vajzat e familjes e të fqinjve, bashkë me ato të fisit, vetëm këndojnë e luajnë me dahire. Nga "dita e drithit" zgjidhen edhe dahirexhi (defatoret), me të cilat përcillet edhe kjo ceremoni. Për dahirexhie zgjidhen dy vajza, përafërsisht me moshë dhe shtat të njëjtë, me qëllim që të plotësohet edhe kushti estetik, që njëherit do e zbukuronte edhe dasmën në tërësi. Këto specialiste të dahires, që gati se çdo ditë do jenë të pranishme në shtëpinë e dasmorit, nuk paguhen, por në njëfarë mënyre shpërblehen me dhurata të ndryshme nga ana e nuses dhe e familjes së dhëndrit, ashtu si edhe "magjatores", të cilat me kohë i fillojnë përgatitjet për bukën e dasmës.

Për këtë ditë nuk thirren burrat, por vetëm vajzat dhe gratë, sepse pa to as që mund të nisë ceremonia. Në këtë katund është traditë që burrat dhe të rinjtë, të paftuar të shkojnë te shtëpia e dhëndrit për

t'ia uruar kryefamiljarit fillimin e dasmës, me fjalët: "Për hajr u koftë", të cilëve u përgjigjet "Kofsh shënosh, njëfshna edhe te ju". Në Veshallë nuk është traditë që me këtë rast të të pranishmëve t'u shtrohet bukë, por ato priten me kafe, llokum dhe cigare. Derisa gratë dhe vajzat janë duke u marrë me punën e drithit në lëmë, burrat hynë brenda në odë, për të qëndruar pak kohë, deri sa të vijë një vajzë më e vogël ose ndonjë djalë me shoshën me drithë të përzier me lule, që duhet ta, "daritin" të pranishmit dhe pastaj të shpërndahen. Në lëmë e shtrojnë një mutaf, ku e grumbullojnë drithin të përzier me lule dhe me para monedhash hekuri.

Ardhja e njerëzve për të uruar vazhdon deri sa zgjat qërimi i drithit përmes shoshjes, që më pastaj të ngarkohet në kalin e zbukuruar me frerin me lule, për në mulli. Vajzat që vazhdimisht këndojnë këngë për këtë rast, vallëzojnë dhe u bien dahireve, pasi të dërgohet drithi në mulli, paratë që janë mbledhë nga burrat, i ndajnë së bashku. Ashtu si zakonisht, edhe ceremonia e fillimit të dasmës, e quajtur "Dita e drithit" i la gjurmët e veta në vargun popullor, që sot janë dëshmia më besnike që tregon të vërtetën e plotë rreth këtij akti paradasmor. Këngët që i këndojnë vajzat janë krijime populllore origjinale të zonës që karakterizohet me veçoritë specifike. Meqë bëhet fjalë për një katund tipik malësor dhe deri vonë pa asnjë infrastrukturë rrugësh automobilistike, në asnjë varg nuk përmen-det vetura, qerrja, ose ndonjë mjet tjetër, karakteristike për punët fushore të rrafshit. Këngët që këndohen me këtë rast, përmes atmosferës festive, si në çdo pjesë tjetër të dasmës, kanë edhe karakter përshkrues të ngjarjes dhe veprimeve, që nga fillimi i ceremonisë, pa përjashtuar edhe dialogun e improvizuar me nusen që ende është në shtëpinë e prindërve. Në këto vargje i hasim edhe ngacmimet e prindërve dhe shoqeve të saj, që do u largohet e dashura e tyre. Sipas traditës, mullixhiu nuk duhej të merrte ujë për bluarjen e drithit që bluhej me këtë rast, sepse besohej se bere-

qeti i familjes së re do shkonte te mullixhiu. Meqë nuk ishte adet që mullixhiu të marr ujë për këtë shërbim, atij i jepej ndonjë dhuratë që mund të ishte ndonjë marhamë, ose ndonjë para krejt simbolike. Drithi i grumbulluar në lëmë ishte i përzjer me lloj lloj farërash lulesh të ndryshme dhe sheqerka, që zakonisht simbolizojnë jetën, që të rinjve duhej tu shkoi ëmbël.

Gjatë këngës nga vajzat, që në valle rrotulloheshin rreth drithit të përzjer edhe me para monedhash, vazhdimisht përmendej nusja me lloj lloj epitetesh si: qibare, fodulle, gjizeli, gjelini etj. (gjizeli dhe gjelini, nga turqishtja, me kuptimin, e bukura dhe nusja). Ashtu si moment i ndërrimit të nishaneve, kur fejesa shpallet publike përmes krismës së pushkës, edhe gjatë qërimit të drithit, qitet me pushkë, pasi të jetë përzjer ky grumbull drithi me tytën e pushkës nga ndonjë burrë. Kjo qitje me armë është shenjë se dasma edhe zyrtarisht ka filluar dhe përfundimisht ndërpritet shpresa e ndonjë ish të dashurë të djalit se mund të jetë e tij : *Ani krejsi pushka duël tejmi, / ani çaron drith Besnik trejmi. / Ani krejsi pushka duël flaka, / ani çaron drith Besnik aga*. Edhe me këtë rast, të qitjes së dytë, pas asaj të shpalljes së fejesës, jehona e zërit të krismës, vjen si rrufeja në veshët e vajzës e cila me të shpjet, ashtu e tronditur del te dera, në lëmë dhe te pojata, për t'i treguar nënës së vet për shqetësimet që ndjen me këtë rast. Që nga dita kur qërohet drithi, vajza e fejuar duket gjithmonë rrallë e më rrallë. Ajo tani më turpërohet të dalë edhe ndër shoqe sepse don të largohet nga jeta e vajzërisë si në heshtje, pa u vërejtur nga ata që e rrethojnë. Ja disa vargje të shënuara po në Veshallë për këtë ceremoni, ku përmenden paratë, lulet e melit, lulet e lirit, dhe lulet e kënës, duke i kombinuar me epitetet e nuses së ardhshme, si: qibare, fodulle, gjizeli et, por edhe duke e ngacmuar kur ia përmendin nënën dhe ndarjen prej saj ; *Da çarojna drithin me pare, / për tauj imi nejs oj qibare. / Da çarojna drithin me lule, / për tauj imi nejs oj fodulle. / Da*

çarojm drithin me fara lule meli, / mas ni jave Agim aga, do t'veje gjizeli. / Da çarojm drithin me fara lule lini, / mas ni jave Agim aga do t'veje gjelini. / Da çarojna drithin me lule kone, / si do dahesh e mejro pi none.

Përmes vargjeve, kushtuar këtij momenti shumë të rëndësishëm për fillimin e dasmës, vajzat pjesëmarrëse në këtë ngjarje solemne vazhdojnë dialogimin me vajzën e fejuar, e cila i ka ditët e numëruara në shtëpinë e prindërve. Këto këngë, edhe pse në qendër të vëmendjes e kanë nusen, atë dhe shoqet e saj i godasin vazhdimisht, duke i quajtur, dosa e kurva, ndërsa ato të familjes së djalit i lavdërojnë, duke i konsideruar edhe të pasur, sepse kanë pasur mundësi që sheqerin e kuq të përzier e kanë blerë nga Gostivari, madje edhe nga Selaniku:

Da çarojm drithin me shosha, / si do jese vet shoçe dosa. / D'a çarojna drithin me dërmona, / ori motër kurva mejr ta bona. / Do t'a çarojm drithin pi hamarit, / me sheqer të kuç pi Gostivarit, / Do t'a çarojm drithin pi sënejki, / me sheqer t'kuç pi Selenejki. / As mos u hidh e mejro, as mos u përdrih, / a të kan gjoftoue se do çarojm drith. / Mu më ka gjoftoue nona e baba, / do çaroje drith Agim aga. / Mu m'ka gjoftoue vëlla derri, / do çaroje drith Agim dilberi.

Nga lajmi i parë përmes krismës së pushkës, se vajza ishte fejuar, në këtë moment ajo tronditet sërish nga ushima e krismës së dytë, që asaj ia bën me dije se në derën e babës do qëndrojnë vetëm edhe disa ditë. Vajzat e kuptojnë edhe këtë përjetim të sajën që atë e trondit, prandaj përmes këngës vazhdojnë ta provokojnë, madje duke u shpreh me gjuhën dhe ndjenjën e saj, kur i drejtohet nënës së vet, posa e kuptoi se i qërohet drithi: *Me irish nouse lulja duël te dera, / do ma çarojn drithin njera un e njera. / Me irish nouse lulja duël në lom, / do ma çarojn drithin non mori non. / Me irish nousja, duël te pojata, / do ma çarojn drithin njera un e ngrata.*

Ashtu si në shumë këngë tjera lirike, edhe në këtë rast, autori anonim, që di të krijojë aq bukur, nuk e la pa e përmendur edhe mulloxhiun, i cili është personazh i ngjarjes, edhe pse në këtë rast atë e ofendojnë, duke e quajtur edhe hajdut, madje me dyshimin se mund ta marrë mësysh kalin e ngarkuar, por edhe ta humb këtë drith jo të zakonshëm, që simbolizon zënien e një familjeje të re. *Dil mullojxhi, dil tej përpara , / t' na i thauësh kalit mashalla. / Ore mullojxhi, ore hajdut, / drithin e nouses mo na e hup, / se do bajna buk ore me nahut.*

Nga dita e "drithit", vajza që po i numëronte ditët si beqare, nuk del ndër shoqe, e vetëdijshme se çdo gjë që lidhej me shoqërinë mes beqareve po merrte fund. Ja si e përshkruan kënga popullore gjendjen e saj, ashtu të vetmuar: *Oj Selvije honëm, lule gjroshe, / oj e mejro pse nuk del nër shoçe. / Pse nouk del nër shoçe oj delije, / do ma çarojn drithin, nouk m'ka hije. / Pse nouk del nër shoçe oj qibare, / do ma çarojn drithin më vejn marre.*

Pasi qërohet drithi, që nënkupton edhe pastrimin nga monedhat e hekurta dha ato të letrës, nga lulet dhe sheqerkat, futet në dy thasë, ngarkohet në kalë dhe niset për në mulli. Në Veshallë dikur punonin pesë mullinj, dy në lumin në hyrje të katundit, e njohur nda vendësit si "Reka e Baçejlles" dhe tre në lumin tjetër, ku kalon rruga për në Bozovcë, i njohur si "Reka e urës Kollit", ose si "Reka e Kishës". Në kohën kur punonin të gjithë mullinjtë, ashtu si për nevojat e përditshme, edhe drithi i dasmës bluhej në mullirin më të afërme të lagjes së katundit. Disa mullinj pushuan shumë më herët së funksionuari, disa më vonë, ndërsa guri i të cilit pushoi i fundit së rrotulluari, ishte "Mulliri i Ferikut" ose i Berzatit (Feriku dhe Berzati ishin vëllezër), që gjendej në pjesën e poshtme të rrjedhës së Rekës së Baçejlles, të quajtur edhe si "Reka e Bregjit". Ashtu si në shumë katunde, ku me kohë pushoi kjo veprimtari që jepte jetë e që ishte gjithmonë në shërbim të popullatës, edhe në Veshallë,

pushoi kjo veprimtari, por tradita e qërimin të drithit vazhdoi në një farë mënyre deri në ditët e sotme, edhe pse ngarkimi i drithit të qëruar në kalin e zbukuruar plot me lule me përcjelljen e vajzave me këngë e valle, tani më është çështje improvizimi sepse pas një shëtitjeje nëpër rrugët e lagjes, kali me drithin në samar, i përcjellë nga vajzat gazmore, kthehet sërish aty prej ku ishte nisur, madje kohëve të fundit, sa për adet, ky drithë nuk ngarkohet në thasë por në duqi. Kulaçi tradicional i dhëndrit dhe i nuses, bukët, e dikur edhe petat për ushqimin e mëngjesit të të grishurve(të ftuarve në dasmë), gatuhej nga mielli i këtij drithi, që me aq ceremoni përgatitej për mulli, ndërsa më vonë, me ndërprerjen e mullinjve dhe ndryshimin e mënyrës së jetesës, të gjitha këto gatime përgatiteshin me miellin e blerë në qytet, ndërsa shumë më vonë edhe buka blihej e gatshme. Nga dita kur qërohet drithi e deri në ditën e marrjes së nuses, përveç atmosferës festive në shtëpinë e djalit, vazhdimisht bisedohet nga i tërë katundi për dasmën, se sa do jetë e madhe ajo, a do ketë të grishur edhe nga katundet tjera, a do ketë "seri" me pehllivanë, e kështu me radhë.

Zënia e kulaçit

Është gjithashtu një pjesë shumë e rëndësishme e një varg ceremonish, e periudhës, nga "nishanet" e deri sa të mbarojë dasma. Kulaçi zihet (të nxënit e kulaçit) një ditë para dërgimit të teshave (petkave) në shtëpinë e djalit, dikur ditën e diel pas dite, kur nusja merrej ditën e enjte, ndërsa nga koha e zhvendosjes së marrjes së nuses, nga e enjtja në të dielën, kulaçi zihet ditën e enjte. Kjo hallkë e zinxhirit të gjatë të këtyre ceremonive, siç vërehet, është vazhdimësi e ngjarjes së qërimin të drithit sepse ky gatim, që në pamje duket si një bukë më e vogël, bëhej nga mielli i atij drithi. Për punën e kulaçit zhvillohen një sërë aktivitete, duke filluar nga caktimi i vajzave kulaçore të cilat duhet të jenë të afërta me

familjen e dhëndrit, për shkaqe sigurie, mbushja e ujit nga tre krojet dhe ngrohja e tij në zjarrin që nuk duhet të jetë shumë i fortë, madje ai nuk duhet të ngacmohet që të marrë flakë sepse mendohej se edhe bashkëshortëve të rinj mund t'u "shkojë flaka" (të kenë zënka gjatë jetës), te mbajtja në dorë e kuisë me ujë gjatë ngrohjes dhe një sërë adetesh e pokushesh tjera të cilat duhet të jenë në shërbim të mirëvajtjes së rrugës jetësore të bashkëshortëve të rinj, e deri te ngjarja e mëngjesit kur nga nusja dhe dhëndri thyhet ai. Nga bisedat me më të vjetrit rreth këtij fenomeni me një sërë elementesh pagane, siç është edhe zjarri, mësuam se ky zjarr që ndizet për ngrohjen e ujit të zënies së kulaçit nuk duhet të fiket për asnjë moment, deri në mbarim të dasmës dhe si i tillë duhet të jetë edhe në shërbim të gatimeve tjera që kanë të bëjmë me dasmën. Sipas rrëfimeve të këtyre subjekteve, uji për zënien e këtij kulaçi, që simbolizon bereqetin, mirëqenien e familjes dhe jetëgjatësinë bashkëshortore të çiftit të ri, duhej të mbushej në një enë bakri. Kusia me këtë ujë nuk duhet të lëshohet në tokë sepse mund t'ia thyejë këmbën "qoftëlargit", që më pastaj të hakmerrej kundër bashkëshortëve të rinj, madje kjo kusi edhe kur vihet në zjarr për t'u ngrohur, duhej mbajtur në dorë nga njëra prej tri vajzave. E tërë kjo procedurë zhvillohej pa folur këto vajza me njëra tjetrën, deri sa të zihet kulaçi. Kjo heshtje përgjatë procesit të përgatitjes së kulaçit e kishte edhe kuptimin e vet. Nëse gjatë kësaj pune bëhej zhurmë, mund të dëgjonin shpirtrat e këqij, nga të cilët besohej se do ndërmerrnin ndonjë aktivitet kundër mirëqenies së bashkëshortëve të rinj. Heshtja e këtyre kishte edhe një shpjegim tjetër, që kishte të bëjë me harmoninë mes dy të rinjve që martoheshin, në të kundërtën, ato do kalonin jetë jo të qetë. Të gjitha këto adete e pokushe zgjasin deri sa mbaron puna e zënies, kur në brendinë e brumit të tij futet një monedhë metali, që do përcaktojë pushtetin e më të fortit, mes nuses e dhëndrit, kur çifti i ri në mëngjesin e natës së parë të martesës do e thyejnë kulaçin me dy pjesë, në njërin nga

të cilat do ndodhet kjo monedhë. Pasi të jetë zënë dhe pjekë kulaçi, kuptohet duke i respektuar të gjitha rregullat që kërkonte tradita, ai ruhet në ndonjë vend të sigurt nën kujdesin më të madh që mos të thyhet deri në momentin kur duhet ta thyejë çifti, sepse thyerja e tij para kohe nuk ishte ogur i mirë për nusen dhe dhëndrin. Nëse ndodhte që të thyhet ai, patjetër të zihej një tjetër kulaç, por pa ceremonitë e të parit. Siç shihet, kulaçi dhe tërë ceremonitë rreth tij janë të një rëndësie të veçantë për çiftin, për fatin e tyre në jetën e përbashkët dhe formimin e familjes së re. Edhe për këtë rast, krijuesi popullor thuri vargje, si dëshmia më besnike dhe objektive për rëndësinë etno-kulturore të kësaj pjese të procesit të dasmës së martesës: *E zaum kulaçin me pare, / për tauj imi nejs oj qibare. / E zaum kulaçin pa bo zo, / T'kimi xhet të heshme, / ma t'mejrën n'dunjo.*

Nga vetë fakti që pjekja e kulaçit bëhet të enjten pas dite, ndërsa thyerja e tij, të hënën në mëngjes, tregon se kjo bukë e vogël nuk është për t'u hëngër por roli i tij është krejt tjetërfare që simbolizon edhe zënien e jetës së re të nuses dhe dhëndrit. Me thyerjen dhe gjetjen e parasë së fshehur në brendi, mbaron edhe misioni i tij, prandaj në disa vargje që i kemi shënuar në Veshallë mësojmë se si shoqet e përqeshin edhe vet kolaçtoresh me fjalë ofenduese, të bindura se ajo me këtë rast nuk u hidhërohet: *Mori soj pa lame e me skërlep, / mo na e losh kulaçin pa pek. / Mori soj pa lame e thoj pa preme, / nauk ta ham kulaçin oj eveqe.*

Dërgimi i teshave (Me i çue petkat)

Një ngjarje shumë e rëndësishme dhe e fundit që i përmbyll aktivitetet fejesore, është dita kur "petkaxhinjtë", nga familja e dhëndrit në mënyrë shumë të organizuar i dërgojnë teshat te shtëpia e nuses, të cilat sërish kthehen në shtëpinë e burrit, ditën e shkuarjes së saj nuse. Pritja, organizimi dhe përgatitja e ushqimit të petkaxhinjve

ishte brenga më e madhe e vajzës, që nga dita e fejesës së saj. Nga shumë shkuarjet andej-këndëj të familjeve që kishin lidhur krushqi, kjo ditë dallohej për seriozitetin që kishte, që nga zgjedhja e të ftuarve që zakonisht ishin burra më në moshë e deri te misioni që kishin ata në këtë ditë që do mbahej mend. Petkaxhinjtë, ashtu të përgatitur mirë, numri të cilëve, patjetër edhe në këtë rast duhej të ishte tek, sillej nga trembëdhjetë deri tetëmbëdhjetë, gjithsesi duke e llogaritur edhe hoxhën e katundit dhe një djalë të vogël, i cili edhe në këtë rast simbolizon lindjen djalë të fëmijës së parë. Burrat e planifikuar shumë më herët, numërimi disa herë i tyre, deri sa të vendoset ai përfundimtar, pasi ta ketë miratuar edhe miku, thirrshin dy tri ditë para ditës kur duhej të nisin. Krahas kësaj përgatitjeje, një gjë të këtillë e bënte edhe familja e nuses, të cilët e mbanin barrën më të madhe për këtë rast, sepse ata përveç organizimeve tjera, duhej ta bënin edhe bukën. Edhe pse numri i petkaxhinjve ishte i përballeshëm për përgatitjen ushqimit nga vetë ato të shtëpisë, në shumë raste merrnin kuzhinierë (açojë) burra, të njohur të katundit për punën e tyre profesionale edhe për bukën e dasmës.

Burrat e ftuar, që më tepër ishin farë e fis të dhëndrit, pa i përjashtuar edhe fqinjët, grumbulloheshin një deri dy orë para nisjes, në ndërkohë pinin nga një kafe dhe bënin muhabet deri në momentin e nisjes në kohën e saktë që te miku të jenë rreth drekës, në orën e caktuar nga babai i nuses, pa asnjë vonesë. Nëse nusja nuk ishte e të njëjtit katund, petkaxhinjtë niseshin shumë më herët, duke e planifikuar kohën e kthimit në shtëpi, para se të vijnë lodraxhinjtë të cilët sipas traditës, në katund vinin ditën e njëjtë. Të afërmit e familjes së djalit, zakonisht gratë, duhej patjetër të shkojnë për urime te shtëpia e dasmorit me ndonjë bakshish, që mund të ishte fare i thjeshtë e deri te ato që kushtonin më shumë, e që i dërgonin më të afërmit, si: lira (monedhë ari e Perandorisë Osmane) dhe

zbukurime tjera ari, pa përjashtuar edhe tesha si: jorgan, bataniye, complete mbështjellësish të shtrojave, enë të ndryshme, si p.sh tepsi bakri, ndërsa kohëve të fundit complete takëmësh për kuzhinë: pjata tenxhere, apo më të afërmit edhe fshesë me rrymë, e të ngjashme. Dy tri ditë para nisjes së teshave, vajzat dhe gratë e familjes i palosnin ato, në mënyrën që të zënë sa më pak vend në dy arkat (sandëqet) që do ngarkoheshin në njërin kalë, të mbuluar me qilim ose me ndonjë sixhade. Në dy arkat paloseshin zakonisht veshjet e nuses, gjërat individuale të arit dhe paja (darija), me gjërat më të imta si, çorapët, këmishët, kovrakët dhe çevret e qëndisura, të cilat ngarkoheshin dhe mbuloheshin. Në kalin tjetër ngarkoheshin zakonisht teshat e shtratit, si: dyshekët, jorganët dhe jastëkët e odës. Ky tip jastëkësh ishin me gjatësi rreth një metër, me mbështjellës prej kashniku me dy liç, me ngjyrë gjaku dhe me yllin tradicional me gjashtë cepa, të ngjashëm me atë izraelit, edhe pse mungon një shpjegim i mirëfilltë për këtë simbol. Këta jastëkë nuk ishin praktikë për të fjetur, sepse në brendi ishin të mbushur me kashtë nga dujt e thekrës. Ato zakonisht mbështeteshin mureve të dhomës (odës) në tre, madje edhe në katër anët e saj, ku ndërpriteshin të dera, që shërbenin për t'u mbështetur mysafirët, deri sa rrinin ulur këmbëkryq mbi postaqi. Kompletet për një dhomë mbërrinte përafërsisht nga 10 deri 15 sosh. Këta jastëkë renditeshin në dhomat për mysafirë, të cilat duhej patjetër të ishin të shtuara me hastra e të mbuluara me mutaf, nëse nuk ishin të mbuluara me dysHEME dërrasash.

Mbasi konstatohej se kanë ardhur të gjithë të ftuarit, ngarkohen kuajt që zakonisht mund të jenë 2 ose tre. Nëse nusja ishte e një katundi më të largët si p.sh, Vica, Shipkovica, apo edhe më larg, të gjithë petkaxhinjtë shkonin hipur në kalë. Në Bozovcë, madje edhe deri në Brodec, dy katundet më të afërta për Veshallën, shkohej edhe në këmbë. Derisa petkaxhinjtë nisnin për te miku, pasi e kis-

hin bërë planin se cilës udhë duhet të shkojnë, nuk pushonin së kënduari vajzat të cilat bashkë më dahire i përcillnin deri në kufi të lagjes. Nga vargjet që këndohen me këtë rast, mësojmë se rrugët që çojnë deri te shtëpia e vajzës e cila është në prag të shkuarjes nuse, janë të ndryshme, por që të gjitha çojnë te shtëpia e saj. Përmes vargjeve lirike, sa të dhimbshme aq edhe tronditëse, mësojmë gjithashtu se vajza që i numëron ditët e fundit të vajzërisë, është tepër e shqetësuar, e vetëdijshme se shumë afër është dita kur ajo do i thotë lamtumirën shtëpisë së prindërve. Në këto momente tronditëse ajo mbështetjen e kërkon te nëna, me shpresë se ajo mund t'a ngushëllojë, duke e mbajtur edhe ndonjë ditë në shtëpinë e vet: *Di çojm petkaxhit udhës epër, / do krejsin pishtollat për s'tepër / Di çojm petkaxhit udhës lure, do t'i bien petkat oj fodulle. / Di çojm petkaxhit udhës zene, / për tauj jon nejs oj besleme. / Di çojm petkaxhit nizetepes vet, / nizetepes vet kur dë nejsin, / kit me pishtolla do krejsin. / Rauëm mori non se d'om morrën, as s'të rouj oj bijo, as s'të prouj, / gjali darsmën e ka nejs për tauj.*

Ashtu siç theksuam më parë, dreka e petkaxhinjve duhet të dallohet nga të gjitha gatimet tjera, prandaj brenga e nuses se mos turpërohet me këto mysafirë specialë është e arsyeshme. Këngët me vargje që e thumbojnë pamëshirshëm familjen e nuses së ardhshme të tyre, nuk mungojnë edhe në këtë rast, madje ato të familjes së djalit, krahas thumbimit të asaj të vajzës, nuk e kursejnë as edhe tërë lagjen, duke i quajtur edhe si kallajxhi (Fisn. Në të shumtën e rasteve kallajxhinjtë ishin rom, që profesion e kishin kallajisjen. Përmes dialogut të improvizuar poetik popullor, del se ago baba është i përgatitur për çdo situatë, madje të shkojë edhe me harxhin e vet, nëse ato nuk ishin në gjendje t'i përballojnë këto shpenzime: *E mori mahalla kallajxhive, / a du bajni buk petkaxhive ? / A du bajni ju, a du bajna vet, / vejn ago baba me harrxhin e vet, / kafen e sheqerin ai i ka në xhep.*

Ironia që sjellin këto vargje nuk ka të ndalur, edhe kur familja që pret petkaxhinjë e ka bërë të pamundurën që drekën ta bëjë sa më të mirë. Nëna e nuses brengoset se ndoshta sheqerparja si ëmbël-sirë, që shumë vonë filloi të gatuhet në këto katunde të thella të malësisë, nuk do jetë e mjaftueshme për mysafirët: *Xhi ka nona nouses xhi hi e xhi del, / njera un e njera sheqerparja s'ëm del, / Nona nauses mos u bon budalle, / bajshe ni temcoj ma të madhe, / ather sheqerparja do t'dale.*

Te këto këngë hasim edhe vargje ku në njëfarë mënyre kuptohet se ato të familjes së dhëndrit ankohen se janë harxhuar shumë deri sa i kanë kompletuar të gjitha teshat sipas traditës. Punimet me pej ari (sermi) të takëmit të kompletuar të veshjes së nuses, kishin kushtuar shumë, prandaj vajzat i drejtohen edhe dasmorit për këto harxhime të tepruara. Brenda këtyre vargjeve e hasim edhe përgjigjen modeste të nuses, e cila në frymën e kursimeve që është dashur t'i ketë parasysh familja e burrit, shprehet se me të vërtet nuk ka pasur nevojë për gjithë atë salltanat. *Do ti' çojm sontijet me shirita, / kit mollin për tauj e harrxhita. / Kit mollin për mu be dilber, tej mos e harrxhit, / çomi sontijet gjalo pa shirit.*

Edhe familja e vajzës është e përgatitur mirë për t'i pritur këto mysairë jo të zakonshëm. Ato thirrin gjithashtu mysafirë për t'i pritur petkaxhinjtë, që mund të jenë farë e fis dhe fqinj të cilët dalin para dere që t'i presin, përveç atyre më të moshuarve, që rrinë brenda në odë. Pas ceremonisë së shkarkimit të teshave, nga kuajt, ku gjithashtu këtë shërbim duhej ta bënin të rinjtë me babë dhe nënë, mysafirët futen brenda në odë ku priten me kafe, e më vonë ua shtrojnë sofrën. Një pjesë e të ftuarve nga ana e nuses që për nga numri mund të jenë edhe më tepër se mysafirët, u bëjnë muhabet petkaxhinjve, madje ulen në sofrën e përbashkët, ndërsa pjesa tjetër, ato më të rinjtë hynë në një dhomë tjetër ku gjithashtu u shtrohet sofa. Ushqimi i petkaxhinjve ndryshon nga ai i dasmës.

Edhe me këtë rast, deri vonë të gjithë të pranishmit hanin në një pjatë (sahan), që ndërroheshin njëra pas tjetrës. Në Veshallë nuk ishte traditë që në sofrën e shtruar të shërbehej me supë ose sallatë. Haja e parë ishte ajo e pjatës me groshe me mish, e dyta, ajo e lakrës e përzier me pak oriz, ndërsa e treta me jani. Në të gjitha këto pjata kishte edhe mish, të cilin njëri ua ndante të gjithëve. Për dallim nga gatimet e zakonshme për raste dasmash, për petkaxhinjtë ka edhe ushqime shtesë, siç është edhe mishi i pjekur, zakonisht, ai i qengjit. Për këto raste, kur nuk respektohet rregulla e tre gjellërave tradicionale, në ne vend të groshës ose lakrave të ketë "birjan" (mish oriz), me një grumbull mish qengji, deleje ose dashi në mes, në ç'rast asnjëherë nuk mungonte koka e tyre. Edhe në këtë rast "kryet" i jepeshin njeriut më të respektuar, zakonisht hoxhës i cili si person zyrtar që është, i kryen ceremonitë fetare, si, duanë e sofrës dhe kurorëzimin, sipas variantit fetar.

Kurorëzimi (niqahi) i çiftit të ri nuk është rregull e përhershme që të bëhet me këtë rast. dikur ky kurorëzim bëhej që në kohën e fejesës, madje kur bëhej edhe kurorëzimi ligjor administrative, para autoritetit zyrtar shtetëror. Bashkë me petkaxhinjtë, te familja e vajzës shkonte edhe hoxha i katundit, sepse pa te nuk mund të kryheshin ceremonitë fetare, siç ishte duaja e sofrës dhe kurorëzimi fetar. Kishte raste kur hoxha ftohej nga ana e nuses, sidomos kur ai takonte mëhallës së nuses ose ishte farefis me familjen e saj. Babai i djalit, ose në mungesë të tij, vëllai më i madh ose ndonjë tjetër person, familjar i tyre, pasi mbaron ushqimi dhe bëhej duaja e sofrës, hidhte para në te (e daritte sofrën). Me këtë rast ishte traditë që pas duasë të thuhej: "Zoti muhabetin", duke aluduar te dy të rinjtë që martoheshin. Edhe në Veshallë, si në shumë katunde tjera të rajonit dhe më gjerë, disa nga mysafirët, sidomos ata më të rinjtë, para se të bëheshin gati për të dalë, në mënyrë të fshehtë merrnin diçka me vete. Sipas adetit, ata fshihnin ndonjë

filxhan kafeje, lugë, taketuke për cigare dhe të ngjashme. Edhe nëse vihej re kjo "vjedhje" nga nikoqirët, ata bënin se nuk e kanë pare sepse nuk kishte kuptim për gjëra të vogla të plas sherri që në fillim të kësaj miqësie, të vetëdijshëm se një gjë të këtillë, do përsëritej edhe në shtëpinë e dhëndrit, me rastin e shkuarjes për "s'pari herë". Ka pasur raste kur ato të familjes së nuses, pasi kanë konstatuar mungesën e këtyre gjësendeve, i kanë kërkuar, madje kanë këmbëngulur në kthimin e tyre. Nuk ishin të rralla rastet kur edhe ato të vajzës, sidomos ata më të rinjtë, u bënin dëm mysafirëve. Derisa petkaxhinjtë ishin ende brenda, ka ndodhur që të rinjtë t'u presin kuajve jelat (grivet) dhe bishtin, ose t'i lidhnin nyja "bishtat" e kërpesheve. Këto skandale ishin më të rralla por të vjetrit rrëfenin për provokime të kësaj natyre, që gati se i kanë luhatur raportet midis tyre, madje që e kanë vënë në pikëpyetje edhe procesin e mirëvajtjes së dasmës. Në raste të këtilla njerëzit e familjes së djalit ishin gjithmonë më tolerantë ndaj asaj të nuses së tyre sepse ende vareshin prej tyre.

Teshat që i sjellin petkaxhinjtë, vajzat i ndejnë atë ditë nëpër murret e dhomave, në mënyrë që sa më mirë vizitorët, sidomos gratë t'i shohin e t'i komentojnë sipas vlerësimit të tyre. Në të njëjtat hapësira, vajzat e shtëpisë shtrinin edhe teshat e bëra nga vet nusia. Pasi mbarojnë të gjitha ceremonitë, petkaxhinjtë dalin nga shtëpia e nuses me përcjellje dashamirëse, duke vazhduar bashkë një pjesë të rrugës, për t'u ndarë më pastaj drejt shtëpive të tyre. Nga ky moment shpërndahen edhe ato që në këtë rast ishin si prietës, për t'u kthyer sërish ditën e përcjelljes së vajzës për në shtëpinë e dhëndrit sepse ata, njëherësh ishin edhe si përcjellësit e saj. Me rastin e përcjelljes së vajzës, ato nuk thirreshin sërish, por meqë kishin qenë të ftuar ditën e petkave, e ndjenin obligim që duke "u pjekë" me vajzën, edhe ta "daritnin" me një shumë të hollash atë.

NEBI DERVISHI

Universiteti i Tetovës

DASMAT STRUGANE DIKUR DHE SOT

Martesa është një ngjarje e rëndësishme e jetës së njeriut që lidhet me shtimin e familjes dhe me vijimin e jetës njerëzore.

Në përgjithësi, në Strugë e rrethinë, si dhe në tërë trevat shqiptare, andej e këndej kufirit politik shqiptaro-shqiptar, martesa e fëmijëve tradicionalisht u përkiste prindërve. Ata e kishin në dorë plotësisht fatin e fëmijëve të tyre. Në familjen patriarkale strugane, si vajza ashtu edhe djali, në të kaluarën, nuk kishin asnjë të drejtë të zgjidhnin fatin e tyre. Gati në çdo martesë vëreheshin vajza të mjera që jepeshin për persona që nuk i njihnin fare, por edhe anasjelltas: djemtë, shpesh herë, martoheshin me vajza që s'i kishin parë asnjëherë.

Në pellgun e Ohrit, në të kaluarën, vajza, me të mbushur moshën 10 vjeç, nuk lejohej të dilte jashtë mureve të shtëpisë. Vizitat e tyre ishin shumë të kufizuara, ato mund të shkonin vetëm te dajallarët dhe xhaxhallarët, por edhe atëherë të shoqëruara nga dikush dhe të mbuluara me ferexhe. Në shtëpi kishin të drejtë t'u dilnin vetëm kushërinjve të parë (nga lidhja e babait dhe e nënës). Gjatë kohës që qëndronin në shtëpi vajzat merreshin me punë të ndryshme shtëpiake: qepnin, gatuanin, kujdeseshin për fëmijët e vegjël të familjes dhe fillonin, pak nga pak, të përgatitnin pajën e tyre.

Synimet kryesore, kur kërkohej një vajzë për nuse, ishin që vajza të ishte nga fis i mirë, pra, derë "oxhaku" e shtëpi punëtore. Kjo do të thoshte që nusja të ishte në atë rang në të cilën bënte pjesë edhe dhëndri. Secila familje, me anë të martesës, kërkonte të forconte pozitën e saj shoqëro-ekonomike, duke lidhur krushqi me familje

të forta e të pasura. Bukuria, mosha etj. ishin gjëra sekondare, pra të dorës së dytë. Duke u nisur nga këto premisa, zgjidhja e këtij problemi kaq të rëndësishëm, shpesh herë, shkaktonte pasoja të rënda në familje.

Martesa, si një proces që ka mbijetuar prej kohëve më të lashta, me ritet dhe ceremonitë e shumta dhe të larmishme, sjell elemente që kanë prejardhje dhe rëndësi të veçantë etnografike. Këtu hyjnë ritet e njohura të përpjekjeve të dhëndrit dhe të nuses, kundërshtimi i nuses, ndarja e saj nga gjiri dhe nga shtëpia e babait, akti i përcjelljes së nuses, pritja e saj në shtëpinë e dhëndrit (burrit) dhe shumë ceremoni të tjera që bëhen me këtë rast.

Duke bërë përshkrimin e dasmës strugane, kalimthi do të ndalemi në çastet e saj më të rëndësishme dhe do të përpiqemi të japim shpjegimet e rastit, gjithmonë sipas të dhënave të mbledhura në rajonet e fshatrave të Strugës.

Me të arritur djali në moshën e martesës, prindërit dhe të afërmit tjerë fillojnë të mendohen e të bisedojnë për të. Në rrethin e Strugës mosha mesatare e martesës ka qenë: për vajzat 16 - 20 vjeç, ndërsa për djemtë 20 - 25 vjeç. Kur djali ishte i vetëm, shpesh, martohej në moshë të re. Por, në qoftë se djali kishte motra më të moshuara, ai nuk mund të martohej përpara tyre, pavarësisht nga ndryshimi i madh i moshave që mund të kishin. Po të ndodhte që ndonjëri të martohej pa nxjerrë motrat, sjellja e tij përbufej dhe ai do të quhej njeri i paturp.

Prindërit dhe të afërmit e djalit, pasi të kishin marrë edhe pëlqimin e fisit, kuvendonin gjerë e gjatë mos vallë me familjen e vajzës mund të ketë pasur ndonjë hasmëri, mosmarrëveshje apo ngatërresë. Në rajonin e Strugës, para se të shkonin te personi që ishte caktuar për të kërkuar vajzën, në mënyrë tradicionale babai ose nëna ia komunikojnë djalit vendimin që kanë marrë. Siç tregojnë,

nga ana e djemve nuk ka pasur ndonjë rast kundërshtimi, por edhe nëse ka pasur, ato kanë qenë tepër të rralla. Djali gjithmonë këto lajme i ka pritur me turp dhe me kokën ulur, duke iu nënshtruar fatit të tij. Mandej caktonin shkesin (shkuesin) që do të ndërmjetësonte. I ngarkuari për të kërkuar vajzën në rrethin e Strugës, gjithmonë kishte lidhje afërsie ose miqësie me familjen e vajzës. Ishin raste të rralla kur caktohej ndonjë kushëri i djalit, e në këtë rast duhej të ishte kushëri i dytë e më lartë i djalit.

Ndërmjetësi ose shkuesi shkonte në familjen e vajzës dhe rrinte një copë herë, e niste bisedën dhe tregonte qëllimin e vizitës. Në bisedë e sipër, shkuesi lëvdonte familjen e djalit dhe personalisht djalin, duke i veshur atij tiparet më të mira që duhej të kishte një mashkull, si: trim, punëtor, i ndershëm e i moralshëm, i zgjuar etj. Në fund të bisedës caktohej dita (afati) i përgjigjes, e cila mund të zgjaste një javë, një muaj e në raste të veçanta edhe më shumë. Para se të jepte përgjigjen, i ati i vajzës do t'i tubonte dhe të kuvendonte me vëllezërit e tij, djemtë, dajallarët e vajzës, farefisnin etj. dhe në disa raste edhe miqësinë.

Shkuesi, për detyrën që i kishte caktuar prindi i djalit, në familjen e vajzës shkonte së paku tri herë. Në afatin e caktuar bëhej takimi për ta marrë përgjigjen. Takimi bëhej në shtëpinë e vajzës, por në raste të veçanta në ndonjë kafene apo në ndonjë vend tjetër. Ka pasur raste që pala e vajzës të mos jepte pëlqimin për lidhje krushqie, por, në raste të tilla, asnjëherë nuk ndodhte që të tregoheshin arsyet e vërteta të mospranimi të lidhjes së krushqisë. Gjithmonë përpiqeshin të mos fyenin anën e djalit. Në raste kur jepej pëlqimi, caktohej dita e nigjahut (kurorëzimit). Më vonë, në fshatrat e Strugës, ky akt kryhej në momentin kur krushqit shkonin të merrnin nusen.

Në Strugë e rrethinë ndodhte shpesh herë të lidheshin me krushqi edhe dy familje që ishin në mosmarrëveshtje ose hasmëri me njëra-

tjetrën. Në raste të tilla ndërhynte miqësia për t’i pajtuar dhe për ta ripërtërirë miqësinë. Kishte raste të lidhjes me krushqi të dyfishtë, domethënë jepnin dhe merrnin.

Duhet potencuar edhe një fakt tjetër me rëndësi: brenda qytetit të Strugës, e sidomos në Ohër, përveç martesës jashtë fisit, ekzistonte edhe martesa brenda fisit. Një rast i tillë, megjithëse lejohej edhe nga feja islame, ndodhte tepër rrallë, sidomos në mesin e shtresave të pasura. Këto martesa brenda fisit, masat e gjera të banorëve të këtij rajoni i shikonin me përbuzje.

Nigjahu ishte faza e parë e martesës. Ai kryhej me ceremoni të pakta. Me këtë rast, si në shtëpinë e djalit ashtu edhe në atë të vajzës, tuboheshin njerëzit e afërm të dyja familjeve që tanimë kishin lidhur krushqi. Në rrethin e Strugës nigjahu kryhet edhe në momentin kur krushqit e dhëndrit shkonin për të marrë nusen në shtëpinë e saj.

Nigjahu zakonisht bëhet në shtëpinë e vajzës. Për këtë qëllim, nga ana e familjes së djalit shkonte një numër i caktuar krushqish, rëndom rreth 5 vetë. Në krye të tyre ishte imami dhe një i afërm i dhëndrit: xhaxhai, daja ose vëllai. Në shtëpinë e vajzës (nuses) krushqit priten me nderime e respekt të madh. Barra për të treguar qëllimin e vizitës i binte krushqarit, i cili shprehej me këto fjalë: “Ne kemi ardhur për një hajr!” “Hajr ishalla, të bitiset dhe të tras-hëgohen” - përgjigjej ana e vajzës. Më pas fillonte nigjahu. Në këtë akt solemn, përveç hoxhës, merrnin pjesë dy veqilë (përfaqësues) të djalit dhe të vajzës si dhe katër shahitë (dëshmitarë), nga dy për secilën palë. Hoxha, pasi të kishte pyetur veqilin e vajzës dhe të djalit për emrat e dy të rinjve që me këtë rast do lidhnin kurorë si dhe për emrat e shahidëve, do t’i drejtohej veqilit të vajzës: “Ti Qazo... çish mehri muhexhel (çfarë shpërblimi në të holla, që de-tyrohej t’i jepte pala e djalit palës së vajzës në rast se ndanin nusen pa ndonjë arsye madhore) i kërkon veqilit të djalit? Pasi veqili i

vajzës kërkonte një shumë të hollash, që gjithmonë duhej të ishin numër tek, nga ana e veqilit të djalit fillonte kundërshtimi, deri në tri herë. Aftësia e veqilëve ishte të vinin nigjahun në rregull, sepse ka pasur raste që nuk kanë rënë dakord dhe nigjahu është prishur. Në momentin kur caktohej shuma, imami pyeste veqilin e vajzës: “A e bërë kabull që filanit t’i japësh të bijën e filanit?” Të njëjtën pyetje hoxha ia bënte edhe veqilit të djalit, dhe pasi të merrte përgjigjen, kuptohet, pozitive, të gjithë së bashku nënshkruanin nigjahun (dokumentin ose aktin) i cili i jepej palës së vajzës për ta ruajtur. Në fund të ceremonisë së vënies së nigjahut, hoxha, ose ndonjë nga krushqit e dhëndrit, merrte jakën e këmishës së djalit dhe të vajzës dhe i lidhte me tri nyje. Kjo bëhej që të mos i “lidhë hasmi” dhe që gjatë periudhës së fejesës, dhëndri të mos shkonte në të “liga”. Jaka e këmishëve zgjidhej në kohën e martesës, në çastin kur dhëndri hynte në dhomën e nuses.

Në momentin kur krushqit e dhëndrit largoheshin nga shtëpia e nuses, ata tentonin të “vidhnin” ndonjë gjë (send) nga shtëpia e nuses, që ndeshet pothuajse në tërë krahinat etnike shqiptare. Kjo ceremoni, pa mëdyshje, është shenjë e “grabitjes” së grave.

Pas dy-tri orësh krushqit e vajzës (kuptohet nëse ishin afër) shkonin për të uruar në shtëpinë e dhëndrit, ku pak orë më parë kishte vajtur vajza e tyre nuse. Me këtë rast krushqit e djalit nisin këngët dhe vallet. Këngët që këndoheshin me këtë rast kishin si tema boshte bukurinë e nuses dhe gëzimin e familjes së dhëndrit:

“Ti moj nëna e dhënrrit
Ç’je kaq e gëzuar...”

Dikur, këngët dhe vallet në shtëpinë e dhëndrit vazhdonin për tri ditë rresht. Pas nigjahut, të dy familjet e miqësura e të lidhura me krushqi kishin marrëdhënie të ngushta me njëra-tjetrën, si në raste gëzimi ashtu edhe në raste hidhërimi.

Në rajonin e Strugës, prej momentit të fejesës e deri në atë të dasmës, për festat e motmotit dhe festa tjera, familja e dhëndrit i dërgonte nuses tesha përmes të afërmeve më të ngushtë të dhëndrit (motrave, vëllezërve etj.) ose, në raste të veçanta, edhe përmes prindërve, kunatave të shtëpisë etj.

Djali i fejuar quhej djalë “i zënë”, ndërkaq vajza e fejuar quhej vajzë “e zënë”. Vajza “e zënë, derisa të mbaronin urimet, të cilat zgjatnin një javë, do të rrinte e fshehur, pastaj u dilte me radhë motrave, kunatave, nënës dhe, së fundi, babait të dhëndrit, por gjithnjë me kokën ulur. Edhe djali “i zënë”, gjatë kësaj kohe, përpiquej t’u shmangej takimeve të drejtpërdrejta me prindërit e tij.

Nigjahu (kurorëzimi) nuk mund të prishej në asnjë rast. Edhe nëse vdiste dhëndri para se të martohej, nusen e tij mund ta merrte vëllai më i vogël dhe nëse nuk kishte vëlla, nusen e zënë mund ta merrte një nga kushërinjtë e tij të afërt. Por, po të vdiste vëllai i vogël, gruan e tij nuk mund ta merrte vëllai i madh, sepse ajo e konsideronte në vend (në këmbë) të babait. Ky fenomen në etnografi njihet me emrin “levirat”, nga latinishtja - kunat ose vëllai i burrit dhe “sororat” (latinisht: soror - motër), që është mbeturinë e martesës në grupe. “Levirati” shprehet me atë që gruaja e ve është e detyruar ose ka të drejtë të martohet me vëllain e burrit të saj të vdekur, kurse ky, pra vëllai, në qoftë se është “i lirë”, ose ka të drejtë ose është i detyruar në të tilla raste të martohet me të./ Ndërsa “sororati” (burri i ve) duhet ose mund të martohet me motrën e gruas (të fejuarës që ndërkohë kishte ndërruar jetë). Veç kësaj, kjo motër mundet dhe nganjëherë duhet, nëqoftëse është “e lirë”, të martohet me të.

Edhe në rajonin e pellgut të Ohrit ka pasur raste kur është lejuar që vëllai, kushëririn i afërt etj. të marrë për grua të fejuarën ose gruan e të afërmit të tyre. Kur vdes vajza, prindërit e saj nuk ia imponojnë

familjes së djalit dhënie e një vajze tjetër. Familja e djalit propozon dhe me pëlqimin e prindërve të vajzës përtërihet miqësia./

Gjatë periudhës së fejesës, dhëndrit jo vetëm që nuk i lejohej të shkonte në shtëpinë e nuses, por ai ruhej madje që të mos e shikonin prindërit e vajzës.

Nga fejesa deri në martesë kalonte përafërsisht një kohë prej një deri në tre vjet, ka pasur raste edhe më shumë. Ky qëndrim i gjatë i nuses në gjirin familjar shpjegohet me nevojën e saj për të përgatitur pajën si dhe me nevojat e dhëndrit për të rregulluar që më parë ekonominë e vet.

DASMA

Dasma në rajonin e Strugës, sikurse në të gjitha trevat shqiptare, është një ngjarje e madhe e gëzimit familjar. Që ajo të dilte sa më dinjitoze, bëheshin përgatitje të mëdha. Dasma ishte një barrë e rëndë për ekonominë familjare, aq sa shumë familje, për vite me radhë, nga shpenzimet e tepërta, nuk e merrnin dot veten. Sado e vobektë të qe familja e nuses, ajo ishte e detyruar që t'i bënte pajën vajzës. Familja e dhëndrit nuk jepte asgjë për të (pajën). Në pajë bënin pjesë: rrobat e vajzës, që zakonisht ishin: 8 - 10 fustanë, 8 - 10 tumane (brekë ose formë e dimive), 10 - 12 këmisha, 10 - 12 jelekë, 15 - 20 mindile (shami të vogla), 5 palë çorape, 15 - 20 shami dore, 2 - 3 breza, byzlyqe, një varëse me florinj (kishte familje që vajzës së tyre në pajë i jepnin edhe orë xhepi), pastaj, dy arka e një valixhe ku viheshin rrobat, 4 jorganë, 2 - 4 dyshekë, 10 sahanë (pjata) bakri me kapak, 10 sahanë supe etj.

Elementet dominuese që kanë ruajtur identitetin etnokulturor të banorëve të këtyre fshatrave (të pellgut të Ohrit), si dhe në të gjitha trojet etnike shqiptare, janë këngët, vallet dhe zakonet e dasmës, të cilat kanë gjenezë të lashtë dhe janë përcjellë e ruajtur me xhelozi

deri në vitet 50 - 60 të shekullit XX. Tradita dhe origjinaliteti bu-
rimor i tyre ka pasur ndryshime fare të vogla, pavarësisht nga koha
dhe mënyra e jetesës së vetë banorëve si dhe nga ndikimet e popu-
lve tjerë që kanë jetuar pranë tyre gjatë shekujve.

Nëpër fshatrat e Strugës dihej gjashtë muaj përpara se kush do të
bënte dasmë në fshat. Prandaj, fshatarët, sidomos kur parashi-
koheshin më tepër dasma, shpreheshin: “Simjet kimi shumë dasma
e do të kënaqemi me ahengje e gjymbyshe”.

Zakonisht, dasmat bëheshin pas Shën Mitrit (pas 8 nëntorit), në
kohën kur burrat ktheheshin nga kurbeti si dhe kur përfundonin
punët në fshat. Koha e dasmave zgjaste gati tërë dimrit. Ishte tradi-
të që dasmorit t’i ofrohej ndihmë një muaj para dasmës, e ky ishte
një lehtësim i madh për të zotin e dasmës.

Gjashtë javë para se të fillonte dasma, i ati i dhëndrit e dërgonte
ndërmjetësin (shkuesin) në shtëpinë e vajzës për të prerë ditën e
dasmës. Kohëve të fundit, në rajonin e Strugës, së bashku me
shkuesin shkojnë edhe prindërit e djalit dhe në të njëjtën kohë i
dërgojnë edhe teshat (peshqeshet) e fundit për nusen para dasmës.
Atë ditë do të merret masa (dimensionet e trupit) e nuses, në prani
të prindërve e të afërmeve të tjerë të saj me një pe të kuq. Në këtë
ceremoni, i ati i vajzës, për të pranishmit, nxjerr llokume me qëllim
që të rinjtë që bashkohen të kenë jetë të ëmbël bashkëshortore.
Ngrënia e llokumit përcillet me urimet: “Paçin fat e këmbë të
mbarë”, “U trashëgofshin” etj.

Një javë para se të fillonte dasma bëheshin përgatitjet që gjatë
dasmës çdo gjë të shkojë në rregull. I zoti i dasmës i ftonë të afërmit
për të kuvenduar, ndërsa në fund caktoheshin detyrat për secilin:

- i pari i dasmës;
- akçiu (kuzhinieri), i cili do të përgatis ushqimin në ditën e
dasmës;

- maxhenicat (gratë që do të gatuajnë bukë);
- "bojalinjtë" (bojaliu i parë mund të ishte daja ose mixha). Zakonisht ishin tre ose pesë bojalinj. Për këtë rast, në rajonin e Strugës tregohet një anekdotë: Po të shkonte bojali i parë daja i dhëndrit, thuhej se bën dasmë e ëma e djalit, kurse po të shkonte bojali i parë mixha, thuhej se bën dasmë i zoti i shtëpisë, pra i ati i dhëndrit;
- personi që do të rruajë dhëndrin;
- personat që do të shërbejnë (hyzmetçinjtë);
- përgjegjësi i lodrave (muzikës);
- personi që do ta përgatisë qerren;
- personi që do të rrijë pas qerres së nuses;
- numri i krushkave që do të shkojnë për të marrë nusen;
- bash-krushka (ose krushka e parë);
- personi përgjegjës për sofrat;
- personat që do të japin sherbet;
- personat që do të ftojnë dasmorët etj.

Pasi të bëheshin të gjitha këto përgatitje, dasma fillonte në ditën e bojës. I zoti i dasmës, një ditë përpara, i fton të afërmit dhe miqtë tjerë që të marrin pjesë në gëzimin e madh familjar, që nga nisja e bojalinjve, ditën e hënë ose të enjten.

Një ditë para se të fillonte dasma (para bojës), njerëzit e afërm të dasmorit therin kaun, lopën, demin etj. ndërsa gratë, bijat e shtëpisë, nuset etj., gjatë këtij akti këndojnë:

"Nafi aga e therri lopën,
e thërriti të gjithë botën.
Nafi aga e therri kanë,
e thërriti gjithë dynjanë.
S'e thërriti gjithë dynjanë
veç miqësinë e akrabanë
huallëkun ku e ka ngrënë..."

Disa ditë para dasmës, e zonja e dasmës i thërret bijat e shtëpisë si dhe gra të tjera për të ftolluar (tëholluar) bakllavatë e dasmës. Bakllavaja është ëmbëlsirë tradicionale me petë të tëholluara. Zakonisht, petët radhiten në tepsi duke u hedhur sipër arra të grimcuara, rrush të thatë (stafidhe), fiq, hurma etj, të cilat pas radhitjes piquen me saç ose në shporet dhe më pas zbuten me sherbet të trashë.

Pasi janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme dasma fillon me ditën e bojës, pra kur nuses i dërgohet boja. Duhet të jetë ditë e hënë ose e enjte. Sipas traditës, në bojë dërgohen një, tre ose pesë vetë. Numri i bojalinjve duhet patjetër të jetë numër tek.

Bojali mund të jetë daja, vëllai, xhaxhai ose kushëriri i dhëndrit. Në bojë dërgohen: ngjyrë për flokët, këna për duart, unazë, vath, këpucë, sandale, doreza, ombrellë, mantel, tel dekorativ, preparate kozmetike, veshje të tjera për nusen, por edhe për familjen e ngushtë të nuses etj.

Me peshqeshet dërgohen edhe leblebija (qiqra të pjekura), sheqerka, gështenja e fruta të tjera. Gratë i bëjnë gati teshat. Të gjitha ato, më parë, i renditnin në hejbe, por më vonë në një arkë, e sipër tyre hidhnin oriz e bonbone ose karamеле. Në arkë, gratë që përgatisin teshat, vënë edhe gështenja, leblebija, rrush të thatë, bonbone etj., të cilat do t’u shpërndahen atyre të cilët e presin bojën te nusja. Bojalinjtë përcillen me këngë dhe tri herë me të shtëna pushke ose revoleje. Dikur boja është dërguar me kalë e më vonë me karrocë. Në momentin e përcjelljes së bojës nis kënga:

“Aj perri, dil perri,
 “Aj perroj, dil perroj,
 kush ta nisi bojën ty?
 kush ta pruni bojën toj?
 Aga baba si zotni.
 Aga baba si zotnoj.

Aj perri, dil perri,
 Aj perroj, dil perroj,
 kush ta nisi bojën ty?
 kush ta pruni bojën toj?
 Anko nenja si kumri.
 E ka gje në pazar,
 Aj perri, dil perri,
 E ka peshu me kandar..."
 kush ta nisi bojën ty?
 Aga daja/mixha si zotni..."

(Në fshatrat toske)

(Në fshatrat geqe)

Bojalinjtë nisen për në shtëpinë e nuses para dreke, rreth orës 10 - 11. Edhe në familjen e nuses, i ati, një ditë përpara, e thërret farefis-sin, miqtë e të tjerët dhe përcakton se kush do t'i presë mysafirët bojalinj në ditën e caktuar.

Bojalinjtë, në shtëpinë e nuses, priten nga të afërmit e familjes. Pas një bisede të përzemërt shtrohet dreka, ndërrohen cigaret e muha-beti etj.

Gratë e shtëpisë përgatitin peshqeshet për dhëndrin. Nëse mungon diçka për nusen, bojaliu i parë, detyrimisht, brenda kësaj kohe të qëndrimit të tyre, duhet që t'i plotësojë mangësitë. Pas drekës, bojalinjtë përcillen për në shtëpinë e dhëndrit. Boja te nusja merrej nga abxhicat (gratë që përgatitin vajzën për t'u bërë nuse), zihej në tigan dhe pasi ftohej i vihej nuses në kokë.

Para se t'ia vënë bojën, mblidhen shoqet e nuses dhe e mbyllin derën që të mos hyjnë gratë në dhomë, për t'i penguar ato që sho-qen e tyre mos e bëjnë nuse. Pasi gratë e shtyjnë derën dhe hyjnë kinse me forcë, me pjatën në dorë, fillojnë t'ia vënë bojën nuses. Ndërkaq kjo e fundit, fillon të qajë, e pas saj qajnë edhe shoqet e saj. Gratë, pasi mbarojnë këtë ritual (adet), nisin të këndojnë:

“Aj perri, dil perri, kush ta venën bojën ty?...”

“Kur ma vishe bojën, alivant të nxehtë,
lumja ti e lumja me cilin do çosh jetë...”

Në vazhdim gratë e mbulojnë nusen me duvak. E lënë rreth një orë të mbuluar, ndërkohë që nusja e hedh tri herë duvakun sikur nuk e dëshiron. Në fund, abxhicat e bëjnë nuse dhe, ashtu e përgatitur, qëndron dy ditë (e hënë e martë). Gjatë këtyre ditëve vijnë njerëzit për “hajrli” (urime).

Të mërkurën (ose të shtunën) gratë bëjnë ahengun, duke kënduar:

“Shkallë më shkallë kur më ngjiteshe,
ja më dukeshe ja s’më shifshe
pa dilni shihni moj zullumqaren
sa mirë ma lojtka dosa moj vallen...”

“... Trëndafile në bokërrinë, trëndafile,
merr gjergjef e aj të rrimë, moj trëndafile.
S’marr gjergjef e s’vij të rri, mor trëndafil
se vjen beu s’më gjen aty, mor trëndafil.
Pa më thotë: - Ku ke qenë mor trëndafil?
Un’ kam qenë te fisi jot mor trëndafil.
Fisi jot ka nuse shumë more trëndafil,
merr me grushtë e hidh në lumë more trëndafil...”

“... Syzeza moj sy-larushe,
dogje male, dogje fushe,
dogje malin prej sevdasë,
dogje fushën prej sevdasë...”

Natën e enjte (të diel) nusja fle në dyshekun e pajës me një çun (djalë) të familjes (nip, vëlla të vogël etj). Gratë ia lyejnë duart me këna. Ditën e enjte (të diel) gratë e veshin nusen me teshat më të

mira dhe i teletisin tërë fytyrën me tel të grimcuar gjer te qafa. Me këtë rast gratë e vajzat, së bashku, i këndojnë:

“... Nënë, ç’kan malet që buçasin?

Bijë, vijnë të të marrin.

Nënë, thue të më presin

sa të ujdin mirë telin.

Bijë, nuk presin atllarët!

Nënë, le t’i ndalin yzmeqarët...”

Në shtëpinë e dhëndrit

Pasi nisen bojalinjtë, të hënën ose të enjten, aty rreth orës 10 - 11, në shtëpinë e dhëndrit, në oborr, bien daullet, nis vallja dhe shtypet gruri.

Prej të hënës e deri të enjten (ditën që merret nusja), në shtëpinë e dhëndrit vijnë njerëz për të uruar dasmën, sidomos pas darke. Te nusja bojalinjtë i presin për drekë. Bojalinjtë, pasi drekojnë, kthehen në shtëpinë e dhëndrit. Të gjithë bojalinjtë u japin nga një peshqesh si dhe një bohçallëk për rruajtjen e dhëndrit. Pasi vjen boja, edhe në shtëpinë e nuses shkojnë për urime. Familja e dhëndrit, të mërkurën, i fton mysafirët për dasmë. Një nga të afërmit e dasmorit, me listë në dorë, shkon shtëpi më shtëpi duke thënë: “Ju bën selam (të fala) zoti i dasmës që nesër të urdhëroni në dasmë”. I ftuari e falënderon duke i thënë: “Faleminderit, ngjefshim edhe më ty ose në familjen tënde”.

Të mërkurën në mbrëmje, pasi largohen mysafirët që kishin ardhur për të uruar dasmën, më të afërmit e dhëndrit bëjnë planin e dasmës. Sipas numrit të konakëve (dhomave), si dhe numrit të sofrave, duke llogaritur 13 - 15 vetë për sofër, caktohen edhe shërbyesit. Pasi qysh të mërkurën është therë kau, lopa ose demi, llogaritet rreth 7 kilogram mish për çdo sofër. Mishi gatuhet në dy mënyra: me jahnë dhe me oriz (byrian). Përveç mishit në sofër

shërbehej edhe çorbë, bakllava dhe pilaf. Bakllavatë janë tëholluar një javë para dasmës. Për çdo dhomë (konak) caktohen dy shërbyes për të dhënë ujë, kafe, për të mbajtur zjarr dhe shërbime të tjera. Caktohet plaku që do të shkojë pas qerres ku do të jetë nusja. Sipas zakonit, ky duhet të jetë plaku më i moshuar në fisin e dhëndrit. Caktohet kush do ta përgatitë qerren. Më parë qerrja mbulohej me qilima dhe duhej të bëhej gati një ditë më parë. Caktohen gjellëbërësi dhe pastrueset të cilat janë vajzat dhe nuset e fisit. Të enjten në mëngjes, pasi rregullohen dhe shtrohen konaqet e caktuara, vinë daullet dhe fillon pritja e mysafirëve të ftuar në dasmë. Dikur dhëndri rruhej më herët, aty rreth orës 11 para dite, sepse rrethanat kanë qenë të tilla që nuk ka pasur si tani vetura, por edhe rrugët kanë qenë jo të mira.

Dhëndrin e rruan kushëriri ose dhëndri i shtëpisë, i ndihmuar nga të afërmit e dhëndrit. Berberit dhe atyre që ndihmojnë në ruajtjen e dhëndrit u japin peshqeshe, si këmisha, peshqirë etj. Më pas shtrohet dreka dhe pas kësaj nisen krushqit për të marrë nusen. Sipas zakonit, krushqit, rrugës ecin në kolonë, dy nga dy, dhe në fillim të kolonës gjendet hoxha i fshatit dhe një më i moshuar, pastaj njerëzit më në moshë, të rinjtë dhe daullet. Pas tyre shkon qerrja ose vetura, kurse e fundit është qerrja e nuses, pas së cilës, hipur në kalë, shkon plaku i caktuar pas qerres. Kur afrohen afër shtëpisë së nuses, i pari i dasmës cakton 3 ose 5 të rinj të cilët i lajmërojnë pritësit të nusja se ia mbërrin krushqit. Sipas zakonit, të gjithë pritësit nga ana e nuses, dalin në oborr dhe radhiten në rresht për një dhe u japin dorën krushqve duke u thënë mirë se erdhët. Pasi hynë në konaqe, krushqit mysafirë shërbehen me nga një llokum, pastaj edhe me nga një cigare dhe menjëherë pas kësaj fillon muhabeti dhe kënga. Gjatë kohës që rrinë krushqit këtu, babai i nuses me disa nga fisi i vet, vizitojnë të gjitha konaqet e krushqve, të cilët ia urojnë dasmën. Pas pak kohe, hoxha me disa

nga ana e dhëndrit e disa të tjerë nga ana e nuses, dalin në një dhomë të veçuar dhe atje bëjnë kurorëzimin (nigjahun) e dy të rinjve që martohen. Pas kësaj ceremonie hoxha dhe shoqëruesit kthehen në konakët e tyre. Ndërkohë, të rinjtë nga ana e dhëndrit dalin jashtë dhe e ngarkojnë pajën e nuses nëpër qerre e traktorë. Paja niset pak para se të nisen krushqit. Te gratë, poashtu pasi përshëndeten, ndahet sherbeti dhe fillon vallja. Krushkave u del dy-tri herë nusja, gjithmonë me tesha të ndërruara. Do të evidentojmë këtu këngën që këndojnë krushkat para se të hynë brenda:

“Top sheqere rrumbullake
mbetën krushkat në sokak,
s’ka kush t’u bojë konak.

Drita moj dil në lomë,
të ka çue vjehrra selam
sheqer koka për të ngrënë.
Unë sheqerkat nuk i dua,
shif se ç’bon nona për mua.

Unë sheqerkat nuk i ha,
shif se ç’bon baba t’u qa”

Krushkat, pasi hyjnë në konak te nusja këndojnë:

“Omonat e domonat,
na i qitni atë flokgjat
përmbi shoqet ma e nalt.
Fuge shallin degerme,
hajde Drita ti me ne” etj.

Plaku i qerres shkon dhe thërret bashkrushkën (krushkën e parë, që duhet të jetë dajovica, halla ose mixhovica e dhëndrit) dhe i thotë që të bëhen gati për t’u nisur. Nusen e fusin në qerre i vëllai me dajën e vajzës, kurse plaku i qerres, në këtë moment, nxjerr një pako të mbushur me oriz, sheqerka e monedha dhe i hedh sipër qerres, ndërkaq fëmijët vrapojnë dhe i marrin ato.

Para se të nisen krushqit, të gjitha qerreve dhe daullexhinjve u japin nga një havli (peshqir).

Qerres së nuses i vënë këmishë e pasqyrë. Qerrja tani shkon para të tjerëve. Kur kthehen, krushqit ndërrojnë rrugën dhe aty ndalohen për të ngarë rizë. Nusja e nxjerrë një rizë (havli - peshqir) të qëndisur me dorë; njëri e merr dhe ik më se 2 - 3 km dhe pastaj një grup të rinjsh dasmorë lëshohen me vrap pas tij. Kush e arrin i pari rizën, ai bëhet edhe pronar i saj. Ai që e merr rizën mburret për gjatë kohë për “trofeun” e fituar, ndërsa nga të tjerët konsiderohet si atlet më i mirë. Në anët e Strugës, për një kohë të gjatë, ka qenë i përmendur Qani Istref Lloga nga Livadhia, i cili në çdo dasmë arrinte që ta merrte rizën.

Para se të hipë nusja në qerre, nëna i jep një para të cilën e fut në gojë dhe e mban deri në momentin kur ndahet sinori (kufiri). Pارانë pastaj nusja e nxjerr nga goja dhe e hedh jashtë qerres. Më të moshuarat (plakat) tregojnë se me këtë nusja i hedh llafet (muhabetet).

Kur afrohen krushqit te shtëpia e dhëndrit, 5 - 7 të rinj shkojnë përpara, dhëndri i pret i veshur me teshat e dhëndërisë, ua jep dorën dhe në dorë u lë pesë denarë të mbështjellë në letër. Derisa shkarkohet paja, mbërrijnë edhe krushqit. Dhëndri nusen e pret në hajat (korridor) dhe i hedh në fytyrë kokrra gruri përzier me sheqerka. Më pas nusen e çojnë te oxhaku dhe ia trokasin kokën tri herë, pastaj në kokë i vënë tri kësula të bardha, njërin mbi tjetrën, dhe ia rrëzojnë me okllai. Sapo zbret nusja nga qerrja, në të dy krahët (nën sqetulla) i vendosin nga një bukë gruri dhe nga një qiri të ndezur. Ky rit bëhet që nusja të jetë me bereqet.

Pasi i mbarojnë këto rite, nusen e çojnë te konaku i grave dhe e lënë në fund të dhomës që të nusërojë, ndërsa dasmoret këndojnë këngë duke vallëzuar:

“Drita moj duar pambuku,
nënë tënde moj e ka hangër uku.
E ka hangër me vërte
duke qarë ndër stre!
Çka kërkove ti moj ke ne?
Moj breshkuze hungareze!
Ti nonën këtu s’e ke,
moj breshkuze hungareze!”

Pasi nis të errësohet, fillojnë përgatitjet për të vënë nga dy sofrat në çdo konak. Para se të fillojnë me darkën, të zotin e dasmës e urojnë: “U trashëgofshin”. Pas mbarimit të darkës vazhdon kënga dhe vallja deri vonë.

Pasi mbarojnë sofrat te burrat dhe te gratë, mbyllet dhëndri. Krushqit mblidhen para derës së dhëndrit, ndërsa imami i fshatit ia këndon duanë. Dhëndri pastaj ua merr dorën me radhë: imamit, babait, dajës, mixhës dhe disa më të moshuarve dhe fluturimthi vrapon të hyjë në dhomën ku është nusja. Rugës ose shkallëve, zakonisht, duke hyrë në dhomë, shokët e tij të pamartuar e godasin me grushte. Pasi mbyllet dhëndri, nëpër konakë vazhdon përsëri gëzimi me këngë e valle.

Pak më vonë, një grup grash, dhëndrit i këndojnë pas dere:

“Na hyri nusja në quar,
na la zjarrin pa mbuluar!
Tingërr, tingërr bie legeni,
na la nusja posi qeni!
Se na erdhe çka na prune,
ti prej ode na përzune!
Tingërr, tingërr bie tagjari,
na la nusja si gomari!”

Pas pak dhëndri hap derën dhe u nxjerr disa kuti llokume.

Para se të mbyllet dhëndri, gratë ia rregullojnë shtratin. Pasi shtrohet dysheku me çarçafë, jastëkë e jorganë, merret një djalë i vogël dhe tri herë rrokulliset në shtrat. Ky është një rit që bëhet me qëllim që edhe çifti i ri të gëzohet pas ca kohësh me një djalë.

Afër mëngjesit (agimit të ditës së premtë ose të hënë), nëna e dhëndrit ose motra hyjnë te dhoma e nuses dhe bëjnë marrëveshje se sa gra të shtie në petulla. Pasi del nga dhoma, nëna ose motra, merr 4 - 5 gra më të afërta dhe hyjnë së bashku te nusja me petulla. Nusja, që të gjithave u jep nga një peshqesh.

Në mëngjes herët, duke zbardhur dita e re, në oborrin e shtëpisë së dhëndrit vijnë daullet, fillon vallja dhe kështu e zgjojnë dhëndrin. Pas një kohe dhëndri e hap derën dhe del. Disa të rinj, duke zbritur dhëndri, e kontrollojnë nëpër xhepa e në trup për t’ia gjetur mindilin që ia ka fshehur nusja. Ai që ia gjen, e merr mindilin për vete.

Pasi del dhëndri në oborr, u jep daullexhinjve të holla dhe hyn në valle. Të nesërmen (e hënë ose e premtë), në darkë, i ftojnë më të afërmit për t’i ngrënë bukët e nuses. Nusja u merr dorën dhe secili i lë në dorë nga një shumë të hollash.

Në fund të javës së dasmës dhëndri shkon në shtëpinë e vjehrrit në petulla. Së bashku me dhëndrin shkojnë edhe 7 ose 9 burra, ndërsa nusen e shoqërojnë 5 ose 7 gra, pra, edhe ky numër duhet të jetë tek. Pasi hanë drekë ose darkë, dhëndri me një të afërm të tij, del në konakun e grave dhe ndan dhurata ose peshqeshe sipas pozitës familjare dhe moshës, kurse fëmijëve u jep para.

Disa ditë pas ceremonisë martesore, të afërmit e dhëndrit (dajallarët, mixhallarët, hallat e tezet), kuptohet ata që i ka, e thirrën nusen në sherbet, duke shtruar darka të bollshme për të, për dhëndrin dhe familjen e ngushtë të dhëndrit.

Pas disa javësh ose ndonjë muaji, vjehri i dhëndrit, për ta forcuar miqësinë, merr të afërmit e tij dhe viziton familjen e dhëndrit dhe të afërmit e

Literaturë:

1. Nebi Dervishi, "Etnokultura në fushëgropën e Ohrit", Tetovë, 2005.
2. Zejnulla Qyra, "Veleshta në histori", Strugë, 2000
3. Islam Baftjari, "Fshati në gurë", Strugë, 1999
4. Xheladin Emini, "Pohumi në histori", Strugë, 2002
5. Nebi Dervishi, "Livadhia e Strugës – vatër e rezistencës, arsimit dhe kulturës", Tetovë, 2008.
6. Fjalori enciklopedik shqiptar, Tiranë 1985.

MUSTAFA IBRAHIMI

Universiteti "Nënë Tereza" Shkup

KËNGË DHE RITE NË DASMAT E RAJONIT TË PRILEPIT DHE KRUSHOVËS

Në këtë trevë janë ruajtur shumë kategori të këngëve. Zanafilla e tyre është aq e vjetër sa edhe martesat. Këto këngë janë bartur brez pas brezi e më së shumti i kanë ruajtur femrat, vajzat dhe gratë pak më të shtyra në moshë. Njëra ndër këto kategori janë padyshim edhe këngët e dasmës. Në krahasim me të tjerat, këngët e dasmës janë më tepër të përhapura në këtë trevë si në fshatrat malore ashtu edhe në ato të rrafshit. Këto këngë janë të shkurtra, por që kanë njëfarë përmbajtje në vete, qoftë kur përmbajnë elementin humoristik, satirik apo herë-herë sarkastik, por pa një qëllim të keq.

Këngët e dasmës nisen të këndohen ndër grupet e vajzave dy ditë para se të fillojë dasma, pra atë ditë kur bëhen gati petkat e nuses dhe të nisen fisnikët të shkojnë te miqtë e rinj. Atë ditë vajzat e përgatisin shtëpinë për dasmë dhe duke punuar këndojnë këngë të ndryshme. E lavdërojnë djalin dhe nusen.

Meqë dasma është momenti më i lumtur dhe më i pritur në familje, vetvetiu u lindën rite të ndryshme dhe këngë të lloj-llojshme rreth dasmës. Këngët e dasmës në shtëpinë e dhëndrit janë të shumta. Ata fillojnë kur merret rrizja (shenja e parë që e sjell "shkejzi" (mësi). Atëherë në atë shtëpi paraqitet një gëzim i madh gjithë familjar. Lajmërimin e këtij gëzimi e bëjnë vajzat e asaj familjeje. Tubohen të gjitha vajzat e lagjes dhe farefisit, dhe me defe në dorë këndojnë këngë për rrizen por edhe dashurinë. Këngët këndohen nga ndonjë dritare që të dëgjojë i tërë fshati:

Bie shini bie vdora
Përmi uodën e dylber begut
Nauk o shini, nauk o vdora
Osht kjo rrizja e dylber begut

Vajzat i këndojnë edhe shkejzit (mësitit) i cili luan rolin e ndërmjetësuesit. Në fillim njëherë sjell dhurata nga vajza, që është shenja e parë e pastaj edhe nga djali. Me këtë rast, vajzat i këndojnë nuses së ardhshme, e cila palon teshat dhe i përgatit për mësitin:

top e ara zerdelia
zerdelia o e bafqeve
kjo lulia rajn n'qardake
tuj paltu o moj rizen-o
ja bon azër, o moj shkejzit-o.

Pasi të kryhen këta formalitete, dhe tash më kur dihet se dy të rinjtë do të merren, familja e djalit fillon me përgatitjen e dasmës. Tri javë para dasmës, dasmori përgatitet duke blerë fustane për nusen. Pra hapi i parë është qepja e teshave të nuses. Me këtë rast merret nusja dhe dërgohet te rrobaqepësi për të marrë masë, që t'i ketë teshat të sakta:

Vauna shkallët maurit-o
Maurit kallkanit-o
Sajova duqanit-o
Çish duqane Çilen-o
Çish gërshan na majren-o
Çish petka na prajten-o
Për lulien gatiten-o
Për shtatin niten-o

E diel

Një javë para se të fillojë dasma, zakonisht dita e diel, në shtëpinë e dhëndrit prapë mblidhen vajzat dhe familja më e afërt që ta qërojnë grurin, nga i cili pastaj shtypet "qeshqeku" grurë i zier dhe i shtypur. Me këtë rast vajzat i këndojnë edhe djalit edhe vajzës, duke ua bërë me dije se dasma prej sot fillon zyrtarisht:

*Amana more dylber beg
Fol e naise ne kiet dasëm
E kum fol, e koum naisun
Ja kum lan jago-babës
Të ma mliedhe farefaysin*

*Kurse vajzës i thuhet me fjalët:
Naisu nause, naisu lulie
Se jen t'ue nais, ojne grunin-o
Aun jem naisun donedisun
Saun e la more nanën vetun.*

E hënë

Të hënë përsëri, përveç vajzave në shtëpinë e dhëndrit, që në mëngjes vijnë edhe gratë e fisit më të gjerë, të cilët duhet ta ftuallin bakllavën. Me këtë rast, më tepër i këndojnë nuses, e cila së shpejti do të duhet të ndahet nga familja:

*Mos më qaj lulie
Se do t'praishet bukuria*

Ose

*Mori si të shkonin lot, moj lulie
Si molla nëpër faqe*

Përgjigjja e lulies në të dy rastet, është se këtë e bën për nder të nënës:

Bukurien nauk e qaj

E pash nanën u rrop t'ue qajt.

E martë

Të martën, dasmori bën përgatitjet intensive për fillimin e dasmës. Këtë përgatitje e fillon me prerjen e mishit, zakonisht theret ndonjë ka.

E mërkurë

Këtë ditë në shtëpinë e dhëndrit ekspozohen teshat që i ka përgatitur shtëpia e dhëndrit, por edhe dhuratat nga farefisi, që njihet si “*e netmja e reshnavë*”. Të gjitha teshat janë të varura në murr, ku janë të shënuara edhe emrat se kush i ka dhuruar. Këto tesha i vizitojnë një numër të madh të grave, dhe më pas komentohen. Aty janë të ekspozuara edhe ari dhe sende tjera të çmueshme. Vajzat duke kënduar, i çojnë porosi vajzës se së shpejti do t’ia sjellin teshat dhe arin që ia kanë blerë:

Bon konak baba xhypi, bon konak

Se do t'vije jago baba, bon konak

Do ta bjere kuti rubën, bon konak.

E enjte

Tri ditë para se të fillojë dasma, kemi disa këngë kushtuar ritit të “petkaxhive”. Petkaxhit janë të afërmit e familjes së dhëndrit, të cilët janë të zgjedhur zakonisht në numër janë tek ose 13 ose 15 anëtarë, të cilët kanë për detyrë nuses t’ia dërgojnë fustanet dhe arrin që i ka blerë shtëpia e dhëndrit. Të gjitha teshat janë mirë të përgatitura nëpër valixhe, dhe çdo i afërm mban nga një valixhe. Para se të nisen vajzat këndojnë:

*Amanet nana xhypka
Bon gati ojne drekën
Gati osh, azër osh
Qitu rize petkaxhive
Petkaxhive të dylber begut*

Ose
*Amanat moj nana xhypka
Dil e shaif moj ç'na vjen audhës
Çish me pa moj bija ime
Jen d'vet te dhandrit, dylber begut*

Për pritjen që duhet ta bënë prindërit e vajzës, vajzat këndojnë:

*metën petkaxhit në konak
paysin jalla ku ka konak
ka konak ke baba xhypi
baba xhypi pret konak
nana xhypka shtron çardak
motra xhypka bon ni kafe
me sheqere me sevdaje
me filxhanet e lulies*

Bashkë me rrobat, nuses i dërgohet edhe kanaja, e cila i përdor për ngjyrosjen e flokëve dhe me këto shprehet fillimi i dasmës te nusja. Vajza pasi i vesh, gjoja pa dëshirë, rrobat që ia ka sjellë familja e burrit, pasi t'i marrë, me rend gratë ngryk del në dhomë tjetër dhe i heq ato e vishet sërish me rrobe vajzërie, deri të nesërmen kur vishet si nuse dhe pret gratë e fshatit që vijnë të shohin pajën, që ka përgatitur brenda afatit të fejesës.

E premtë

Ditën e premtë, që në mëngjes, shoqet e nuse mblidhen dhe e zgjojnë nga gjumi, duke i kënduar :

*Gremu lulije gremu, lum kunata
Se kunata don ta laje Lulije kaj kananë...*

Këto këngë këndohen nga shoqet e nuses, dhe janë pikëlluese, pasi paraqitet faza e përfundimit të një jete rinore. Andaj nusja u drejtohet shoqeve dhe kunatës:

*Iqmu moj shoqe, iqma të keqen
Se besa jam sëmu shoqja ime, dergjuno
Shoqet i japin kurajë :
Mos m'u trem lulie
Mos m'u trem lum shoqja
Se shoqja ta kum dhan lulie
Dylber agën gjal i rie.*

Ndërsa, në shtëpinë e dhëndrit, kryhen përgatitjet e fundit. Zakon është në këto treva që të shkohet (gryshet) në çdo shtëpi të bijave dhe të farefisit dhe të ftohet gratë e burrat të vijnë në dasmë që ta shtojnë gazmendin. Kur të vijnë bijat vajzat e reja në të hyrë të oborrit nisin këngën:

*Majr e bone, bukur bone dylber beg
Çish gazlllove farefaysin dylber beg
Farefaysin e Dylber agës*

E shtunë

Gazi dhe hareja shtohet sidomos ditën para se të fillojë dasma. Më parë dita e parë e dasmës ishte e premtja, por tash dasmat nisin të shtunën. Te burrat këndohen këngë madje bien daullet dhe zurlet. Nën zërin e daulleve dhe zurllave e shtypin qeshqekun, gjë që tregon shumimin në familje nga çifti i ri, i cili do të fillojë një jetë të re. Te gratë ka vetëm dajre dhe vajzat që i bien deficit. Vajzat e mëhallës i këndojnë të gjitha nuset e me nuset më të reja. Deri sa

biseda dhe katundarët që vijnë dhe palohen në radhë ahengu arrijnë në kulm vajzat e thyejnë këtë monotoni me zërin e tyre. Zakonisht në këto kënga, përqeshet babai i nuses e lavdërohet shtëpia e djalit, si shtëpi bujare, shtëpi pasaniku, që ka gjithçka. Përveç "tamlit të zogut" siç thot populli.

Rrajni familija e nauses ku jeni

Shpajet me kashta i kini

Shpajët e familis ton zgrada jen

Gjithashtu vajzat i japin përkrahje nuses, se ka bërë zgjedhje të mirë, dhe se të gjithë e xhelozojnë për këtë:

Moj lulie dilimi i bakllavës

Mair va bone caucave t'mallës

Ani mair va bone, qi si ngjove

Dylber agën vet e deshe, vet e more.

Kështu shprehet qartë pasuria që ka burri duke përmendur edhe rindërtimin e shtëpisë që e ka bërë për dasmë, që nusja në fillim të shoh gjithçka që ka të mirët.

Në mbrëmje te gratë bëhet sërish gëzim. Luhen shumë drama të shkurtra popullore (kryesisht i luajnë gratë) duke i imituar burrat dhe gratë plaka. Po ashtu përqeshet edhe i zoti i shtëpisë, si në vargjet:

Abaz aga qalla-qalla

Zboet dasma ne me pralla

Me ni luge me ni kaupe

Me ni diele bishte gaupe.

Ose

Ani buke mos shikoni

Mo muloni nër peshterke

Osht e nana e dylber agës.

Më interesante nga të gjitha ditët, që nga fillimi, kur të vihet qeshqeku për t'i ngrënë dasmorët, është nata e qerres kur bëhet përgatitja e qerres me qilima të kuq, shenjë që tregon se është qerre nuseje. Atë mbrëmjeje behët aheng i madh sesa ditëve tjera, kur edhe nëna e djalit (vjehrra) del dhe luan me djemtë dhe vajzat që këndojnë dhe vallëzojnë të gjithë së bashku.

E diel

Posa zbardh dita zgjohen të gjitha gratë dhe bëhen gati të shkojnë ta marrin nusen. Në dasmën e dhëndrit marrin pjesë të gjithë gratë e fshatit, të cilat për dy ditë sa zgjat dasma, vallëzojnë nuset dhe vajzat. Të dielën dhëndri nxirret në oborr, dhe në shoqëri të valles që i luajnë krushqit, dhëndrin e qethin dhe e ruajnë, kurse krushqit dhe mysafirët i dhurojnë para. Për të shkuar që të marrin nusen nisen edhe dasmorët, kuptohet edhe disa nga të afërmit e djalit.

Këngët që këndohen kur merret nusja u drejtohen më së shumti nuses dhe familjes së nuses. Nuses edhe njëherë ia bëjnë me dije, se nuk kanë harruar se për çka kanë ardhur p.sh : Këto këngë këndohen te shtëpia e nuses:

Dullaku i lulies kutaja-kutaja

Kutonje lulije se do t'lam ke shpaja.

Provokuese janë edhe këngët drejtuar babait të nuses, i cili sikur dëshiron që të hamenden dhe mos t'ia marrin vajzën edhe atë ditë:

Ka dal baba o shashtis në lam

A da vin ta marrin lulien

A jan bo pishman ?

Derisa të gostiten krushqit, nusja nusëron në shtëpinë e vet, kurse vajzat vazhdimisht këndojnë, dhe zakonisht këndohen këngë nënçmuese kundër nënës dhe babait të nuses:

Kjo nausja tone krejt me tel

*E lam nanën vete ne çengel
Kjo nausja tone si bujare
E lam babën vet si magar
I ka livar veshët si zagar.*

Ndarjen e nuses nga prindërit, gjithashtu e përshkojnë këngë që janë prekëse dhe nënçmuese për prindërit e saj:

*Nismu moj lulie, nisu Naile
Un jam nisun ballin teledisun
Sun e la moj nanën vet
Merre nanën tane
Përplase për dheje
Yp në limuzin lulie, ajde ke ne.*

Në rast se ndodhë ndonjë mosmarrëveshje, për shumë gjëra objektive dhe subjektive mes familjes së djalit dhe të vajzës, atë ditë në shtëpinë e djalit e ndiejnë njëfarë frike të përzier në ndenjë gëzimi. Andaj, edhe në të shkuar, edhe në të kthyer zgjidhen dy lajmëtar (nishanxhi), të cilët ndahen nga krushqit, dhe para të gjithëve e lajmërojnë dhëndrin se gjithçka është në rregull.

Pasi të zbresin të gjitha gratë prej qerres me nusen mbetet vetëm një grua. Pas pak vjen babai i djalit, apo vëllai më i madh dhe e zbresin nusen për dore deri te pragu i derës së mudbakut. Para se të zbres prej qeres, në tokë i shtrojnë tepsi e përmbi atë lëkurë. Mbi mbulesën e nuses i vihet freri i kuajve (si shenjë se prej tash nusja është nën kontroll të kësaj shtëpie), frerin e tërheq ndonjë vogëlush, kryesisht nipi. Përmbi krye i vihen 3 kuleç dhe kurani. Krejt kjo simbolizon : disiplinën, bereqetin dhe besimin në fe, që duhet t'i plotësojë nusja në shtëpinë e re. Kështu e qojnë deri te dera e mudbakut. Me këtë rast vajzat këndojnë:

*Oj e broj kush na garkoj
Baba xhypi na garkoj*

Jago baba na shkarkoj.

Edhe me këtë rast bëhet lavdërimi i shtëpisë së burrit, si në vargjet e poshtëshënuara:

Dole nause dole, pi asaj kasolle

Erdhe nause erdhe ke sarajet tona

Gjiete nause gjiete gjalin me musteqe.

Këtu na del në shesh se vajza që e kanë zënë për djalë është nga një derë më e varfër, gjë që tregon edhe sot e kësaj ditë për një ndasi klasore, por jo në atë kuptimin e plotë që ka pasur dikur, sepse në dallgë kohësh kjo ndasi ka filluar të asimilohet.

Kur mbrin te mudbaku, ndalet para derës dhe me njërin gisht e lyen tri herë derën me mjaltë, kurse vajzat këndojnë:

Lyje derën me mijalte oj nuse

Kaur da qielish ne t'kërsase, oj Lulie

Asmit tona ne t'plasin, oj nuse.

Kur hynë brenda në mudbak, atë e njoftojnë me mjetet me të cilët do të duhet të punojë në të ardhmen. Herën e parë e qojnë te oxhaku dhe tri herë i këndojnë: oxhake - buxhake, kurse nusja tri herë i bie me krye oxhakut. Më pas nusen e qojnë te shporeti në të cilën zihet jemeku, ku nusja i shtinë kripë. Më pas atë e qojnë te maxhja, duke mbyllur dhe çelur tri herë, ndërsa të pranishmit i këndojnë:

Çile maxhen, ne t'kërsase oj nuse

Nane jote, ne t'plase oj lule.

Pastaj, si rezultat i respektimit, nusja i përkulet vjehrrës tri herë në prehër, edhe atë me gjunjët. Vajzat tri herë këndojnë vargjet:

Unxhu grau nusie

Për atrin e vjerës-o.

Në fund, nuses te preni i vihet një djalë të vogël, ndërsa ajo i jep një dhuratë.

Në mëngjes, të rinjtë zgjohen herët. Më pas hyjnë prindërit dhe më të afërmit, duke kënduar me dahire vallëzojnë, duke i shoqëruar në valle herë djalin e herë nusen. Me këtë rast këndohet:

Trenafili n'faunt kataunit

O sa ernet paska çelun

Un kam çelun kam jeshue

Oborrin e jago babës

Odën o mori e dylber agës.

Mund të themi se këto këngë janë aq të larmishme, sa që me shembujt e tyre të nduarnduarta paraqesin një kolorit të pasur si nga përshkrimi, ashtu edhe nga forma dhe përmbajtja. Këto këngë, zakonisht i këndojnë vajzat më të rritura, por edhe gratë. Interpretimin e tyre e bëjnë në grupe dhe gjithmonë të përcjella me dajre.

Referencat:

- ASANI, Bexhet. (2011). *Lirika popullore shqiptare në Maqedoni*. Strugë.
- BERISHA, Anton. (1982). Krijuesi gojor dhe përcjellësi gojor, në “Çështje të letërsisë gojore”. Prishtinë 1982.
- BERISHA, Metush R., Reflektime të traditës kulturore (Karadaku i Preshevës), Prishtinë, 2013.
- BIDO, Agim Arti popullor në veshje e tekstil. Tiranë 1991.
- DERVISHI, Nebi. (2005). *Etnokulutura e Fushëgropës së Ohrit 1*. Tetovë (f.329 -330).
- Folklor shqiptar I, Inst. i Folklorit. Tiranë 1966.
- IBRAHIMI, Mustafa. (1993). *Thesari folklorik shqiptar nga rajoni i Pelagonisë*. Shkup.
- ISMAILI, Zejadin.(2000). Mbi folklorin dhe llojet e tij. Idriz Seferi, Kumanovë.
- KROSI, Ibrahim. (1964). Këngë popullore lirike nga Derveni. Shkup.
- KROSI, Ibrahim. (2000). *Lirika popullore shqiptare në Maqedoni*. Shkup.

- MURATI, Qemal (2008). *Kërçova – Hulumtime gjuhësore, etnografike dhe folklorike*. Shkup.
- NEZIRI, Zeqirja. (1997). Letërsia gojore shqiptare. Shkup.
- PLLANA, Shefqet. (1962). *Punë me këngët popullore shqiptare*. "Gjurmime Albanologjike". Prishtinë, 1/1962, fq.166.
- SEJFULLAI-REÇANI, Fehim. (1989). Këngë popullore të Gostivarit. Shkup.
- SHERIFI, Beadin. (1991). Këngë nga Prespa. Shkup 1991.
- SHERIFI, Beadin. (1993). Këngë lirike prespane. Korçë 1993.
- TUDA, Rahmi. (1998). Vlerësime folklorike. Tetovë.
- TUDA, Rahmi.(2000). Larmia e disa formave dhe motiveve folklorike. Strugë.
- VINCA, Nuhi. (1992). Lirika popullore shqiptare në regjionin e Strugës. 1992 Shkup.
- XHAGOLLI, Agron & BOGDANI, Ramazan. (2011). *Kërçova identitet kulturor*. UEJL, Tetovë.
- ZENKU, Abedin. (1979). *Lirika popullore e Kërçovës*. Në revistën "Jehona". Shkup. 1-2/1979, Viti XVII, fq.259-277.
- ZENKU, Abedin. (1982). Këngë lirike nga Kërçova. Shkup 1982.
- ZEQIRI, Mumin. (1995). Nga lirika familjare shqiptare e Kumanovës. Kumanovë.

NEXHAT ÇOÇAJ*Universiteti UBT – Prishtinë*

DASMA DHE DISA SPECIFIKA TË SAJ NË KRAHINËN E HASIT

Hyrje

Krahina etnografike e Hasit shtrihet në verilindje të Shqipërisë dhe kufizohet në veri e veriperëndim me rrethin e Tropojës, që i ndanë përroi i Skatinës dhe Gropa e Bytyçit, në perëndim ndahet nga Rrethi i Pukës me liqenin artificial të Fierzës, në jugperëndim, jug dhe juglindje ndahet nga Rrethi i Kukësit me lumin Drini e Bardhë. Drini i Bardhë vazhdon ta ndajë Hasin edhe me Vërrinin e Perdrininë, ndërsa me lumin Erenik kufizohet me Rekën. Si tërësi krahina e Hasit ka një sipërfaqe prej 912 km² dhe është ndër krahinat etnografike më të mëdha në trojet shqiptare. Krahina e Hasit shtrihet rreth e rreth Pashtrikut. Ajo i ngjan një ishulli.²⁹ Brenda kufijve të Shqipërisë Hasi ndodhet në pjesën veriore të rrethit Kukësit, kufizohet në jug me Lumën nga perëndimi me Malzinë, nga veriperëndimi me Bytyçin dhe Malësinë e Gjakovës. Pjesa e Hasit (Kosovë) shtrihet mes Qafë Prushit në veri dhe Drinit të Bardhë në jug duke zënë skajin jugor të Rrafshit të Dukagjinit me fshatrat përreth Drinit të Bardhë deri në Vermicë.

Në bazë të statistikave, në pesë vitet e para të mijëvjeçarit të tretë, Malësia e Hasit ka pasur rreth 80.000 banorë etnikisht shqiptarë (Hasi i Shqipërisë dhe ai i Kosovës), por më vonë ky numër është zvogëluar në masë të dukshme për shkak të migrimeve, që vazhdo-

²⁹Nexhat Çoçaj, Hasi- enciklopedi etnokulturore II (gjeografia, trashëgimia familjare, jeta sociale), Durrës, 2014, fq. 21.

jnë ende ta zvogëlojnë numrin e banorëve të fshatrave të Hasit. Pavarësisht migrimit të vazhdueshëm të banorëve të Hasit, aktualisht sot banorët e Hasit jetojnë në 72 fshatra, që në fakt paraqesin një krahinë kompakte etnografike me një nëndarje të njohur në popull si: ***Hasi i Rrafshit, Hasi i Brisë dhe Hasi i Gurit***,³⁰ dhe si vendbanime janë të tipit të shpërndarë nëpër lagje, me një distancë relative në mes lagjeve.

Dasma si moment kryesor i jetës familjare është një kod zakonesh, normash e praktikash të ndryshme, produkt shoqëror i shumë epokave dhe breznive. Me kalimin e kohës këto rite e tradita të shoqëruara me shumë ceremoni, kanë pësuar ndryshime si në aspektin përmbajtjesor të tyre, ashtu edhe në aspektin organizativ, ndonëse diçka është ruajtur nga lashtësia dhe është bartur deri në ditët tona, qoftë edhe në mënyrë fragmentare.

Kështu, në ceremonitë e dasmës në Has edhe sot në fillim të shekullit XXI gjejmë mjaft gjurmë të zakoneve të moçme e që disa prej tyre gjatë kohës janë përballur me ndikimet e huaja dhe kanë dalë fitimtare dhe nuk janë shuar në tërësi. Zakonet e dasmës hasjane, përfaqësojnë në mënyrë besnike reflektimin e formacioneve historiko-shoqërore të banorëve të krahinës së Hasit.

Martesa është një nga aktet më të gëzuara dhe më me rëndësi për jetën e njeriut, pasi ka të bëjë me zhvillimin e familjes dhe të shoqërisë në përgjithësi.³¹

Si gjithkund në trojet shqiptare edhe në fshatrat e Malësisë së Hasit ceremonia e dasmës zhvillohet në disa faza, që shoqërohen me një varg ritesh, të cilët, varësisht prej fazës së kësaj ceremonie, janë

³⁰Më gjerësisht të shihet Ramazan Bogdani, Hasi Korregografik, ASHRPSH, Tiranë, 1972, fq.9. &Teki Selenica, Shqipëria më 1923, Tiranë, 1923, fq. 106-108 &Xhavit Lashi, Qarku i Kukësit në rrjedhat e historisë, Tiranë, 2017, fq. 204.

³¹Nexhat Çoçaj, Hasi enciklopedi etnokulturore IV (ritet e lindjes, dasmës dhe vdekjes), Durrës, 2012, fq. 168.

shumë të pasur e të gërshtetuar me doke e tradita të trashëguara nga lashtësia. Por ka edhe rite të atillë, që me kalimin e kohës janë transformuar në rite të reja, por gjithsesi diçka nga e kaluara ka mbetur qoftë edhe vetëm si formë fillestare, apo edhe si shenjë se dikur ka ndodhur ashtu.

Disa nga specifikat e fejesës së vajzave

Fejesat dhe martesat në fshatrat e malësisë së Hasit janë bërë në bazë të rregullave të caktuara.

I zoti i shtëpisë ka pasur të drejtë ta fejojë qoftë djalin, qoftë vajzën edhe pa fjalën e babës e të nënës së të rinjve, pasi ata kanë qenë krahë pune dhe fitimet i kanë sjellë në shtëpi.

Përrjashtime në fejesa dhe martesa, sipas rregullave tradicionale, kanë bërë për ato vajza apo djem, të cilët janë rritur jetimë, përkatësisht pa njërin prind apo edhe pa asnjërin, me ç'rast kujdesi për ta ka qenë më i madh, ku për fejesën e këtyre fëmijëve të interesuar kanë qenë të gjithë anëtarët e rritur të familjes e në veçanti i zoti i shtëpisë dhe zonja e shtëpisë.

Por, kontribut në këtë drejtim kanë luajtur edhe dajallarët e tyre e që gjithsesi vullneti dhe interesimi i tyre nga familja, përkatësisht nga farefisi i fëmijëve është respektuar dhe është çmuar.

Fejesa e djalit apo vajzës konsiderohej e suksesshme, përkatësisht e mbarë, vetëm atëherë pasi i zoti i shtëpisë apo prindërit e të rinjve, t'i kenë sqaruar edhe këto rrethana:

- të fejuarit të mos jenë farefis nga të dy anët e prindërve, përkatësisht të mos kenë afërsi gjaku as nga ana e babës, që ndryshe kjo afërsi quhet vija e gjakut e as nga ana e nënës, që në popull njihet si vija e tamlit;

- të mos jenë lidhë më parë familjet e tyre me ndonjërin prej ritualeve si pirja e gjakut, kumbaria, dëshmitarë në pagëzim dhe kuro-rëzim të prindërve;
- të mos jenë të besimeve të ndryshme fetare etj.
- të jenë familjet e përafërta sa i përket gjendjes ekonomike dhe pasurisë së patundshme,
- të mos jetë familja e vajzës në shënjestër për amoralitet dhe për pabesi.³²

Zakonisht fejesat janë kryer me anë të shkuesisë, apo misitit, siç njihet ne Has. E që për shkak të ngjashmërive të shumta me rajonet tjera, nuk e shoh të udhës që të ndalemi në këtë pjesë, në përjashtim të paraqitjes së një kënge, që e pasqyron në mënyrë reprezentative gjendjen emocionale të familjes së dhëndrit, karshi shkuesit, i cili deri vonë në Has ka qenë i paguar mirë, për angazhimin e tij.

*“Na past qit misiti nusen e keqe
ju baftë udha lak e leqe,
Na past qit misiti nusen me behanë
mos e nxeftë as dill as hanë,
Mos na daltë nusja qysh na ka thanë
mos prit ai me fol t’vetinkërkan”³³*

Por në ceremonitë e fejesës nuk mungojnë edhe këngët mbi dëshirat e prindërve hasjanë, që e shprehin gëzimin për fëmijën e tyre edhe pse kur ndodh ceremonia e fejesës ai është në kurbet, që është specifikë për banorët e Hasit zeja e bukëpjekësin, pothuaj se në gjithë Ballkanin:

*“Mu kant ’banazog et ’shkoj për hava
T’shkoj tashoh Jeton agën n’furrshka asht tujba,
T’i kallxojnafaksë, qi puna ka maru*

³²NexhatÇoçaj, Hasi enciklopedi etnokulturore IV (ritet e lindjes, dasmës dhe vdekjes), Durrës, 2012, fq. 169.

³³Këndoi Nura Xhibixhiu, 78 vjeçe nga Lugishta e Hasit.

*Qaty ku patëm kqyr, nusja ka pranu...*³⁴

Në anën tjetër përmes këtyre vargjeve, mund të kuptohet se në një mënyrë apo tjetër gjatë fejesës së vajzave, vajzat në Has, kanë pasur mundësi që ta japin pëlqimin e tyre për fejesë. Dhe mënyra e komunikimit të pëlqimit të vajzës për fejesë, apo jo ka qenë përmes forma të ndryshme: përmes komunikimit të vajzës me nënën, apo motrën më të madhe, por gjithsesi forma më e veçantë ka qenë mënyra e komunikimit me anë të pjesëve të veshjes, që në fakt ka qenë mënyrë e komunikimit me shenja.

Simbolika e marhamës së fejesës me vija të kuqe në skajet e saj

Së këndejmi mund të thuhet se në ritet e dasmës, përfshi këtu fejesat dhe martesat një rol të madh kanë luajtur edhe veshjet tradicionale, që kanë kryer funksionin informative, pos funksionin tjetër për veshje dhe mbrojtje të trupit. Prandaj në masë të madhe veshja specifike e Hasit ka treguar edhe për statusin e vajzave. E shoh të udhës që me këtë rast t'i jap disatë dhëna për disa pjesë të veshjeve të vajzave, të cilat në fakt më shumë ka kryer funksionin informativ sesa ndonjë funksion tjetër.

³⁴Këndoi më 2003 Gjemile Quni, 81 vjeçe nga Kojushi i Hasit.



Në këtë foto siç shihet nga katër vajzave tëmnjëraështë e fejuardhetretjerajo.

Deri sa të sillet nga familja e dhëndrit materiali për përgatitjen e pajes, vajza edhe e fejuar ende e bartë në kokë shaminë me ngjyrë të verdhë (sarit) si të jetë e pafejuar, pasi shenjë e fejesës së një vajze është marhama e bardhë, që në fakt është simboli fejesës së vajzës hasjane, me anë të të cilit simbol i mundëson asaj daljen e lirë në fushë, në ruajtjen e bagëtisë dhe nëpunë të tjera në katund. Pra, nga momenti i bartjes së kësaj marhame (të bardhë) ajo e arrin shkallën më të lartë të lirisë dhe njëherësh edhe të mbrojtjes, sepse me anë të kësaj pjese të veshjes, ajo u tregon të tjerëve se është e fejuar. Për këtë plakat e fshatrave të Hasit thonë: “Çika prej ditës kur fejoheh, e mban me vete qefinin e burrit”.

Me këtë rast do të sjell disa të dhëna për mënyrën e përgatitjes ose të punimit të marhamës së bardhë. Në fakt kjo pjesë e veshjes së vajzave të fejuara punohet nga dikush i familjes së vajzës me material të dhëndrit. Pasi të punohet në vek, pëlhura pritët sa është i

gjatë trupi i vajzës dhe qepet sa është e gjerë vajza, pra mund të jetë dy deri tre pollë (pjesë e punimit të pëlhurës nëvek).

Varësishtesa kohë qëndron nën unazë siç thuhet, marhama e bardhë “RRITET” duke iu shtuar thekët në të gjitha anët, ose edhe punohet një e re nëse rritja e tejkalon parashikimin, apo nëse fejesa ka ndodhë sa ka qenë vajza shume e vogël.³⁵



Marhama me njëvijëtëkuqe

Marhama me dy vija të kuqe – ka simbolizuar faktin kur vajzat e bartin marhamën me një vijë të kuqe në të dy skajet, kjo është shenjë se vajza e fejuar, që e bart këtë marhamë:

- është fejuar pa e njohur të fejuarin e saj, përkatësisht pa e parë por jo edhe që nuk di asgjë për te,
- ka pranuar propozimin e prindërve dhe me pak fjalë ajo ka dhënë pëlqimin e saj për këtë fejesë.

Në fakt, me anë të kësaj shenje ajo tregon se nuk e ka kundërshtuar këtë fejesë dhe ndodh që gjatë viteve, deri sa të fejohej, ajo në gjergjef t’ia shtojë edhe ndonjë vijë kësaj marhame.

Po të donte vajza ta shprehte pakënaqësinë e saj, ajo do ta barte marhamën pa asnjë vijë me ngjyrë të kuqe, që në fakt është shenjë e mospajtitimit të saj me fejesën e bërë.

³⁵Për mënyrën e punimit të marhamës së fejesës, më gjerësisht të shihet NexhatÇoçaj, Hasi enciklopedi etnokulturore III (veshjet tradicionale të Hasis), Durrës, 2013, fq. 275-282.



Marhama me dy vijë tëkuqe

Marhama me dy vija të kuqe-

Marhama e çikave me dy vija të kuqe me një hapësirë në mes vijave deri në 5 cm, tregon se vajza që e bart këtë ka qenë në dijeni në lidhje më këtë fejesë dhe se pëlqimin e kanë dhënë prindërit e saj, pasi ajo në një mënyrë apo tjetër e ka dhënë pëlqimin e saj për të fejuarin.

Në anën tjetër, marhama me dy vija të kuqe dyshe, simbolizon gjendjen

mesatare të familjes së të fejuarit, që sqaron arsyen e dhënies së pëlqimit të vajzës, para se të shpallet fejesa.

Marhama me tri vija të kuqe- Ka qenë simbol i qartë që vajzat, që e kanë bartur këtë marhamë me tre vija të kuqe, e njohin të fejuarin e tyre dhe se ato dëshmojnë me anë të kësaj simbolike se, para se të fejoreshin, kanë pas rast të takohen, përkatësisht të shihen me të fejuarin e tyre dhe se pëlqimi për këtë fejesë ka qenë i plotë nga ana e vajzës, pavarësisht faktit se a kanë pasë fat të takohen ata para fejesës apo jo.

Fillimi i dasmës

Dasma në krahinën e Hasit ndahet në dy pjesë, si edhe në trevat tjera:

- Në dasmën që zhvillohet në shtëpinë e nuses, që në Has quhet përcjellje
- Në dasmën e shtëpinë e dhëndrit



Mënyra e vendosjes së kanës

Në përcjellje pos vendosjes së kanës dhe këngëve që këndohen nuk ka ndonjë pjesë shumë interesante, që do të dallonte nga pjesët tjera të hapësirës shqiptare. Ajo që duhet të veçohet me këtë rast është

fakti se koka e vajzës që martohet, mbulohet me kamzat e tlinave, që në fakt është pjesë e veshjeve që e përdorin vetëm gratë e martuara, përkatësisht nusët, që nga dita e dytë e martesës.

Fillimit të dasmës në fshatrat e Krahinës së Hasit i paraprinë ceremonia e ardhjes së bijave, që në fakt shënon zyrtarisht fillimin e dasmës në shtëpinë e dhëndrit dhe janë ritet e ditës së parë të dasmës. Familjarët e dhëndrit, sipas traditës kanë qenë të obliguar që të shkojnë t'i marrin bijat në shtëpinë e burrit, sepse dasma pa bija nuk bëhet. Ardhja e bija venë dasmë përcillet me këngë e valle dhe se dasmori, për këtë ceremoni ka angazhuar "godit" defaoren, a varësisht nga gjendja ekonomike edhe tupanat (lodrat).

„Fryni era e ra n'pengjere

Dada Dudë, mori a mun erdhe,

U thyvoja e ra n'fertere

Dada Tixhë, mori a mun erdhe...”³⁶

Sipas traditës se cila bijë që vjen në dasmë duhet të pritët me këngë nga vajzat e shtëpisë. Madje nëse janë në valle kur për dyer të oborrit hyn bija, vallja ndërpritet dhe ia marrin këngës:

³⁶Këndoimë 2006 SabrijaZekaj, 80 vjeçengaRomaja e Hasit.



Vallja e bijave, që zhvillohet ditën e parëtëdasmës, e që nis pas dite

*„Nisidilli me perenu,
Na kanë ardhbuijat, shumë jemi gzu
Kanë ardhLma, Gjyla, Hata
Tashpo mrrin edhe Kada vet e shtata...”³⁷*

Po këtë ditë, në mbrëmje organizohet darka e dasmës, në të cilën darkë shtrohet rakia kudo në fshatrat e Hasit pavarësisht besimit fetar. Kjo darkë organizohet kryesisht për familjarët, fqinjët, dajët e rrallë ndonjë mik apo dhëndër, përkatësisht varësisht nga gjendja a ekonomike. Viteve të fundit kjo darkë në zhargonin popullor po quhet “darka e qenve”, për faktin se pihet në mënyrë të pakontrolluar rakia dhe zakonisht organizohet në shtëpinë e dhëndrit, edhe sot kur ceremonia e dasmës bëhet nëpër hotele.

³⁷Këndoimë 2004 GjylaTemajngaKushnini i Hasit.

Ritet e gatimit të kulaçit

Ritet e gatimit të kulaçit, janë në fakt një ceremoni, që ndodhë pas mesnatës së ditës së ardhjes së bijave, ku të rinjtë dhe të rejat e fisit mbliidhen për ta gatuar kulaçin. Marrin pjesë edhe bija të martuara, por nuk janë aktive në gatimin e kulaçit e as të gjërave tjera. Meqë ky rit është i përhapur në gjithë hapësirën shqiptare, po i përmendi vetëm disa elemente, siç është mbytja e pulave në errësirë. Në fakt numri i pulave të mbytura nuk është i caktuar, por varësisht nga numri i pjesëmarrësve mund të shkojë deri në pesë. E veçanta është se pulave që planifikohen të përgatiten për pjesëmarrësit që gatuanë kulaçin, duhet t'u pritët koka në prag të derës, nëpër të cilin prag hyn nusja për herë të parë në shtëpinë e dhëndrit. Therja e pulave për natën e kulaçit, bëhet me besimin se po u "pritën" mundësitë e lindjes së vajzave nga ana e nuses, që pritët të vijë në shtëpi. Pos terjes është e lidhur me një besim mjaft interesat edhe mënyra e fshehjes së pendlave të pulave të therura, ku ato duhet të fshihen në një vend të sigurt, që të mos gjinden deri sa të vjen nusja në shtëpi, në të kundërtën besohet se nëse gjenden pendlat, nusja do të përballët me shumë gjëra negative, përkatësisht nuk do të ketë harmoni në jetën bashkëshortore.³⁸

Gjithashtu e veçantë që duhet të potencohet me këtë rast edhe gatimi i kulaçit nga një djalë me dy prindërit gjallë. Pos këtij kushti, edhe mielli me të cilin gatuhet kulaçi i nuses duhet të gatuhet vetëm me miell të familjes, pro të nxjerrë nga gruri i familjes, e nuk preferohet të jetë i blerë. Po në lidhje me miellin, vlen për t'u theksuar se mielli i tepërt si dhe troshat, që mbeshin nga gatimi, nuk hidhen, por ruhen dhe i shtohen gatimit të bukës nga nusja në ditën e tretë të ardhjes së saj në shtëpinë e burrit.³⁹ Ka edhe shumë

³⁸NexhatÇoçaj, Hasi enciklopedi etnokulturore IV (ritet e lindjes, dasmës dhe vdekjes), Durrës, 2012, fq. 256.

³⁹E dhënë gojore e Ziza Kërhani, nga Guruzhupi i Hasit.

veçori tjera, por i vetëdijshtëm se në një shkrim të shkurtër nuk mund të thuhet të gjitha, po e jap një këngë, që do ta ilustronte një pjesë të këtyre traditave:

*“Filloj darsmja për me u nisë
për hajrt’koftë, o i zoti i shpisë,
u gatu kuleçin’magjet’re
për hajrt’koftë, oj nanë, kjo re,
u qit kuleçin’magjet’kuqe
për herë t’koftë or vlla kjo nuse,
u zu kuleçi me kangë e gzim
shti motmot knofshëm për shtim.”⁴⁰*

Ritet e grishjes

Ritet e grishjes në Has janë të njohura dhe kanë disa nga rregullat që e veçojnë dasmën hasjane nga dasmat tjera. Kështu grishja në Has bëhet vetëm brenda një dite, përkatësisht të hënën, kur nusët merreshin të enjten, dhe të enjten kur nusët merren të dielën. Me pak fjalë do t’i përmendi disa veçori siç është grishja e miqve vetëm paraditen e ditës së hënë e në asnjë mënyrë nuk preferohet pasdite. Grishtarët janë njerëz të caktuar nga familja e dhëndrit, të cilët për në fshatin ku kanë të grishin (thirrin) për dasmë duhet të nisen nga shtëpia e tyre para se të lind dielli, pra herët në mëngjes. Zakonisht shkuarja e tyre bëhet me kuaj, në përjashtim në Zym të Hasit, kur grishtari vishet me një veshe të veçantë dhe mban në dorë një shishe të rakisë, pasi ai në Zym grishjen e bën vetëm në Zym, pasi Zymi është i vetmi fshati Hasit, që martesat i bën brenda fshatit.

*“Ani ik moj megjull,
mos t’shoh me sy,*

⁴⁰E kënduamë 2002 Zelfije Krasniqi nga Damjani I Hasit.

*se tash po i nisim grishtart' e ri
kemi nis grishtart' e ri
me na thirr miqsinë, o shpi për shpi
shpi për shpi n'katunn'katun
jem shpi e madhe e kemi miq shumë.*"⁴¹

Dita e marrjes së nuses



*Veshje e nuses, që vjen nusja nga shtëpia e
prindërve në shtëpinë e dhëndrit
është e martuar.*

Në pamundësi që një kumtesë të përfshihen shumë fenomene dhe veçanti të dasmës së një krahine, po i përmendi edhe disa fenomene, që në mënyrë ilustruese e dëshmojnë për ndryshimet e rriteve të dasmave nga njësitë tjera krahinore.

Së pari duhet të theksojmë se nusja në ditën e martesës ajo vishet me një veshje të veçantë, e cila është gërshe-tim në mes veshjes së nuseve dhe të çiknisë. Pra ka elemente të përbashkëta, e që në fakt janë pjesë të veshjeve me funksion in-

formativ, që tregojnë se ajo ende është vajzë dhe se nuk

⁴¹Këndoi më 2005 Ajne Likaj nga Krajku.



Dalja e nuses nga shtëpia e prindërve deri në fund të lagjes e mban kokën ulur dhe trupin e kërrusur dhe mbahet për krah nga vëllezërit e saj, apo kushërinjtë.

Siç shihet në fotografi, pjesë të veshjeve siç janë këmisha, kullani (brezi) dhe dorëzat janë pjesë e veshjeve të nuseve, ndërsa dimitë dhe shamia janë pjesë të veshjes së çikave, edhe pse dimitë e martesë janë të bardha e të shoqëruara me pika të vogla të bardha.

Po në këtë foto shihet edhe mënyra e ngjyrosjes, apo teleisjes së fytyrës së nuses, ku dominon figurat e diellit, që paraqesin dëshirën e prindërve, telatores (asaj që e bën rregullimin e nuses), që nusja ta kalojë jetën e shëndetshme si dielli në jetën bashkëshortore.



Mënyra e zbritjes së nuses nga kali, në shtëpinë e dhëndrit



Në këtë foto shihet se nusja e sapoardhur, ende pa iu hequr duvaku nga koka, që është i punuar nga tre shoka (breza) të grave me ngjyra të kuqe, i vendoset freri i kalit, që simbolizon mbajtjen nën kontroll të gruas nga ana e burrit



Vendosja e plisave të bardhë mbi kokën e nuses, që simbolizon lindjen e fëmijëve të gjinisë mashkullore, që në fakt ishte dëshirë në të kaluarën pothuaj se e të gjithë familjarëve të dhëndrit, por edhe të nuses.



Veshje e nuseve në dy ditët e para të martesës, ku tani veshja e nuseve ndryshon dukshëm nga veshja e çikave dhe nga veshja e ditës së ardhjes së nuses në shtëpinë e dhëndrit.

MINIR ADEMI, ITSHKSH - SHKUP

AVNI AVDIU, UNIVERSITETI 'NËNË TEREZA' - SHKUP

RITET E DASMËS TRADICIONALE SHQIPTARE NË KARADAKUN E KUMANOVËS

Hyrje

Qysh prej se ekziston njeriu është shfaqur nevoja për të pasur jetë të përbashkët të mashkullit dhe femrës dhe për vazhdimin e jetës përmes lindjes së fëmijëve si trashëgimtarë të tyre. Kjo arrihet me kurorëzim e martesës. E martesë ka disa rite.

Çdo rit ka simbolikën e vet, që përçon domethënie dhe kuptimësi për kulturën e popullit. Për shembull shamia e kuqe me të cilën vajzës i mbulohet koka simbolizon, virgjërinë dhe ndershmërisë e saj, vaji i saj simbolizon pikëllimin për beqarinë, gostia e miqve shpreh gëzimin për miqësinë e re dhe respektin reciprok të tyre, e kështu me radhë.

Edhe pse nga ato rite ka elemente arkaike, të pakuptimta, e bile edhe qesharake, prapëseprapë ka edhe të tjera që e mbajnë gjallë kulturën dhe qenien tonë etnike dhe si të tilla duhet kultivuar. Zaten edhe ky punim e ka këtë qëllim, që të paktën duke i mbledhur të dhënat gojore nga të moshuarit, të ofrojmë vlera autentike popullore shqiptare, ashtu që ato të ruhen ndër breza të tërë në kujtesën tonë kolektive. Nëse koha imponon që ato të mos praktikohen më e të flaken tutje, atëherë të paktën të mos harrohen.

Mirëpo, botëkuptimi i shqiptarëve në përgjithësi duket se ka ndryshuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Këto rite kanë filluar dalëngadalë të zbehën e madje edhe të konsiderohen si demode.

Ky studim synon të tregojë çështjen e martesave të hershme tradicionale, në veçanti në Karadakun e Kumanovës, e që janë përshkuar me disa rite e ceremoni karakteristike të kohës, të bartura ndër shekuj deri në ditët tona.

Rëndësia e dasmës dhe riteve të saj

Pa dyshim, dasma me ritet e saj konsiderohet si një ndër ngjarjet më të rëndësishme e më të hareshme të gjithë popujt e botës. Këto rite një ashtu kanë zënë vend të rëndësishëm edhe në traditën kulturore të popullatës së Kumanovës, si pjesë përbërëse e etnosit shqiptar⁴².

Ruajtja, mbrojtja dhe kultivimi i së kaluarës tradicionale të të parëve tanë ka qenë, është dhe do të mbetet gjithmonë thesari ynë i çmuar kombëtar. Ndër vlerat e rëndësishme tradicionale janë edhe ritet e dasmave, të cilat populli shqiptar i ka ruajtur me një përkushtim të madh.

Dasma paraqet paradigmen më të mirë përmes së cilës mund të shtyhet rrjedha e ndryshimeve brenda kuadrit të vlerave tradicionale. "Nëpërmjet dasmës, - thotë studiuesi Clifford Geertz, barten mesazhe të nduarduarshme, si dhe vlerave të rëndësishme kulturore me të cilat karakterizohen ritet e kalimit"⁴³.

Vlen të ceket se me anë të dasmës si dukuri sociale, ndodh riorganizimi i njësisë më të vogël shoqërore - familjes. Ndryshimet që shfaqen përmes dasmës pasqyrohen në dy kahe: njëri ka të bëjë me privimin e një bashkësie nga një anëtar, i cili i bashkëngjitet një bashkësie tjetër, kurse i dyti është i ndërlidhur me formimin e bërt-

⁴² Mumin Zeqiri, *Besime Popullore Shqiptare - Rite e Mitologji në Rajonin e Kumanovës*, ITSHKSH, Shkup, 2016, f. 174

⁴³ Clifford Geertz, *Ritual and Social Change: A Javanese Example* & Gerc, K., *Tumačenje kultura I-II*, Biblioteka XX vek i Čigoja štampa, Beograd, 1998, str.276-277

hamës së re familjare me ç'rast ndryshon edhe statusi social i të porsamartuarve. Këto dy kahe e përcaktojnë ritin e dasmës si sistem i kalimit dhe krijimit. Perceptimi i dasmës si sistem i kalimit është i ndërlidhur me veprën e etnologut të njohur botëror A. Van Genep, i cili në librin e tij të botuar më 1909 në Francë me titull *Les de passage* (Ritet e kalimit) i vendosi bazat e teorisë së riteve që shënojnë kalimin nga një status në një status tjetër social, ose nga një periudhë në një periudhë tjetër kohore. Teoria e Genepit vazhdon të zbatohet gjerësisht edhe sot e kësaj dite në kuadër të teorisë së komunikimit të riteve, veçmas në antropologjinë sociale britanike⁴⁴.

Ritet e dasmave në Karadakun e Kumanovës

Shumë familje të anës së Karadakut të Kumanovës, me shumë kujdes i kultivuan ritet e dasmave, duke bërë që ato të mos zhduken. Kështu, sot e kësaj dite vazhdimisht bëhen përpjekje që ato të kthehen në mënyra të ndryshme edhe gjatë ceremonive dasmore të kohës së sotme. Karadaku me rrethinë krahës ruajtjes së dialektit autentik dhe veçorive të tjera kulturore, karakterizohet edhe me ruajtjen e organizimit të dasmave tradicionale. Ritet e dasmave në anën e Karadakut të Kumanovës që i kemi hulumtuar nga gojëdhëna të ndryshme, i takojnë shekujve të kaluar. Lidhshmëria e të kaluarës me të sotmen, ka ndikuar që banorët e kësaj ane të mos lejojnë që traditat, doket dhe ritet e dasmave të zhduken dhe krijuan mundësi që në momente të caktuara ato të rikthehen në mënyrën më të mirë të mundshme.

Pa dyshim, martesë në jetën e njeriut zë një vend shumë të rëndësishëm. Ky akt i lartë familjar që lidh fatin e dy të rinjve për

⁴⁴ cituar nga: Izaim Murtezani, *Rite dhe praktika magjike të ciklit jetësor*, ITSHKSH, Shkup, 2017, f.73

një jetë të përbashkët është shumë me rëndësi për familjen e çiftit, pasi që krijon lidhje miqësie.

Dasma, e veneruar nga dioptria e teorisë së riteve të kalimit, karakterizohet me këto faza konkrete të përgjithshme: në kohën fillestare të dasmës mbretëron gjendja initiale paramartësore në të cilën iniciantët, ose rishtarët kanë status të “djalit” ose “vajzës”, ose i përkasin kategorisë “i pafejuar” dhe “e pafejuar”. Ritet e separacionit ose ndarjes fillojnë me dërgimin e shkuesit për lypjen e ndonjë vajze dhe vazhdojnë deri në ditën e dasmës kur vajza braktis shtëpinë e saj⁴⁵. Dëshira e madhe e dy të rinjve për martesë është pritje vite me radhë për të filluar jetën bashkëshortore. Sipas traditave tona, në rajonin e Karadakut me rrethinë djali e vajza nuk janë njohur më herët para fejesës. Fejesa është realizuar nga prindërit, të cilët pasi që kanë dëgjuar për dikë o ndonjë rast të mirë, i janë drejtuar dikujt që qëndronte afër me familjen e vajzës që e dëshironin për djalë, edhe e kërkonin të njëjtën. Se a do t'i përgjigjeshin familja e vajzës, kjo ishte çështje që mbetej të shihej në të ardhmen. Mu për këtë, fejesa dhe martesë sa dëshirë ishte edhe ankth i pritjes gjer në momentin e pranimit nga familja e vajzës, bile ndoshta edhe deri në ardhjen e nuses në pragun e shtëpisë së djalit.

Dallimet në fejesë e martesë, ndërmjet vendeve fushore dhe atyre kodrinore malore në Karadakun e Kumanovës, ishin me pak ndryshime. Në esencë ishin të përafërta.

Në këtë punim mëtohet të trajtohen këto rite në fshatrat fushore: Hotël, Likovë, Nakushtak, Vaksicë, dhe ato kodrinore - malore: Runicë, Allashec, Izvor etj.

⁴⁵ Izaim Murtezani, *Rite dhe praktika magjike të ciklit jetësor*, ITSHKSH, Shkup, 2017, f.75

Tradita përmes rrëfimeve autentike të të moshuarve

Njëra nga banoret më të vjetra që ka kaluar një shekull jetë, lokja Azbije Iseni, e lindur më 12.04.1915 në fshatin Hotël, dhe e martuar po në këtë fshat, foli me nostalgji për të kaluarën dhe dasmën autentike të martesës së saj. Ajo i mbante mend shumë mirë këto doke të vjetra të dasmës shqiptare. Me rastin e ditëlindjes së 104-të të saj (12.04.2019), zhvilluam një bisedë me të:

"Kam qenë vajzë e mirë dhe nuk më kanë lanë me dal prej fshati", - nisi me shaka rrëfimin. "Kur djali kalonte në moshën e pjekurisë, pra merrte pamjen dhe trupin e burrit, familja fillonte të interesohej për nuse. Ndryshe thuhej 'me ja gjet një rob për shpi'. Kjo në kuptimin e fjalës nuk nënkuptonte rob për punë, por njeri që do të kujdesej për burrin dhe familjen e tij. Shpesh, për vende të mira, njerëzit vet i afronin ndokujt ndonjë nuse. Më pas dërgohej mësimi (shkuesi) për t'ia kërkuar vajzën për djalë", - sqaroi lokja Azbije.

Adem Ademi, i lindur më 1926, në fshatin Hotël, kujton: "Në kohën tonë thoshin pleqtë (përcjell kujtimet e gjyshit të tij, Sulejman Ademit që kishte jetuar 105 vite, 1852-1957), se për djalë mundesh të trokitsh edhe në derën e mbretit, e për vajzë jo. Familja e djalit e dërgonte mësimin për ta kërkuar vajzën. Kur e shihte të udhës se familjet mund të përshtaten për miqësi, mësimi e ecte punën deri në fejesë. Ky bashkim, i dy të rinjve bëhej pa u takuar dhe pa u njohur mes vete vajza dhe djali, por të gjitha punët rridhnin përmes mësitit, ku shpeshherë kishte edhe malverzime dhe shitje të interesave të njëres a palës tjetër. Kur afroheshin qëndrimet e dy palëve, mësimi shkonte për ta marr dorën e nuses dhe të shtëpia e djalit tuboheshin shumë mysafirë dhe e pritnin me shumë gëzim fjalën e marrë, që në popull njihej si '*dora e nuses*'. Mirëpo,

kishte edhe raste të dështimit nga ana e njerëzve zemërthyer, dhe kjo e prishte 'dorën' e nuses"⁴⁶.

"Në këto kohëra për fejesën e vajzës pyeteshin burrat, e në veçanti babai, duke mos pas të drejt të përzihet nëna. Fjala e babait ishte përfundimtarja ndër burra. Kishte raste kur nëna nuk shprehte gatishmëri për ta fejuar vajzën, por babai nga kryeneçësia e të qenit burrë dhe ndjesia se vetëm ai vetej në atë shtëpi, e jepte dorën pa e pyetur fare gruan e tij, me ç'rast thyhej zemra e nënës, e cila e kishte lind dhe rrit deri në atë moshë"⁴⁷.

Gjatë rrëfimit të tij për ritet e dasmave, Bexhet Destani i lindur më 1929 në fshatin Izvor, tash me vendbanim në fshatin Çerkez, është shprehur se më tepër ishte prezentë kryeneçësia te fshatrat malor të Karadakut, duke u nis nga tradita e burrave malësor se në shtëpi pyetët burri e jo gruaja. Sipas tij, kjo ishte evidente edhe në shumë fshatra të tjerë si në Bellanoc, Shtrazë, Gushincë, Runicë, Izvor, etj.

"Në kohën tonë, nuk jemi takuar e njoftuar mes veti, por ashtu si ka thënë baba edhe është bë. Vajzat fare nuk janë pyetur për pëlqimin e tyre. Kështu ishte fati i vajzave tona ku kishte raste edhe të mospajtimit të çiftit bashkëshortor, por me vite të tëra kanë qëndruar të shtypura nga burri duke mos guxuar të thyejnë vendimin e babait. Pasi mësi arrinte të bind familjen e vajzës se djali është i mirë dhe është prej familjes së mirë, ai e dërgonte dorën e nuses. Ai merrte shpërblime nga familja e nuses dhe familja e djalit. Këto ishin traditat shqiptare, kur burri njihej për burrë e gruaja për grua", shprehet Destani.

⁴⁶ Minir Ademi, *Hotla nëpër kohë*, Kumanovë, 2017, fq.101

⁴⁷ Bexhet Destani, i lindur më 1929, Izvor;

"Sot të rinjtë: djemtë, nipat e mesat tona i harruan ato tradita, andaj sot po ndodh shumëçka në mesin e popullit tonë", - rrëfen plaku 99 vjeçar, Selver Aziri, nga fshati Hotël.

E gjithë kjo ishte sa i përket fejesës së dy të rinjve, që i ndërronin unazat dhe ishin të fejuar disa muaj ose vite derisa nusja përgatitej për çejzin e nusërisë dhe në popull njihej se janë "nën unazë". Kështu pritej deri kur arrihej marrëveshja mes familjeve për ta caktuar ditën për dasmë, e cila ndër këto treva njihej si "vadë".

Sipas marrëveshjes mes familjes së djalit dhe vajzës, të fejuarit nuk takoheshin gjatë fejesës, pra respektohej marrëveshja. Vajza e fejuar nuk i dilte vjehrrit ose vjehrrës para martesës. Pamja e nuses, e bukur a e shëmtuar shihej, veç kur ajo vinte në oborrin e shtëpisë së burrit. Atëherë tërhiqej duvaku me pistoletë, ose ndonjë hekur dhe gjuhej disa herë në qiell, me ç'rast zbuloheshin edhe fytyra e saj.

Dasma fillonte që nga dita e martë në mbrëmje, kur ftoheshin familjarët më të afërt dhe shpallej dasma. Shpreheshin urimet dhe në fund të të gjitha diskutimeve merrej vendim që për ditën e mërkurë të dërgoheshin petkat te miku i ri. Në atë natë caktohej se kush do të shkonte me petka, kush me krushqit dhe kush me dhëndrin. Në ditën e mërkurë, tuboheshin familjarët e djalit dhe atë ditë i çonin petkat te miku prej ku do ta merrnin nusen. Atje shtrohej drekë për familjarët e dhëndrit. Zakonisht marrja e nuses ishte ditën e enjte ose të diel. Te familja e djalit nga dita e enjte hapej konaku dhe fillonin jo vetëm familjarët, por i tërë fshati vinin për urime për dasmën e nisur dhe konaku mbyllej ditën e diel. Ditën e enjte te djali shtrohej darkë për familjarët, të cilën e përgatitnin familja e djalit, duke u ndihmuar nga fqinjët dhe nga vajzat që gatuanin bukën, ndërsa gratë më të moshuara e përgatitnin ushqimin. Në orët e vona të natës tuboheshin të rinjtë djem e vajza të familjes dhe ishte nata e kulaçit. Fillonte gëzimi, vallja, defi me këngë të ndryshme, ndërsa një vajzë e zinte kulaçin, së cilës i vendosej një kapelë e

burrit dhe ajo e merrte një enë dhe miellin, kurse duke e zënë kulaçin vajzën e këndonin vajzat e tjera. *'Kush e zë kulaçin do ta merr kovaçin'* këndohej pandërprerë gjersa në kulaç ishte vendosur një pare e hekurt, por pa e parë se ku po e vendos ajo që e zinte kulaçin, ishte sekret nga ajo. Po ashtu natën e kulaçit ziheshin misër dhe njihej në popull si *'nata e kallamoçave'*. Të premtën përsëri vazhdonin tërë ditën urimet dhe në mbrëmje përgatitej darka për të afërmit. Muzika dhe gazmendi bëhej pandërprerë dhe në mbrëmje caktoheshin për thirrjen e mysafirëve për darkë. Ditën e shtunë vazhdonin urimet nga dashamirët dhe në mbrëmje përgatitej darkë për mysafirët e ftuar. Nëse dasmori ofronte daulle, çdo mysafiri që vinte me dhurata, daullet i rrihnin gjersa mysafiri i jepte të holla ekzekutuesve të muzikës. Derisa tuboheshin të gjithë mysafirët e ftuar, shtrohej darka e përgatitur. Të afërmit e djalit edhe pas ngrënies së darkës bënë gazmend dhe burrat merrnin vallen⁴⁸.

Ata që ishin mirë të përgatitur për valle kombëtare tradicionale të gjithë rrotull përnjëherë fillonin të këndonin:

*Kur kanë nis e me knue
T'ka pas qefi mej ndigue
Lezet sini mej shikue.
Kur kanë pas me nda mejdana
Gjithë janë pre me tagana,
Gjithë përreth i kan shikue
Kush ka tret kush ka fitue*⁴⁹.

Këto ishin vargje të këngëve që shpesh këndoheshin nëpër dasma, përderisa gjatë ditëve të ceremonive të dasmës organizoheshin edhe lojëra të ndryshme.

⁴⁸ Zenel Ademi, i lindur më 1933, Nikushtak;

⁴⁹ Instituti Albanologjik i Prishtinës, Këngë të ndryshme popullore, Prishtinë, 1982, f.380;

Pas largimit të mysafirëve, të afërmit e djalit, vajza e djem tuboheshin në shtëpinë e djalit. Kjo quhet '*nata e pulës*'. Pulat preheshin nga mbrëmja dhe ziheshin e piqeshin mirë. Përgatiteshin për të pasur sasi të mjaftueshme dhe duke bërë gëzim me def dhe duke vallëzuar i hanin kofshat e pulave. Në mëngjes familja e djalit zgjohej më herët dhe fillonin përgatitjet e qerreve për ta marr nusen. Nëse nusja ishte nga ndonjë vend malor, përgatiteshin kuajt dhe shkonin për ta marr nusen me kuajt.

Për nusen që e merrnin nga malësia e Karadakut, rrëfen edhe Ramize Aliti, e lindur 1927 në fshatin Runicë, dhe e martuar në Sllupçan: "Ajo nuk vinte e përgatitur me duvak, por me një kalikuse të kuqe, me fytyrë të mbuluar dhe hipur mbi kali. Me muzikë mbërrinin në fshatin e dhëndrit. Krushqit drekonin te familja e nuses. Kur arrinte nusja në fshatin e dhëndrit, ishin festime të mëdha deri në orët e vona, me ushqim, pije, këngë dhe gazmend".

Nëse nusja ishte nga vendet fushore përgatiteshin qerret me thupra prej druri, lakoheshin dhe mbi to vendosnin qilima të kuq. Në pjesën e parë e të fundit vendosnin nga një pëlhurë që të mos shiheshin gratë ose inxhet në qerre. Po ashtu përgatiteshin edhe qetë, që zbukuroheshin me disa tufa të kuqe në ballë. Caktohej se kush do t'i tërhiqte qetë. Aty kah mesi i drekës përgatiteshin inxhet, burrat dhe krushqit për të shkuar për ta marrë nusen.

Dasma te familja e nuses fillonte nga dita e enjëte. Nusja i vishte petkat e burrit dhe fillonte me shaminë e kuqe mbi kokë dhe e mbulonte gjithë fytyrën. Shoqëruesja e martuar që ia kishte veshur petkat fillonte e para të qaj: 'uuuuu, uuuu, uuuu'. Pas saj fillonte të qante vajza duke i përqafuar shoqet e saj dhe gjithë familjen me rend. Të gjithë ia uronin nusërinë. Natën e dytë, nuses i ngjitej kana dhe njihej si '*nata e kanës*'. Ditën e enjte dhe ditën e premte, edhe te vajza thirrreshin mysafirë për darkë. Vajza ftonte më tepër shoqërinë e vet, të afërmit e familjes dhe mysafirë të tjerë.

Ditën e diel ose të enjten, nusja përgatitej me fustanin e bardhë që sigurohej nga burri dhe i vihej një shami e kuqe në kokë, duke ia mbuluar gjithë fytyrën. Posa arrinin inxhet dhe uleshin në vendet e tyre, atëherë hynte nusja në dhomën e inxhëve dhe së pari ua merrte dorën vjehrrës dhe disa të afërmeve të djalit. Pastaj, ajo kthehej mbrapa dhe në një skaj të dhomës duke e shoqëruar nga një ose dy shoqe përdore, një fëmijë nga ana e djalit i hidhte elbebija mbi kokë në shaminë e kuqe, pastaj nuses i hiqej shamia dhe i shihej fytyra nga të gjitha inxhet. Aty ishte edhe pamja e parë e nuses me vjehrrën dhe me familjen. Ajo gjatë gjithë kohës sa ishte e fejuar ose sikurse thuhej se ‘ka ndejtë nën unazë’, nuk kanë mundur të shihej asnjëherë nga familja e burrit e të mos flasim për burrin.

Nusja pas kësaj ceremonie prapë e vendos shaminë e kuqe mbi kokë, duke e mbuluar fytyrën dhe del në oborr për t'u përshëndetur me farefisin dhe familjen. Të gjithë i *merr në grykë* dhe i vajton, ndërsa nusen e shoqëron një e afërme, e cila mban një qese dhe të gjithë ata që përshëndeteshin, nuses i dhuronin të holla. Në fund nusja përshëndetej me vëllezërit, motrat, babanë dhe nënën, duke i vajtur me zë dhe duke u ndarë nga familja që kishte jetuar një periudhë 18 ose 20-vjeçare te baba. Kjo ishte ndarje e dhimbshme shpeshherë shoqërohej edhe me vaj nga burrat që nuk arrinin të përmbaheshin nga dhimbja e ndarjes së babait dhe nënës me vajzën. Dhe pas kësaj, nusja afrohet nga vëllai deri te qerrja. Vëllai e hip në qerre dhe pastaj thirren inxhet dhe në fund dalin edhe krushqit. Pas kalimit të qerres së fundit, disa burra ndalen për ta dorëzuar amanetin, që ndryshe njihej ‘me ja ba teslim’. Fjalët e babait të nuses ishin: ‘po ta baj teslim, gjaku im, robi i joti’, dhe nga ai moment në largim pak nga dera, burrat e familjes së djalit shkrepnin armët në shenjë gëzimi për nusen që e marrin.⁵⁰

⁵⁰ Bexhet Destani, i lindur më 1929, Izvor;

Sipas kujtimeve të Selver Azirit i lindur më vitin 1920, në periudhën kur ai ishte martuar, qerret të renditura njëra pas tjetrës të tërhequra me dy pen-kije, zakonisht i tërhiqnin shërbyesit e shtëpisë që ishin të zënë me punë të pronari. Njëri nga anëtarët e afërt të familjes dilte në fund të rrugës dhe e lidhte një peshqir për dore dhe i thirrte krushqit për darkë ose drekë. Shpesh ai që bënte dasmë të madhe, blinte edhe një dash për shpërblim dhe organizonin vrapime me kuaj. Ai i cili do ta zinte vendin e parë me kali në igdil e fitonte si shpërblim dashin. Po ashtu gjatë thirrjes së krushqive çdo njëri, porositej që të merrte me vete lugën e drurit dhe të vijë të hajë ashure. Rrugës derisa nusja afrohej të shtëpia, njeri nga anëtarët e familjes, zakonisht ishte i ri, nga nusja e merrte boçën e kompletuar. Ai vraponte para qerreve për t'ia dhuruar dhëndrit, i cili e shpërblente me të holla. Pasi afroheshin qerret për në shtëpi me nusen, qerrja e parë ishte me nusen dhe vjehrrën dhe anëtarët e ngushtë të familjes.⁵¹ Para se të arrinin qerret me nusen, në afërsi të dyerve të hyrjes, qëndronte njëri nga anëtarët e familjes, duke e shoqëruar dhëndrin me një pjatë të mbushur me oriz, grurë dhe sheqer. Nga qerrja e parë e nuses fillonte të gjuaj me oriz dhe sheqer e deri në qerren e fundit. Me të arritur nusja bashkë me krushqit, babai i djalit afrohet afër qerres. Nusja vjehrrit ia vendos një boçe, ndërsa vjehrrin e zbret nusen nga qerrja, e vendos afër këmbëve tepsinë e mbushur me ujë që të shkelë pikë së pari mbi të. Pastaj ia largon duvakun me një revole dhe shkrep disa plumba në ajër në shenjë gëzimi për nusen e marrë në familje.

Zenel Ademi, i lindur më 1933 në fshatin Nikushtak, tregoi: "Pasi të arrijë nusja në familjen e djalit, pasi t'i hiqet duvaku, vajzat këndojnë këngë për nusen 'Mashalla, mashalla... Sa e mirë na doli nusja...'. Burrat qëndrojnë më larg nga gratë dhe e shikojnë nusen, e cila qëndron në këmbë dhe i mban sytë e mbyllur, ndërsa motrat

⁵¹ Selver Aziri, i lindur më 1920, Hotël;

e burrit e kapin për krahu dhe e dërgojnë te pragu i shtëpisë. Me dorën e lagur me sherbet nusja prek me dy gishta zemrën e vjehrrës dhe prapun e lartë të derës tri herë në hyrje të dhomës së familjes ku do të jetojë. Pastaj e dërgojnë në dhomën e shtëpisë dhe e ulnin në tri kapelat e burrave.

Para se ta dërgojnë nusen në dhomën e dhëndrit, e mashtrojnë duke i thënë se: 'Po të thirr daja'. Kur ajo del, e sheh dhëndrin. Vajzat e tjera rrahin shuplakë, duke e mashtruar nusen. Ky është shikimi i parë i nuses me dhëndrin. Pastaj atë e dërgojnë në dhomën e djalit për ta njoftuar me dhëndrin. Këtu zhvillohet takimi i tyre i parë. Djali për herë të parë qëndron me nusen dhe jo më shumë se 10 minuta. Pastaj familja e djalit përgatiten edhe për darkën e hoxhës për t'i kënduar lutje. Darka përgatitet shumë e begatshme. Në darkë ftohen edhe anëtarët e familjes. Pas shtruarjes së darkës, imami i fshatit këndon lutje dhe dhëndri përshëndetet për dore me hoxhën, pastaj me babanë dhe me më të moshuarit. Me të dalë nga dhoma e burrave, skaj dhomës së nuses, tubohen gjithë të rinjtë vajza dhe djem si dhe afër derës qëndron edhe nëna për t'u përshëndetur për herë të fundit me djalin si beqar. Dy prindërit, dhimbshëm e përjetojnë këtë përshëndetje si largim të djalit të tyre nga beqaria. Dhëndri afrohet deri te dera e nuses me shumë gazmend, gjersa defi dhe kënga e vajzave vazhdojnë. Në afërsi të derës duke hyrë në dhomën e nuses goditet nga shokët e tij në shpinë. Në hyrje vendoset një enë me ujë dhe ai është i detyruar që ta godasë enën me ujë dhe të hyjë brenda në dhomën e nuses. Në brendi nusja është e shoqëruar nga një grua e afërt e familjes, e cila pas disa minutave del nga dhoma.⁵² Ditën e nesërme, para se të thirren të afërmit për në petulla, një pjatë me petulla dërgohet te dhoma e nuses. Thirren të gjithë të afërmit për të ngrënë petullat e mëngjesit, të cilat përgatiten nga nëna dhe të afërmit e shtëpisë.

⁵² Zenel Ademi, i lindur 1933, Nikushtak;

Në mëngjes nusja ua shpërndan të afërmive të familjes së burrit dhuratat e saj që i sjell nga familja e vet, ua merr dorë gjithashtu, ndërsa të pranishmit, kryesisht burrat, në shenjë respekti i japin nuses para. Vazhdohet me valle të cilën e udhëheq ai i cili ishte në radhë për t'u martuar, dhe pastaj vallen e udhëheq dhëndri, e pas tij vazhdon edhe nusja.

Për ceremoninë e petullave na rrëfen Hanumshaje Asani e lindur 1932 në fshatin Orizare e martuar në fshatin Lipkovë: "Vajzat e sillnin për ta thyer kulaçin dhe së pari e prekte nusja e djali. Të tjerët e kapnin për ta thyer duke u munduar që në njërën anë ta gjejnë vajzat parën e në tjetrën edhe djemtë përpiqeshin ta gjenin. Ky ishte një tentim për shkak se nëse e gjen paranë në kulaç djali, atëherë për të parën herë nusja do të lind djalë, e nëse e gjen vajza atëherë do të lind vajzë. Ai që e gjen merr shpërblim nga dhëndri. Largohen mysafirët dhe familja më e largët. Nusja përgatitet për të pritur ata që do të vijnë për ta parë çejzin e që e ka pru nga baba. Ajo ishte dita e hënë kur tërë ditën kishte vizitues edhe nga fshati edhe nga familja, për ta parë marifetin e nuses. Pastaj, dërgoheshin petulla edhe te familja e nuses. Në mbrëmje përgatitej darka ku nusja për të parën herë shërbente me larjen e duarve. Nusja ulej në sofrën e përbashkët të familjes dhe ajo zakonisht, ulej në mes të dy djemve si shenjë që për trashëgimi të ketë së pari djalë".⁵³

Në ditën e dytë te familja e burrit, nusja zgjohej herët para agimit dhe fillonte të pastrojë oborrin e burrit dhe të të afërmeve të vjehrrit. Në ditën e tretë në familjen e tij ftohej për drekë dhëndri te familja e nuses. Pasi drekonte bashkë me familjen, dhëndri me disa të afërm të familjes së ngushtë dilnin në dhomën tjetër për t'u njoftuar me nënën e nuses ose gjyshen.

⁵³ Hanumshaje Avdiu, e lindur më 1932, Orizare;

Rexhep Jashari, i lindur më 1946 në fshatin Allashec, rrëfen se në përshëndetjen e parë, dhëndri i përkulej gjyshes duke ia marrë dorën, dhe i jepte të holla. Si shenjë loje për ngushtim të dhëndrit, shpeshherë përdorëshin lojëra të ndryshme ndaj dhëndrit, duke i vendosur llokum në këpucë dhe gjëra të tjera. Në fund duke u ngritur sofa, dhëndri ishte i detyruar të dhuronte të holla për bakllavën e përgatitur nga gjyshja.⁵⁴

Pas disa ditëve ftohen për drekë ose darkë edhe familja e nuses, të quajtur babgjyshtë. Me ardhjen e prindërve të nuses zakonisht më së shumti shërbente ndaj tyre dhëndri dhe ishte kënaqësi edhe e nuses që i shërbente burri të afërmit e saj. Në fund gjatë përshëndetjes së nuses me anëtarët e familjes, çdonjëri i dhuronte të holla asaj. Pas kalimit të një periudhe tri javore të nuses te burri, vinte familja e nuses për ta marrë vajzën *s'pari* (për herë të parë). Ajo qëndronte në familje një javë, dhe te familja e babait dërgonte ushqime nga më të ndryshmet, e sidomos bakllavë. Po ashtu familja e burrit vinin për ta marrë nusen. Për familjen e dhëndrit përgatitej drekë. Nusja vishej si në ditën e parë me duvak dhe përsëri ajo dërgonte ushqime të ndryshme e sidomos specialitetin e bakllavës, e cila e shpërndante në çdo shtëpi të të afërmeve të dhëndrit. Pas dy muajve nusja prapë kthehej për së dyti te familja, ku qëndronte dy javë. Pas kësaj nusja për në familje shkonte dy herë në vit, nga dy javë në stinën e pranverës dhe vjeshtës,.. Të gjitha këto tradita të dasmave shqiptare në trevën e Karadakut dhe më gjerë, si tradita popullore etnike në shumë vise shqiptare, me disa ndryshime krahinore, fatkeqësisht sot pak ruhen në traditën shqiptare, dhe kanë filluar të zbehen dukshëm. Por, ne si popull nuk duhet t'i humbasim e t'i zhbëjmë këto vlera të paçmueshme. Traditën tonë të pasur duhet ta ruajmë si sytë e ballit, duke mos e harruar asnjëherë. Ky është

⁵⁴ Rexhep Jashari, i lindur më 1946, Allaheec;

thesari ynë. Kjo është tradita jonë, kjo është pasuria jonë e madhe e kulturës shpirtërore.

Informatorë:

1. Azbije Iseni, e lindur më 1915 në fsh. Hotël
2. Selver Aziri, i lindur më 1920, në fsh. Hotël
3. Adem Ademi, i lindur më 1926, në fsh. Hotël
4. Ramize Aliti (fsh. Runicë 1927-2014 fsh. Sllupçan)
5. Bexhet Destani, i lindur më 1929 në fsh. Izvor
6. Zenel Ademi, i lindur më 1933 në fshatin Nikushtak
7. Hanumshaje Avdiu, e lindur më 1932 në fsh. Orizare

Literatura e shfrytëzuar:

1. Ademi, Minir, *Hotla nëpër kohë*, Kumanovë, 2017
4. Beqiri, Nazmi, *Këngët e kaçakëve në Malësinë e Karadakut*, Kumanovë, 2006
- Murtezani, Izaim, *Rite dhe praktika magjike të ciklit jetësor*, ITSHKSH, Shkup, 2017
5. Geertz, Clifford, *Ritual and Social Change: A Javanese Example*
6. Gerc, K., *Tumaçenje kultura I-II*, Biblioteka XX vek i Čigoja štampa, Beograd, 1998
7. Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Këngë dasme I*, Prishtinë, 1980
8. Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Këngë të ndryshme popullore*, Prishtinë,
9. Zeqiri, Mumin, *Besime popullore shqiptare rite e mitologji në rajonin e Kumanovës*, ITSHKSH, Shkup, 20163.

ISMET BEXHETI*Universiteti AAB - Prishtinë*

KËNGËT DHE VALLET NË DASMAT E RAJONIT TË KARADAKUT

Hyrje

Secili popull i ka të veçantat e veta kulturore të cilat i përcjell nga gjenerata në gjeneratë duke i dhënë edhe karakteristikat e çdo gjenerate veç e veç dhe që në kontekstin historik dhe kulturor e krijojnë edhe identitetin e vet. Identiteti nacional është një kompozicion i krijuar nga elementet dalluese dhe të përbashkëta të një përkatësie etnike, duke u nisur nga individi, familja, rrethi e rajoni. Ky kompozicion nuk është i kornizuar vetëm në komponentin etnike duke u zhvilluar në një rreth të izoluar. Ashtu si ndodh gërshtimi kulturor ndërmjet krahinash të një populli, ashtu ndodh edhe ndikimi i kulturave në mes të popujve të ndryshëm, e me theks të veçantë në mes të popujve që bashkëjetojnë në fqinjësi. Bartjet kulturore ndër breza dhe ndikimet e ndërsjella bëhen traditë popullore e cila përcaktohet nga faktorë të ndryshëm historik, shoqëror, religjioz, ekonomik, gjeografik etj. Pjesë e këtij mozaiku kulturor e multi-kulturor është edhe Rajoni i Karadakut. Kjo trevë, në aspektin gjeografik i takon Ballkanit perëndimor i cili shquhet me kolorit etnik, kulturor dhe fetar.

Hapësira gjeografike e përfshirë në këtë studim nuk nënkupton vetëm malësinë e Karadakut. Ajo përfshin edhe vendbanimet që shtrihen rrëzë malësisë, fshatrat fushore të cilat përbëjnë një rreth unazor nga pjesa e fshatrave të Shkupit, të Kumanovës, të Preshevës dhe të Bujanocit, duke vazhduar në jugperëndim të fshatrave të Dardanës së sotme, të cilat lidhen me fshatrat në jug të Gjilanit

dhe fshatrat e Vitisë dhe kështu duke vazhduar në vendbanimet në lindje të Kaçanikut deri në Han të Elezit. Qarku unazor i mbyllur me lidhje të pashkëputura mes njëra-tjetrës, lidhjet familjare në mes të pjesës malore dhe fushore si dhe shpërnguljet nga malësia në vendet e rrafshëta, domosdoshmërisht imponon që në një punim të natyrës së tillë këto vendbanime të trajtohen si një tërësi. Pra, Rajoni i Karadakut edhe pse nuk është një tërësi administrative dhe ka pësuar ndryshime të kohëpaskohshme të kufijve shtetërorë, edhe sot është e ndarë në tre shtete, megjithatë është një hapësirë kulturore e multikulturore e cila me dallimet që e bëjnë koloritin dhe me elementet e përbashkëta përbën një terren të pasur për hulumtime etnomuzikologjike dhe etnokoreologjike.

Këngët dhe vallet edhe pse janë objekt i disiplinave të ndryshme të muzikologjisë, ato megjithatë në raste të caktuara e shoqërojnë njëra-tjetrën dhe janë pjesë e pandashme e dasmës, në këtë rast edhe e dasmave të rajonit të Karadakut.

Kënga si term në këtë punim nënkupton këngët popullore tradicionale që këndohen në dasma. Këto janë këngët lirike të dasmave të përcjella nëpër breza dhe autori i këtyre këngëve është anonim. Përkritazi me vallet, në fokus të këtij punimi janë vallet tradicionale të burrave që përcillen me daulle e surla, dhe me instrumente të fabrikuar në dasmat e rajonit të Karadakut.

I. Kënga në dasmat e rajonit të Karadakut

Këngët e dasmës janë ndër më të shumtat në opusin e krijimtarisë së këngës sonë popullore. Ato janë përcjellës të dokeve e ritualeve të ndryshme popullore që bëhen në dasmat shqiptare, të cilat marrin karakterin e manifestimit më të madh familjar. Përmes këtyre këngëve shihet niveli i zhvillimit shoqëror e kulturor si dhe marrëdhëniet e caktuara ndërnjerëzore në mënyrë reale. Kjo, “sepse në këto këngë të dasmës, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt, qoftë

edhe tërthorazi, reflektohen aspekte të shumta të jetës materiale dhe shpirtërore të popullit, të dhëna madje herë-herë edhe me nota të theksuara realiste".⁵⁵

Këngët tradicionale të dasmave i kanë mbijetuar kohës deri në ditët e sotme. Për vjetërsinë e tyre, përmbajtjen tekstuale, strukturën melopoetike dhe elementet e tjera muzikore mund të bazohemi në burime të ndryshme siç janë botimet e ndryshme nga mbledhësit e folklorit, muzikologëve e etnomuzikologëve të ndryshëm si dhe nga këngët e ruajtura edhe në ditët e sotme.

1.1. Burime nga mbledhësit e folklorit

Në gjysmën e dytë të shekullit njëzet shfaqet një interesim i madh rreth mbledhjes së këngëve popullore, dhe botimit të teksteve të tyre, duke përfshirë edhe këngët lirike të dasmave. Edhe në vendbanimet e Rajonit të Karadakut e me theks të veçantë të fshatrave që e rrethojnë Karadakun, janë mbledhur një mori këngësh të dasmave. Kjo, përveç tjerash, përbën një rëndësi të madhe dhe shpreh prezencën e madhe të kësaj kategorie të këngëve popullore në këto treva. Shënimet e mbledhura nga ky rajon janë të përfshira në përmbledhjet e botuara nga Instituti Albanologjik, nëpër revista dhe botime të tjera nga autorë të ndryshëm.

Këngët që janë mbledhur kryesisht nëpër vendbanimet rrëzë Karadakut, por edhe në fshatrat e thella malore, pasqyrojnë përmbajtjen e pasur të këngëve që janë pjesë e riteve dhe zakoneve të këtyre anëve dhe që lidhen me fazat e ceremonialit të martesës, nga parafejesa, fejesa, dërgimi i petkave, nata e kulaçit, këngët e shumta të kanagjeqit, të krushqve, të arritjes së nuses në shtëpinë e burrit e deri në përfundimin e plotë të dasmës.

⁵⁵Instituti Albanologjik i Prishtinës, Këngë dasme, Prishtinë, 1980, f. 5.

Kënet kanë karakter të gjallë melodik dhe ritmik, janë të hareshme dhe në to mbizotëron gëzimi *Ojlulija jonë, lulëhasreti*⁵⁶, *Kumano-va edhe Shkupi ni kodër ndërmjet*⁵⁷, *Shka kanë lulet qi kanë çelë*⁵⁸, *Janë nis kerret mlue me t'kuq*⁵⁹, por nuk mungon edhe elementi humoristik e ironizues *Po vjen msiti xhades'vjetër*⁶⁰, *Hini msiti n kapixhi*⁶¹, *Don me hi msiti n'dallap*⁶².

Nga këto këngë të botuara mund të shihet se në përgjithësi mbizotëron vargu tetërrokësh. Kënga *Nisim kerret pa le hana*⁶³ ka vargun tetërrokësh simetrik i cili krijohet nga dy gjysmëvargje VIII(4+4). Evidente janë edhe vargjet dhjetërrokëshe, njëmbëdhjetërrokëshe dhe dymbëgjetërrokëshe simetrike dhe asimetrike X(5+5), X(6+4), XI(6+5). Nga këngët e mbledhura shihet që këngët e dasmës në rajonin e Karadakut janë të shkurtëra, por ka këngë të gjata edhe mbi njëqind vargje, siç është kënga *Ngjitja Hanës t bardht e ftyrës*⁶⁴.

Ky rajon e ka të folmen e dialektit gegë, dhe si rrjedhojë edhe të kënduarit është me po të njëjtin dialekt. Për këtë arsye në tekstet e këngëve ku është vënë shenja e pikësimit(‘) që zëvendëson shkronjën ë nuk e kam numëruar si rrokje e veçantë në kuadër të vargut.

Bazuar në këngët e evidentuara nga mbledhësit e folklorit, këto materiale të mbledhura ofrojnë një pasuri të madhe të vlerave folklorike shqiptare. Duke u njohur me këto këngë dhe me përmbajtjet e tyre poetike, mund të kemi një pasqyrë në kontekstin

⁵⁶ Instituti Albanologjik i Prishtinës, Këngë dasme, Prishtinë, 1980, f. 104.

⁵⁷ Po aty, f. 358

⁵⁸ Po aty, f. 363

⁵⁹ Po aty, f. 372

⁶⁰ Po aty, f. 81

⁶¹ Po aty, f. 69

⁶² Po aty, f. 86

⁶³ Po aty, f. 371

⁶⁴ Po aty, f. 308

social, historik e kulturor, gjithashtu edhe të jetës shpirtërore dhe materiale të këtij rajoni.

I.2. Këngët e notizuara nga terreni

Kënga përfaqëson strukturën e pandarë të vargut dhe të melodisë, andaj nuk duhet kufizuar vetëm në përmbajtjen tekstuale. Me regjistrimin, notizimin, transkriptimin si dhe analizën e këngës, ajo merr një pasqyrë edhe më të detajuar. Përveç kontekstit social, ekonomik dhe kulturor që reflekton përmbajtja poetike e këngës, me trajtimin muzikorne njihemi edhe më thellë me strukturën melodike dhe ritmike të saj.

Në këtë drejtim ai që e mbush këtë zbraztirë të madhe është Lorenc Antoni i cili ka botuar përmbledhjet me titull *Folklori muzikor shqiptar*. Në këto përmbledhje këngësh të notizuara të pasuara me një analizë modeste, kemi këngë nga të gjitha trojet e shqiptarëve të ish-Jugosllavisë, e ku një pjesë me dhjetëra e dhjetëra këngë i takojnë kategorisë së këngëve të dasmës në rajonin e Karadakut. Nga këto këngët të dasmës, përveç vargut të pastër me eksklamacione, ne mësojmë për strukturën melodike karakteristike me kadencime, radhën tonale, ambitusinsi dhe llojllojshmërinë e ritmit, që tregon edhe për veçoritë e këngëve të këtyre anëve. Këngët *Kpute dranafilin e lshoje n bunar, Hajde mori vajz' me fistan t'sarit, Qit moj nuse ni tas ujë, Oj lulije gjilpana gjergjefit, Po vjen baba i lules me duçi me pem', Kur ma daven vaden, Ka çel dranafile te bunari-o*⁶⁵, janë tregues të larushmërisë së strukturës metrike të vargut. Te këto këngë shfaqet edhe vargu gjashtërrrokësh, vargu tetërrrokësh, vargu dhjetërrrokësh si dhe vargu asimetrik dymbëdhjetërrrokësh XII (7+5). Kemi edhe këngë të njëjta që janë

⁶⁵ Lorenc Antoni, Folklori muzikor shqiptar, bleni V. Rilindja, Prishtinë, 1972

regjistruar në disa pjesë të rajonit të Karadikut, por me pak ndryshime si kënga *Ka hyp Gazmenaga përmë çeshëm-o*⁶⁶.

Nga këngët e notizuara shihet se ambitusi nuk është edhe shumë i gjërë dhe kryesisht arrin deri te kuinta e seksta, megjithatë kemi këngë me kapërcime intervalore deri në kuintë. Edhe ritmi muzikor është shumë i larmishëm duke u nisur nga masat e thjeshta e deri te masat e përziera 2/4, 7/8, 9/8, ritme këto që janë prezente edhe në rajonet e tjera shqiptare.

1.3. Kënga lirike tradicionale e dasmave në ditët e sotme

Edhe kur rrethanat shoqërore e historike kanë ndryshuar rrënjësisht, duke përfshirë edhe zhvillimet teknologjike, megjithatë në këto treva edhe sot e kësaj dite është ruajtur si vlerë kënga tradicionale ndër dasmat e këtij rajoni. Këngët tradicionale, edhe pse i kanë mbijetuar kohës, funksioni i tyre social e kulturor si pjesë e rriteve dhe zakoneve është zbehur në ditët e sotme dhe mund të themi se këngët tashmë kanë vetëm funksionin argëtues. Në ditët e sotme më së shumti këndohen këngët tradicionale që i kushtohen nuses dhe dhëndrit, duke theksuar tiparet e bukurisë, zotësisë si dhe dashurisë në mes të njëri-tjetrit etj.

Në tekstin por edhe në melodinë e këngëve të dasmave të Karadikut vërehen ndryshime të vogla edhe ndër vendbanime por edhe ndër gjenerata. Kjo është e natyrshme meqë kënga vetëm përmes këndimit është bartur në rrethe e vendbanime të ndryshme dhe me gjendje sociale jo të njëjtësi dhe në rrethana të reja, të cilat objektivisht krijojnë edhe variantet e këngëve siç është rasti me këngën " *Mu kanë t' bana flutur, / me hip në lis, / Ta shoh Qëndrimin/ çfarë*

⁶⁶ Po aty, f. 93

dasme ka nis'/'⁶⁷, këngë e cila me disa ndryshime në përmbajtje është regjistruar edhe në botimet e cekura më lartë.

Te këto këngë, bazuar në sistemet e sotme cilësore të vargëzimit, vërejmë më së shumti vargun e këmbëve trokaike në shumë kënge tradicionale të rajonit të Karadakut:

Kallne / kallne / çitnja / timin/

-V-V-V-V⁶⁸

Vargu i pastër, i kësaj kënge por edhe i shumë këngëve, si *Na luli-jen vet e kena pa*⁶⁹, është tetërrokësh simetrik XIII(4+4). Por ashtu sikur edhe te këngët e mbledhura gjatë viteve 50-60 të shekullit XX edhe te këngët e sotme tradicionale është prezent vargu dhjetërrokësh e dymbëdhjetërrokësh.

Në tekstet e këngëve lirike të dasmave përkundër këngëve lirike të dashurisë, janë përdorur më pak fjalët e huaja, në veçanti turqizmat që ka qenë shumë prezente në këngën popullore shqiptare. Në këto këngë përveç vargut të pastër hasim edhe vargjet e zgjeruara me interpolacione *O, Oj, Ani, Of, aman, Of aman, Tjarnana*. Raste të tilla kemi *Ani kaj lulije lot si gruni-o/ Shka i bane nanës që t për-zuni-o*⁷⁰, si dhe elementet që përsëriten apo krijojnë gjysmërefrenin apo refrenin: *Elena gidi, /Magbulja spo di// Op tja-ra-na-naj-na, tja-na, / Op tja- ra-na-naj –na /*⁷¹.

Elementet lirike silabike janë të theksuara të këngët e dasmave: *Na ka ardh një dorë/ Na ka ardh ni dorë / Naka ardh kollaj / Si me k'put me dorë*⁷².

⁶⁷ Informator Xhevrije Zeqiri, Kumanovë

⁶⁸ Grup vajzash, Kumanovë

⁶⁹ Vajzat e Shkupit (<https://www.youtube.com/watch?v=dJFmgLTwkI0>)

⁷⁰ Vajzat e Shkupit (<https://www.youtube.com/watch?v=VtL0Wfc44FU>)

⁷¹ Gjylshahe Zimeri, Llojan, Kumanovë

⁷² Valdete Bexheti, Kumanovë

Kurse elementet melizmatike vijnë në pah te vargjet me eksklamacione, të cilat bëhen në të shumtën e rasteve për arsye muzikore, si te rasti i këngës e cila është ndër të rrallat që është ndërtuar strofe+refren: *Hajdeni çika na ta kallim ooo/ Ani çfardo nuse na nuk marrim oooo*⁷³. Pra, këngët lirike të dasmave edhe pse kryesisht janë këngë njëstrofëshe megjithatë ndër raste të ralla ka këngë edhe me refren, si kënga e sipërpërmendur apo këngët që janë kënduar nga grupi i vajzave të Shkupit, si: *Na lulijen e kem pa te daja, E mori Lulijenana t' ka urue*, etj.

Këngët janë kryesisht diatonike dhe shumë rrallë ka këngëtë modeve kromatike. Edhe kapërcimet intervalore janë të ndryshme deri te kuinta siç është rasti te kënga *Kumanovës i dul flaka, /Kush e kalli, Raif aga*⁷⁴.

Këngët lirike të dasmës në rajonin e Karadakut kanë një ritmikë të larmishme dhe shumë të pasur. Te këto këngë më së shumti është e pranishme masa ritmike 2/4 *Na lulijen vet e kena pae, Naka hy në valle nusja e frajerit, Flutur flutur për hava, Fluturoj ni flutur flutur*,⁷⁵. Ritmi 7/8 paraqitet në dy variante, me strukturën 2+2+3 si te këngët *Elena giti dhe Hajt lulije mere horen*, ndërsa me strukturën 3+2+2 janë shumë këngë si: *Kshyrni kshyrni kush po hin me lu-e, Oj lulije holl e holl mindilin*⁷⁶ etj. Edhe këngët me masën ritmike të përzier 9/8, me strukturë 2+2+2+3 janë shumë të përhapura: *Hajde na ta kallim na ta kallim, S'ka ma mirë s ka ma sevda, Motra jena lujna knojna*⁷⁷, *O na lulijen e kem pa te ja*⁷⁸ etj.

⁷³ Grup vajzash, Rramanli, Kumanovë

⁷⁴ Grup vajzash, Kumanovë

⁷⁵ Vajzat e Shkupit (<https://www.youtube.com/watch?v=2K1YEKdlv7>)

⁷⁶ <https://www.youtube.com/watch?v=xMJsLXfYe6Q>

⁷⁷ Grup vajzash, Rramanli, Kumanovë

⁷⁸ <https://www.youtube.com/watch?v=vxtcGpvIXJo>

Të gjitha këngët e dasmave janë këngë monodike, të interpretuara qoftë solo apo edhe në grup, ku i gjithë grupi këndon këngën në të njëjtën vije melodike. Ka momente të veçanta gjatë fazave të ndryshme të ceremonialit të dasmës kur edhe vallja ka qenë pjesë e këngës. Kjo ceremoni e vallëzimit me këngë është bërë në netët kur janë mbledhur familja e ngushtë dhe kanë vallëzuar kryesisht duke marrë vallen nusët e reja të familjes. Këto valle janë luajtur vetëm nga grate: *Hajt Magbule mere horen/ Vjen Valdetja ta merr doren / Ta merr doren t ban sajgi/ Edhe t'ul ne sandali*⁷⁹. Këngët e dasmave të vajzave janë ekzekutuar në shoqërim me def.

II. Vallet në dasmat e rajonit të Karadakut

Me gjithë rrethanat historike e shoqërore që nuk kanë qenë në favor të ruajtjes së vlerës së përbashkët të këtyre vendbanimeve të rajonit të Karadakut, vallja e burrave ka qenë dhe vazhdon të mbetet një nga elementet ndërlidhëse të këtyrë trevave për folklorin muzikor. Kjo, se vallet popullore të burrave kanë zënë vend të rëndësishëm në jetën e përgjithshme të folklorit, duke qenë të pranishme edhe sot nëpër dasma. Këto janë një suitë vallesh që luhen të pashkëputura, duke krijuar kontrastin, llojllojshmërinë e tematikës, të strukturës dhe të performimit. Këto elemente e bëjnë nganjëherë të duket si një vepër artistike muzikore skenike e rrumbullakuar. Këtu qëndron edhe veçoria e valleve në këto treva.

Ka numër të madh vallesh që ndër vendbanime të ndryshme mund të pësojnë ndryshim të renditjes apo edhe të kenë emërtime të ndryshme, por ky numër i madh i valleve dhe kjo traditë e vallëzimit vazhdon t'i ruaj veçoritë e veta si valle të Karadakut në raport me rajonet tjera.

⁷⁹ Gjylshahe Zimeri, Llojan, Kumanovë

II.1. Shoqërimi instrumental dhe vokal i valles

Shoqërimi instrumental te vallet tradicionale të burrave ka rëndësi të posaçme. Ritmi dhe melodia që e krijon muzika në harmoni me lëvizjen e valltarit i jep kuptim të plotë vallëzimit. Shoqërimi instrumental i valleve të burrave është bërëme daulle dhe surla. Grupi instrumental është quajtur *Daullxhi*, *Tupanxhi* apo *Surlaxhi* dhe formacioni më i zakonit ka qenë me një daulle dhe dy surla. Nëpër fshatrat fushore dhe qytetet që e rrethojnë Karadakun, me futjen e instrumenteve, si klarineta, harmonika etj, u krijuan grupe muzikore të cilat quheshin *çallgija* dhe instrumentistët ishin të komunitetit rom. Përbërja e zakonshme orkestrale ishte nga instrumentet e klarinetës, harmonikës, gjymbyshit (instrument me tela) dhe darabukës. Nga vitet e tetëdhjeta të shekullit të kaluar morën hov të madh formimi i grupeve muzikore me instrumentistë dhe këngëtarë shqiptarë. Grupet instrumentale fillimisht përbëheshin nga klarineta, harmonika, kitara dhe defi, e në disa grupe edhe violina.

II.2. Emërtimi, gjinia dhe strukturat metro-ritmike të valleve

Vallet e rajonit të Karadakut emërtohen sipas vendit, si *Preshevka*, *Tërnocka*, *Miratocka*, *Gjlanka*, *Kumanovka*, *Hogoshka*, *Shkupjanka* (*Memetka e Shkupit*) etj. Kemi edhe valle që janë emërtuar sipas emrave të njerëzve si vallja *Deli Agushit*, *Memetka*, *Dimka*, *Ibrahim Hoxha* etj. Pastaj janë edhe vallet me emërtime sllave e turke si vallja *Çacak*, *Tefte*, *Çyçek* e *Pembe-pembe* dhe emërtime të tjera. Vallet janë kryesisht epiko-lirike. Edhe pse renditja e valleve ka ndryshime jo edhe aq të theksuara ndër pjesë të ndryshme, megjithatë te vallet e para mbizotëron epika me hap të ngadalshëm dhe të rëndë, e vallet e fundit janë me hapa të shpejtë e lirik. Vallet

e Karadakut mund t'i kategorizojmë edhe si një suitë e valleve të burrave e cila ka dy pjesë të valleve të një tërësie, ku pjesa e parë përfshin kategorinë e valleve të rënda, kurse pjesa e dytë kategorinë e valleve më të lehta. Pjesa e parë e cila përfshin numrin më të madh të valleve me renditje të pandryshuar nis me vallen *Tefte*. Kjo valle në të shumtën e rasteve është si një uverturë e suitës së valleve, ku grupi muzikor ekzekuton melodinë me ritëm 7/8 me një melodi të butë në shkallën maxhore (makami rast). Gjatë ekzekutimit të kësaj valleje valltarët vetëm e bëjnë rrethin duke ecur në të djathtë si parapërgatitje për vallen e radhës. Por në disa vende kjo valle edhe vallëzohet si forme e "nxemjes" për vallet tjera.

Vallja e radhës *Pembe-pembe*⁸⁰ nis në momentin kur valltari i parë jep shenjën e lidhjes me valltarët e tjerë. Pra valltari i parë njëkohësisht është edhe udhëheqësi i valles por edhe "dirigjues" i orkestrës, duke diktuar fillimin, emocionin përmes lëvizjeve trupore, dinamikën, shpejtësinë e valles dhe përfundimin e saj. Vallja *Pembe-Pembe* është në masën 4/4, ku në pjesën e parë tempoja është e ngadaltë, kurse pjesa e dytë është e shpejtë. Kjo dukuri e ndërrimit të tempos ndodh te të gjitha vallet. Ndërrimi i tempos pason edhe me ndërrim të vijës melodike, e shpesh edhe me ndërrimin e tonalitetit dhe me improvizim. Kjo valle e cila ekzekutohet kryesisht në B-dur, me ndërrimin e shpejtësisë bëhet edhe modulimi në mënyrë jo të zakonshme duke zbritur vetëm për një sekondë të vogël në tonalitetin A.

Përveç harmonizimit të elementeve strukturore të valles, rol të madh luan edhe shoqërimi instrumental i cili krijon koloritin melodik dhe ritmik. Vallja e *Preshevkës* e ka metriken në 4/4 dhe ekzekutohet zakonisht në C-mol⁸¹, ndërsa vallja e *Miratocek* luhet në

⁸⁰ <https://www.youtube.com/watch?v=QB1VWnrcWUc>

⁸¹ <https://www.youtube.com/watch?v=UeQGNk1a3hQ>

ritmin 4/4 në Es-dur⁸². Vallja e *Dimkës* shoqërohej edhe me këndim në gjuhën sllave dhe ekzekutohej në shkallën e molit në ritmin 4/4⁸³. *Gilanka* është me ritëm 4/4 në tonalitetin bazë C, në shkallë kromatike orientale ku tetrakordi i parë është në mekamin *Hiçaz*⁸⁴. Kjo është edhe e vetmja valle melodia e së cilës interpretohet në këtë radhë tonale.

Vallja e Gajdes e cila nis me një pjesë rubato duke vazhduar me ritëm 7/8, kryesisht ekzekutohet në g-mol.

“*Vallja e Marhames* nënkupton momentin e garës së kuajve ose të vrapuesve në rrugëtimin e krushqive për ta marrë nusen. Sipas të anketuarve, kjo valle përpara është quajtur *Toska*”⁸⁵. Ekzekutohet në shkallën muzikore Dur themelor në bazën tonale B-dur apo Es-dur. *Vallja e Memetkes* luhet në ritmin 7/8 me strukturën e masave 2+2+3 dhe ekzekutohet në B-dur.

Në rajonin e Karadakut, varësisht prej vendbanimeve ku ato luhen, kanë edhe emërtime të ndryshme, edhe pse struktura e vallëzimit është e njëjtë. Një valle të tillë e kemi vallen e *Deli Agushit*. Vallja e *Deli Agushit* në Shkup, Kumanovë, Preshevë dhe Bujanoc ka emërtim të njëjtë në ritmin e përzier 12/8 në a-mol (me fakturë 7/8+5/8). E njëjta valle përcillet me një vijë tjetër melodike dhe në disa vende njihet me vallen e quajtur *Ibrahim Hoxha*. Po e njëjta mënyrë e vallëzimit por me nuanca të vogla dhe me vijë melodike krejtësisht tjetër e kësaj valle merr emrin Tërnocka. Në Anamoravë vallëzimi identik i valles së lartpërmendur shoqërohet edhe me këndim, dhe është quajtur në bazë të këngës: *Jam e ligë o morejam tuj deکہ/ Lidhma kryt me borsilek/ Borsilekut an more poivjen era /*

⁸² <https://www.youtube.com/watch?v=IpQi0AZ4r9A>

⁸³ <https://www.youtube.com/watch?v=Lv0RYYdgnxo>

⁸⁴ <https://www.youtube.com/watch?v=prgJEF56GCo>

⁸⁵ Qendra rajonale për trashëgimi kulturore - Gjilan, Vallet e Karadakut, Gjilan, 2018, f. 25

*Dil pak jasht djal' se erdh pranvera*⁸⁶. Me krejtësisht strukturë tjetër të valles, në Gjilan luhet vallja të cilën gjilanasit e quajnë vallja e *Deli Agushit*. Kjo valle vallëzohet pa ritëm, vetëm duke u ndjekur valltari i parë prej instrumentistëve. Po e njëjta valle në Kumanovë e Preshevë njihet si *Preshevka e vjetër*.

Pjesa e dytë e valleve është me valle kryesisht 2/4 dhe 4/4, që përfshijnë vallet më të gjalla e të shpejta, dhe një pjesë e tyre janë edhe valle që luhen nga sllavët, vllehët edhe turqit. *Hogoshka* dhe *Shota*, që të dyja me ritëm 2/4 janë të përafërta dhe vallëtarët vallëzojnë përballë njëri tjetrit. E tillë është edhe vallja “Tarazejbek” që është luajtur në Preshevë. “Vallja Tarazejbek është valle e lehtë, qytetare, e cila luhet nga çift burrash edhe atë karshi-karshi, ballë për ballë”⁸⁷. Nga vallet vllehe e sllave luhej vallja *Çaçak*, pastaj vallet turke *Çyçek* dhe *Pajtushka*.

Renditja e valleve ndryshon ndër vendbanime por edhe nga valltarët. Në Kumanovë vallja e parë ka qenë Tefte, vallja e dytë Pembe-pembe pastaj pasonte vallja Memetka, Ibrahim Hoxhës (Obllakja), Dimka Preshevka, Miratocka, Moravka, Gajdja, Shota (Hogoshka), Çaçakja edhe Çyçeku turk. Ndodhte që në fund të përseritej një valle e cila ishte e preferuara e valltarit apo e mysafirëve. Në dy dekadat e fundit të shekullit XX shtohet edhe vallja e Rugovës⁸⁸. “Në gazmendet e Tërnocit luajtja e valleve fillonte me këtë radhitje: Tërnocka, Pembe-pembe, Vallja e Mehmet agës, Vallja e Deli Agushit, Gilanka, Preshevka, Morava, Dimke Dimke, Shota, Gajdja dhe Çaçaku”⁸⁹.

⁸⁶ SHTKKP, Çështja e valles shqiptare në Preshevë dhe rrethinë (tribunë shkencore), Xhemaledin Salihu, *Valle popullore të vjetra në Preshevë*, Preshevë, 2011, f.29-46

⁸⁷ Po aty

⁸⁸ Informator Qamil Bexheti, Kumanovë

⁸⁹ SHTKKP, Çështja e valles shqiptare në Preshevë dhe rrethinë (tribunë shkencore), Xhahit Ramadani, *Vallja e Deli Agushit*, Preshevë, 2011, f. 90-102

Vallet e burrave në rajonin e Karadakut janë luajtur në gjysmërreth, ashtu si edhe vallet e grave.

Derisa këngët e kanë ruajtur elementin popullor etnik, disa valle të Karadakut janë një vlerë multietnike e Ballkanit. E veçanta e këtyre valleve është se ky repertor i valleve është ruajtur dhe kultivuar deri në ditët e sotme vetëm te popullata shqiptare e rajonit të Karadakut, por jo me intensitetin e deri para dy dekadave. Edhe pse instrumentistet kanë futur pjesë muzikore të marra nga popuj e vende të tjera, arkitektonika e valles, motivi, formacioni, trajta e vallëzimit është tipike e rajonit të Karadakut.

Një pjesë e valleve janë luajtur edhe nga popujt fqinj dhe ky cikël i krijuar i valleve me gërshetim kulturash e vlerash, i përngjan suitave evropiane, që mund të hedhim një paralele me polifoninë evropiane dhe polifoninë popullore shqiptare. Mu për këtë është me interes për të nxitur hulumtime të mëtejshme jo vetëm për të ndriçuar origjinën e ndonjëres nga vallet, por në tërësi si një pasuri e ruajtur dhe e kultivuar në rajonin e Karadakut.

Përfundim

Kjo temë kishte për qëllim që t'i jepet një pasqyrë e prezencës së këngëve dhe valleve në dasmat në rajonin e Karadakut. Përmes mbledhësve të folklorit pamë reflektimin e këngës në aspektin social e kulturor. Nga burimet etnomuzikologjike në mënyrë edhe më të afërt u bë e mundur që të njihemi edhe me strukturën melopoetike, shkallën, ritmin etj. Nga burimet e sotme patëm mundësinë për të parë vazhdimësinë dhe ruajtjen e këngëve të një pjese të këngëve tradicionale. Gjatë këtij punimi është vërejtur se në këngët e dasmave të rajonit të Karadakut mbizotëron vargu tetërrokësh dhe këndimi diatonik. Nga evidentimi i këngëve tradicionale në ditët e sotme vërehet vazhdimësia e këngëve me pak

ndryshime dhe se kënga në dasmat e sotme kryesisht e ka funksionin argëtues.

Duke u bazuar në shënimet e autorëve të tjerë rreth valleve të burrave të rajonit të Karadakut, si dhe kërkimeve të mija, edhe pse me pak dallime rreth emërtimeve dhe radhitjes së valleve të burrave, shihet një pasuri unike e repertorit të njëjtë të valleve të burrave në rajonin e Karadakut. Këto valle kanë karakteristikat e veta si në arkitektoniken e valles poashtu edhe në shoqërimin instrumental, muzikën e saj e cila është një suitë e valleve e përbërë nga pjesë të valleve të veçanta të cilat performohen si një tërësi.

Bazuar në këto, mund të themi se rajoni i Karadakut është terren i pasur për hulumtime etnomuzikologjike e etnokoreologjike dhe se shihet nevoja e një politike të mirëfilltë institucionale për të ruajtur këto vlera, por edhe për të marrë hapa më konkrete në iniciativën e ofrimit të dokumentacionit argumentues në UNESCO për vallet e burrave të rajonit të Karadakut, jo vetëm si vlerë nacionale por si vlerë multikulturore e njerëzimit.

Bibliografia:

1. Antoni, Lorenc, *Folklori muzikor shqiptar bleni V*. Rilindja, Prishtinë, 1972;
2. Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Këngë dasme*, Prishtinë, 1980;
3. Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Këngë dasme*, Prishtinë, 1984;
4. Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjilan, *Vallet e Karadakut*, Gjilan, 2018;
5. SHTKKP, *Dasma shqiptare në preshevë dhe rrethinë dikur dhe sot*, (tribunë shkencore), Ramadani Xhahit - Vallja e Deli Agushit, Preshevë, 2011;
6. SHTKKP, *Çështja e valles shqiptare në Preshevë dhe rrethinë* (tribunë shkencore), Salihu Xhemaledin - Valle popullore të vjetra në Preshevë, Preshevë, 2011.

Informatorë:

Grup vajzash, Kumanovë, 5 maj 2019;
Grup vajzash, Rramanli, Kumanovë, 17 korrik 2019;
Gjylshahe Zimeri, 56 vjeçare, Llojan, Kumanovë, 15 maj 2019;
Magbule Aliu, 52 vjeçare, Nasalë, Gjilan, 15 maj 2019;
Qamil Bexheti, 60 vjeçar, Kumanovë, 5 maj 2019;
Valdete Bexheti, 50 vjeçare, Kumanovë, 20 qershor 2019;
Xhevrije Zeqiri, 57 vjeçare, Kumanovë, 15 maj 2019.

Burime tjera – video nga kanali Youtube:

<https://www.youtube.com/watch?v=dJFmgLTwkI0>
<https://www.youtube.com/watch?v=VtL0WFc44FU>
<https://www.youtube.com/watch?v=2K1YEKdlv7E>
<https://www.youtube.com/watch?v=xMJsLXfYe6Q>
<https://www.youtube.com/watch?v=vxtcGpvIXJo>
<https://www.youtube.com/watch?v=QB1VWnrcWUc>
<https://www.youtube.com/watch?v=UeQGNk1a3hQ>
<https://www.youtube.com/watch?v=IpQi0AZ4r9A>
<https://www.youtube.com/watch?v=Lv0RYYdgnno>
<https://www.youtube.com/watch?v=prgJEF56GCo>

NEVRIJE BISLIMI-ISMAILI*Universiteti "Kadri Zeka"- Gjilan***DASMA NË SHTËPINË E VAJZËS**

(Dasma dhe krijimet folklorike në shtëpinë e vajzës - nuse në rrethin e Gjilanit)⁹⁰

Dasma është një nga momentet më të rëndësishme në jetën e njeriut. Pavarësisht nga ndryshimet e rrjedhave dhe zhvillimeve shoqërore dasma edhe sot, në familjet shqiptare përbën një ngjarje të veçantë familjare. Në tërësinë e saj dasma është një ceremoni, në të cilën gërshetohen praktika të caktuara rituali, në një ndërlidhje të dukurive etnografike me krijimet e ndryshme folklorike, që iu përshtaten fazave dhe momenteve në të cilat kalon e gjithë ceremonia e dasmës. Është kjo arsyeja që trajtimi i këngëve të dasmës nuk mund të shkëputet nga vetë shqyrtimi i ritualeve brenda ceremonisë së dasmës.

Përgjithësisht, këngët e dasmës edhe në rrethinën e Gjilanit janë realizuar gjatë momenteve rituale më së shumti në shtëpinë e dhëndrit. Ndonëse në traditën tonë jo fort të largët, më së pakti ka zënë vend dasma në shtëpinë e vajzës – nuse, pasi konsiderohej ndarje apo largim i bijës së shtëpisë në një mjedis të ri dhe nuk dihehin kushtet në të cilat ajo do të gjendej apo se si do të përshtatej aty ku do të shkonte. Andaj shqetësimet e kësaj natyre e shndërronin dasmën në shtëpinë e nuses në një atmosferë

⁹⁰ Punimi që po e realizojmë është rezultatet i punës kërkimore në teren, pasi mungojnë regjistrime apo materiale të kësaj natyre. Mirënjohje për të gjithë bartësit që më kanë dhënë informata në Anamoravë. Falënderoj të gjithë ata që më ndihmuan me informacione. Midis tyre përmendim: Shukrije Shabani (1944) Mogillë-Viti, Lutfije Isufi (1950) Velekincë, Hanmije Sylja (1964) Pozheran, Zyhrije Haliti (1967) Kabash, Afërdita Hajrullahu (1977) Smirë.

përgjithësisht të dhimbshme, pa lënë shumë vend për një atmosferë të hareshme dhe të gëzueshme. Edhe regjistrimi i këngëve që shoqërojnë ceremonialin e dasmës në rrethin e Gjilanit, ashtu si edhe trajtesat e ndryshme, paraqiten me përmasa të ndryshme, duke qenë mbizotëruese këngët dhe trajtesat rreth tyre në shtëpinë e djalit. Nisur nga një situatë e tillë, përzgjedhëm për të realizuar shqyrtimin e dasmës në shtëpinë e vajzës – nuse, me dëshirën e mirë që të hedhim dritë rreth këtij momenti të rëndësishëm.

Deri tani kemi regjistruar një numër të konsiderueshëm nga këngët e praktikuara në momente të caktuara ceremoniali. Pikërisht mbi këtë bazë do të realizojmë këtë trajtesë shkencore. Besojmë se është me interes shqyrtimi në një rrafsh krahasues, se si realizohej dasma në shtëpinë e vajzës gjatë dasmës tradicionale dhe dasmës në ditët e sotme, përkatësisht dasmës tradicionale dhe dasmës bashkëkohore.

E para, me pikësynimin dhe dëshirën që të njihen më mirë dhe më të plota traditat e lidhura me dasmën në shtëpinë e vajzës, që ato të mos humbasin krejtësisht. Nga ana tjetër, është me shumë rëndësi edhe dokumentimi sa më i plotë i mënyrës së organizimit dhe zhvillimit të dasmës në rrethinën e Gjilanit.

E dyta, për të parë se çfarë është ruajtur nga tradita dhe cilat janë disa nga dukuritë e reja, të përfutuara gjatë kohëve të fundit. Në këtë mënyrë, pikësynimi ynë do të jetë që të mund të dalin në pah pikërisht elementet më të rëndësishme të dasmës tradicionale dhe asaj moderne në rrethinën e Gjilanit.

Me pak fjalë, mund të themi se do të shihet se cilët elemente të dasmës tradicionale kanë mbetur ende në dasmën e quajtur moderne, duke shënuar rite, këngë, valle, veshje etj., për t'u shprehur konkretisht nëse ato janë ose jo ende aktive në rrethin e Gjilanit.

Gjatë trajtesës sonë lidhur me këngët e dasmës në shtëpinë e vajzës do të shtrojmë probleme të tilla, si:

- fejesa, dhënia dhe marrja e lajmit të fejesës,
- urimet gjatë shkëmbimit të unazave,
- përgatitja e dhuratave dhe shkëmbimi i tyre,
- caktimi i ditës së dasmës,
- fillimi i dasmës në shtëpinë e vajzës,
- dërgimi i teshave ose petkave të nusja (ceremonia dhe ritet e pritjes së miqve të rinj)
- vënia e kënasë nuses; kush ia ngjiste, si quhej ajo që e zbukuronte nusen dhe çfarë këngësh këndoheshin për nusen natën e kanagjegjit.
- si i këndojnë nuses motrat, shoqet në këtë natë (nata e kënasë) dhe çfarë i kujtojnë asaj nëpërmjet këngëve,
- cilat këngë këndohen ditën e fundit të vajzës në shtëpinë e saj, përkatësish në dasmën e saj.
- cilat këngë këndohen ditën e dasmës në shtëpinë e nuses,
- koha e stoliset nuses, kush e stolis dhe si i këndohet asaj,
- cilat këngë të reja këndohen sot në dasmën e vajzës etj.

Fejesa

Rituali i dasmës zë fill me aktin e fejesës. Fejesa e dikurshme lidhej me disa norma dhe zakone të ndryshme, praktikimi i të cilave ishte i detyrueshëm. Mos funksionimi i tyre në tërësi mund të përfundonte me prishje, por edhe më keq, me prishjen midis dy familjeve, të djalit me të vajzës. Fejesa në kohë të mëhershme bëhej me ndërmjetësimin e shkuesit apo të mesitit. Zakonisht shkues ishte një i afërm i shtëpisë së vajzës ose të djalit, apo dhe ndonjë person tjetër, të cilit i shkonte për dore shkuesia (siç quhet në rrethin e Gjilanit, ***msitnia***). Përndryshe, kishte dhe njerëz të caktuar që e kishin si një lloj profesioni shkuesinë.

Shkuesi zakonisht dërgohej nga familja e djalit për t'ia kërkuar vajzën atij personi që e porosiste i zoti i shtëpisë (babai i djalit). Më përpara vajzën që do të kërkohet për nuse duhej ta kishte motra e djalit, nëna apo halla e tij. Ka qenë në traditë që vajzën mos ta jepnin që herën e parë, kur vinte msiti për ta kërkuar. Arsyet e refuzimit ishin ndër më të ndryshmet. Midis tyre, mund të përmenden: vajza është e re ose në shkollë, se duhej të pyesnin për familjen e djalit, për djalin etj. Mirëpo, detyra e msitit nuk përfundonte vetëm me një të shkuar te familja e vajzës. Atij i duhej të shkonte disa herë, derisa familja e vajzës të interesohet dhe të pyeste për familjen dhe djalin. Pra, msiti shkonte te shtëpia e vajzës disa herë, deri sa të merrte përgjigjen përfundimtare, për të zyrtarizuar kështu lidhjen e miqësisë midis dy familjeve.

Familja e vajzës ishte e detyruar që t'ia kthente përgjigjen msitit. Përgjigja që duhet të merrte ai, shpeshherë e kishte një kohë të caktuar, si pas një ose dy javësh, ose një muaji, në vartësi të kërkesave të familjes së vajzës. Pasi merrte përgjigjen, msiti shkonte te familja e djalit dhe u sillte familjarëve të djalit përgjigjen që e prisnin, nëse ishte pozitive.

Fejesa në rrethinën e Gjilanit, përkatësisht në Anamoravë, kalon përmes tri momenteve të rëndësishme, siç janë:

- Momenti i dhënies së fjalës nga ana e familjes së vajzës dhe sjellja e lajmit të pranimit për fejesë nga ana e msitit, që e sjell zyrtarisht te familja e dhëndrit (në Anamoravë quhet **ikrar**),
- **Fjala e nuses** apo **dora e nuses**, siç quhet në Anamoravë, është zyrtarizimi i fejesës ndërmjet dy të rinjve.
- Momenti kur prindërit e djalit dërgojnë **punë dore** (gjësende) për të përgatitur vajza pajën apo **çejzin**.

Dhënia e dorës së vajzës zakonisht jepej nga babai i vajzës. Në rast se mungon kryefamiljari, atëherë këtë akt e kryen vëllai i madh. Në rastet kur vëllai është i vogël për nga mosha, këtë të drejtë e kishte xhaxhai i vajzës. Ky rit kryhej në prani të disa të afërmeve të vajzës, zakonisht njerëz shumë të afërt të familjes së vajzës. Në traditë ishte e domosdoshme dhe ftesa për dajën e vajzës.

Zakoni i **dhënies së dorës** bëhej duke u çuar mesiti në këmbë, jep dorën, duke u drejtuar, përafërsisht me këto fjalë: "A ta ka kërkuar NN çikën për djalë?" Nga ana e babait të vajzës, duke iu drejtuar msitit, thuhej: "Po e ka kërkuar dhe për hair i qoftë". Përgjigjej msiti: "Për hair ju qoftë të dy palëve!". Më tej, nga të pranishmit jepeshin urime për babanë e vajzës, duke thënë në këtë mënyrë: "Për hair të qoftë, ishalla i punon shëndeti dhe nafaka".

Ndërkohë, në shtëpinë e vajzës shkonin gjatë gjithë ditës vizitorë nga familjarë për t'i uruar fejesën e vajzës, me urata ndër më të ndryshmet, si: "I punoftë nafaka", "Ishalla me shnet e me të mira", "Hairqoftë" etj. Vajza gjatë asaj dite rrinte e mbyllur në dhomë, e mërzhitur, duke qarë. Ajo ishte gjatë gjithë kohës e shoqëruar nga ndonjë shoqe ose kushërirë e saj. Msiti, pasi merrte fjalën nga babai i vajzës, shkonte te shtëpia e dhëndrit, për të sjellë lajmin e mirëpranimit nga shtëpia e vajzës. Ky paralajmërim, që quhet **ikrar**, do të thotë se msiti çon **ikrarin**, parafjalën se kanë vendosur familja e vajzës për ta dhënë.

Kulmi i fejesës së vajzës kishte të bënte sidomos me shkuarjen e dorës në familjen e dhëndrit. Kjo ceremoni i kishte disa specifika të saja për nga ana e nuses. Ajo duhej të përgatiste **bohçen** (dhuratën) për dhëndrin, që të ishte simbol fejesë, të cilën e sillte në shtëpinë e dhëndrit. Dhurata kryesore ishte unaza e floririt. E gjithë dhurata duhej të ishte e mbështjellë nga një bohçe e qëndisur nga nusja dhe e stolisur me zbukurime estetike.

Në familjen e vajzës ditën që bëheshin gati për të shkuar te dhëndri për të çuar dorën, zotëron një festë si e heshtur. Zakonisht shkonte vëllai i vajzës, daja, xhaxhallarët dhe msiti. Ata visheshin me rrobat më solemne, për të paraqitur seriozitetin dhe nderin e familjes. Momenti që nisen për të shkuar te shtëpia e dhëndrit, shoqërohet me urime, si: "Ishalla, për hair e me nafak". Me vete marrin edhe peshqeshin apo dhuratën (bohçen) që nusja kishte përgatitur për t'ia dërguar dhëndrit. Në këtë rast bohçja e dhëndrit është simbolika kryesore e fejesës, e cila më pas analizohet nga familja e dhëndrit se si është punuar dhe rregulluar, më tepër për nga ana estetike. Zakonisht, përgatitet një bohçe edhe për msitin nga ana e vajzës, por i jepet në kohën kur ajo martohet, gjatë ceremonisë së dasmës.

Detyra e msitit nuk përfundon me dorën e vajzës. Ai është i "detyruar" që ta vazhdojë interesimin e tij në përfundimin e martesës së dy të rinjve. Ndërkohë, deri në përfundimin e martesës, ai vazhdon të luajë rolin e ndërmjetësuesit, duke u interesuar gjatë periudhës që vajza është ende ndër unazë, kohë që përgatit pajën apo çejzin.

Pas zyrtarizimit të fejesës, familja e dhëndrit përmes msitit i dërgojnë fjalë mikut të ri se dëshirojnë të shkojnë në vizitë te nusja, për t'i sjellë asaj **punë dore** dhe gjësende të ndryshme, për të përgatitur çejzin. Zakonisht, i dërgojnë edhe të holla për nevoja që do të ketë nusja. Periudha kohore që nga ana e dhëndrit shkojnë te nusja është vetëm 2 - 3 javore, sepse ata duhen të pasi familja e nuses duhet të plotësohet me të gjitha sendet e nevojshme, që të jenë gati përgatitjet për gjithçka që tradita e kërkonte.

Përpara se t'i sjellin gjësendet te nusja, miku i ri apo dhëndëri dërgon fjalë përmes msitit se çfarë duhet t' sjellin nuses. Familjarët e nuses bëjnë kërkesat e tyre dhe familja e dhëndrit është e detyruar që t'i plotësojë të gjitha kërkesat.

Edhe pritja e miqve të rinj nga ana e familjes së nuses ka ceremoninë e vet. Njerëzit e nuses përgatisnin një drekë të begatë në ushqime, duke filluar nga gatimet tradicionale dhe deri tek ëmbël-sirat më të mira. Gjatë pritjes së miqve të rinj nga familja e nuses ftohen edhe të afërmit e nuses, siç janë: dajallarët, xhaxhallarët dhe kushërinjtë e afërm të familjes. Në këtë rast, për prurjen e punëdores të nusja vinë: vjehri me ndonjë djalë (jo dhëndëri), axha dhe daja. Pas ngrënies së drekës vjen edhe koha për të treguar miku i ri se çfarë ka sjellë te nusja. Në këtë rast miku fillon t'i shpalosë me radhë të gjitha gjërat që kanë sjellë. Duhet thënë se, ndër të tjera, kanë sjellë dhe flori.

Familja e vajzës (burrimi), pasi i sheh gjërat e sjella nga ana e mikut, e jep pëlqimin nëse janë të kënaqur ose kanë ndonjë kërkesë tjetër. Zakonisht në këto raste, kur është puna te floriri, babai i nuses vendos se çka dhe sa duhet të sjellë ar, për ta marrë vajzën e tij.

Pas një farë kohe, mikeshat e reja shkojnë për ta përhajruar lidhjen e re me familjen e nuses. Në këtë rast vjehrra, së bashku me vajzat, bijat (hallat e dhëndrit), kunatat dhe motrat (tezet) shkojnë te nusja. Zakonisht te nusja granimi nuk shkojnë për drekë, por vetëm për çaj, që shoqërohet me gjëra të ndryshme ushqimore, deri në ëmbël-sira dhe fruta. Gjatë kësaj vizite të vjehrrës me gratë e tjera, të afërme të dhëndrit, priten nga disa gra të afërme të nuses, si: halla, motra, teza dhe gratë e xhaxhallarëve. Nusja nuk e takon vjehrrën, nuk duhet t'i dalë asaj përpara, deri në ditën e dasmës. Vjehrra në këto raste gjithëherë shkon e përgatitur me një dhuratë për nusen, që është në të holla, flori ose ndonjë material i veçantë për fustan, që i dërgohet asaj në rast se nusja i del përpara për ta njoftuar vjehrrën.

KOSOVARE KRASNIQI*Instituti Albanologjik - Prishtinë***RITET DHE CEREMONITË E DASMËS
NË RAJONIN E ANAMORAVËS*****Hyrje***

Dasma në gjirin e popullit shqiptar njihet si më e madhja festë familjare që kremton populli ynë. Një ndër dëshirat më kryesore tek prindërit është martesë e fëmijëve të tyre, sepse më parë sipas karakterit religjioz, përveç, bashkimit të dy të rinjve, shtimin e familjes, qëllimi tjetër i tyre ishte të fusnin krah pune në shtëpi. Është fakt se për ritet dhe ceremonitë e dasmës interesohen, etnografet dhe folkloristët. Etnologu Bashkim Lajqi, në studimin e tij, martesën e përkufizon si *“një institucion tradicional, të cilin shkenca e definon si lidhje seksuale, ekonomike dhe shoqërore të dy personave, të gjinive të ndryshme, ndërsa shoqëria e vërteton përmes zakoneve, ligjeve dhe religjionit”*. (Lajqi 2007: 179).

Populli shqiptar martesën e konsideron si të shenjtë. Edhe pse famijet sakrifikojnë shumë për ditët e dasmës sepse ekonomia e shtëpisë zbrazet, ajo që e karakterizon të gjithë këtë është shprehja: *“Një herë martohet njeriu”*. Etnologët e shquar për dasmën konkludojnë se dasmat në trevat shqiptare, zhvillohen duke u bazuar në krahinat ku ndodh dasma. Andaj, etnologu Ukë Xhemaj shpalos mendimet e tij, duke thënë se *“Dasma shqiptare, sikundër çdo traditë tjetër e jetës dokesore (zakonore) ngërthen elemente të krahinore, krahas atyre përbëjnë thelbin bërthamor të kulturës kombëtare”*. (Xhemaj 2005: 165).

Kërkimi dhe qëllimi im hulumtues i folklorit shqiptar në rajonin e Anamoravës qëndron në atë se është rajon kultura e të cilit ka rënë

në harresë, përkundër faktit se zotëron një kulturë me vlerë, me zakone dhe tradita të lashta. Pra, para nesh qëndron edhe një pjesë në juglindje të Kosovës, Anamorava, e cila ka thesar të kulturës ende të pa gërmuar sa duhet. Pra, në këtë aspekt, jemi një rajon i kërcënuar nga harresa.

Mirëpo edhe e tashmja kërkon më shumë vëmendje për historinë e traditave të së kaluarës. Dhe këtu lind vetvetiu pyetja: Çfarë dimë ne për martesën e gjysheve tona, nënave tona, dhe motrave tona? Çfarë dimë ne, për kulturën dhe traditat tona? Reflektimi i përgjigjes tonë, si brez më i ri, do të ishte: Shumë pak, Asgjë apo gati pothuajse asgjë!

Dhe, para se të na hedhë në krahët e tij harku i harresës, fillojmë të shpalosim ritualet dhe ceremonitë e dasmës anamoravese dhe këngët e dasmës që janë një nga pjesët kryesore të dasmës. Këngëtari popullor në çdo ritualë ka skalitur virtytet më të larta për dhëndrin dhe nusen anamoravese. Dasma ka një forcë ngazëllimi dhe kremtimi në familjet tona, andaj në këtë studim do të analizohen më hollësisht ceremonitë nga dita e parë kur fillon dasma e deri te përfundimi i saj. Për ta pasur një pasqyrë më të qartë të kësaj dukurie, vëmendje të posaçme do u kushtohet ceremonive e veprimeve magjike ndër ritet e dasmës në Anamoravë. Populli shqiptar i anës së Moravës u përket dy religjioneve të ndryshme: fesë myslimane dhe fesë katolike. Në kumtesën tonë, ne do të ndalemi më shumë në zakonet dhe ceremonitë e dasmës myslimane, besim ky, i cili e përbën shumicën e popullsisë anamoravese.

Ritet dhe ceremonitë e dasmës tradicionale në Anamoravë

Shekullin në të cilin e jetojmë, te jeta e secilit njeri martesë bëhet atëherë kur dy personat e gjinisë së kundërt, përshkohen nga dy gjendje emocionale, ajo shpirtërore dhe ajo fizike, dhe kur paraqitet kjo ndjenjë, ajo transformohet në martesë. Mirëpo në

gjysmën e parë të shekullit të kaluar, pra, vitet e 50-ta, në Kosovë martesat nuk e kishte ecurinë e njëjtë me martesat e kohërave të tashme. Ritet e dasmës për të cilat do flas sot janë të një dasme të vjetër, të para 60 vitesh. Zonja në fjalë, për martesën e saj më thotë atë çfarë ka mundur ta ruaj në kujtesën e saj.

Dasma në rajonin e Anamoraves zgjaste disa ditë. Dasmat kanë filluar që nga dita e mërkurë e deri në ditën e hënë, dite e cila quhet Dita e Grave. Ceremonitë e shumta që zhvillohen në rajonin e Anamoraves dallohen nga ato ceremoni që zhvillohen në shtëpinë e dhëndrit dhe nga ato që zhvillohen në shtëpinë e nuses. Gjatë këtyre ditëve janë kënduar këngë e janë luajtur lojëra nga më të ndryshmet. Subjekti i këngëve të cilat janë kënduar gjatë këtyre ditëve është varur nga momenti i cili është përjetuar në ato çaste. Marrim shembull një këngë e cila është kënduar një javë para dasmës:

*Oj lulije o moj top i basmes,
ani sot një javë është nata dasmës*

ose kënga tjetër:

*Hajde knojna kah flladi akshamit,
le ti shkon lulijes për rreth xhamit,
për rreth xhamit ku është tuj punu,
bohçen Argjend agës tuj maru.....*

Meqë flasim për dasmën të paktën gjashtë dekada para, dasma në të dy rastet sikur te djali ashtu edhe tek vajza organizohej ndaras burrat nga gratë. Edhe ritualet dhe ceremonitë e tyre në të shumtën e rasteve bëheshin ndaras.

Ritet dhe ceremonitë në shtëpinë e dhëndrit

Dasma tek dhëndëri fillon me ditën e mërkurë kur i dërgoheshin “teshat nuses”, dhe po këtë ditë, në shtëpinë e dhëndrit fillonin këngët e vallet e ndryshme. Këngët e vallet popullore që këndoheshin në dasmë shoqëroheshin me dajren (ose defat) e cila njihet si instrumenti më kryesor i dasmave. Këndonin me zë të lart që të dëgjoheshin sa më larg të kuptohej se kush ishte duke u martuar, pasi që në këtë kohë mjet tjetër të informimit nuk kishte. Këngëtarët e lëvdonin nusen e dhëndrin me këngët nga më të ndryshmet.

Çejzi i përgatitur nga nusja edhe teshat e përgatitura po ashtu nga nusja, bëheshin gati dhe ia dërgonin nuses tek shtëpia e babait të saj. Po në të njëjtën ditë në shtëpinë e dhëndrit është gatuar “Kulaçi”. Për ta gatuar kulaçin caktohej një nga vajzat e shtëpisë e cila duhej t’i kishte të dy prindërit gjallë. Deri sa të gatuhet kulaçi të mërkurën vajza është kënduar me këngë nga më të ndryshmet, herë duke e lëvdur e herë duke e ngacmuar atë. Njëra nga këngët ku ngacmohej vajza është: *kush e qet kulaçin, do e merr kovaçin*. Pastaj ai “kulaç”, mbështillej me një pecetë edhe ruhej deri të hënën në mëngjes kur në dhomën e nuses dhe dhëndrit mblidheshin mysafirët e mbetur. Nusja edhe dhëndëri duhej që atë kulaç ta ndanin së bashku përgjysmë, dhe nëse pjesa më e madhe e kulaçit ndahej nga nusja, atëherë besohej se nusja do ia merrte zemrën dhëndrit, dhe e kundërta. Etnologu Bashkim Lajqi, në studimin e tij, thotë se “*Kulaqi – ka të bëjë me pjellorinë në martesë*”. (Lajci 2007: 128).

Ritet dhe ceremonitë në shtëpinë e vajzës

Shtëpia e nuses ishte më e heshtur, mirëpo edhe aty kishte ceremoni. **Dita e enjte** quhet ndryshe edhe **dita e bojës**. Në këtë ditë disa vajza shoqet e nuses janë zgjuar herët edhe janë mbledhë me një dhomë, kanë rregulluar nusen duke e veshur edhe duke ia vënë një lirë në

gojë, me qëllim që vajza të tregohej “e mirë si lira” pastaj në ora njëmbëdhjetë e mëngjesit i kanë mbledhur edhe gratë e tjera.

Me këtë rast, vajzat kanë përgatitur “kanë” që ndryshe quhej edhe “bojë” edhe ia kanë venë në kokë vajzës që martohej. Po këtu ia kanë vënë edhe shaminë dhe vajza ka filluar të qaj edhe “të i marrë ngrykë” të gjitha shoqet e gratë e pranishme. Vajza në këtë ditë qan me zë, duke e theksuar shkronjën “Uuuu” qan me dënes, duke krijuar edhe një lloj melodie. Sipas traditës “boja” duhej të vihej para orës dymbëdhjetë të ditës. Shoqet e saj edhe qajnë edhe e këndojnë njëkohësisht.

Vajza e cila kujdesej për vajzën – nuse ndryshe thirrej edhe **telake**. Detyra e kësaj ishte që ta ndihmojë nusen që të përgatitet për veshje e për të gjitha ritualet që kishin të bënin me nusen. Nga ana tjetër, telakja duhej ta mësonte nusen, se si të sillet në shtëpinë e burrit kur të hyj si nuse e gjëra nga më të ndryshmet. Në fund pasi vajza nisej për nuse, telakja është paguar. Edhe telakja nga këngët nuk kursehej, edhe ajo është kënduar me kënge ngacmuese.

Në këtë ditë vajza i ka zhveshur teshat e vajzërisë dhe ka veshur nga ato që i kanë sjellë të burri. Rrobat e vajzërisë i kanë vendosur në hambarë.

Të premten, vajza pasi është zgjuar herët, është larë, është rregulluar, e ka vënë shaminë në kokë. Pastaj të gjitha rrobat që i kanë sjellë familja e burrit ajo i ka veshur. Arsyeja pse është zgjedhur pikërisht kjo ditë e veshjes ishte se besohej se, po ti veshte vajza në këtë ditë teshat do t’i rrinin më bukur, ose siç shprehet zonja tek mi tregon këto rituale thotë “që t’i kenë me hije”. Pasi që i ka përshëndet ashtu të gjithë njerëzit e shtëpisë, duke përfshirë këtu edhe vëllezërit, vajza është dashur të del edhe nëpër farefisnin aty afër dhe t’i përshëndes edhe ata duke qarë e duke i marrë ngryk.

Ky ritual vazhdonte tri dite me radhë, duhej që vajza të del e të përshëndetet me të afërmit e saj .

Vajzat që e shoqëronin nusen, së bashku me të ktheheshin në shtëpinë e vajzës prapë edhe me një dhomë të shtëpisë, i shtrinin “çejzin”. Me fjalën “çejz” kuptohet të gjitha gjërat që ia kanë dërguar nuses nga shtëpia e dhëndrit.

Dita e shtunë – e shtuna është **Nata e dasmës**. Në mëngjes vajza së bashku me disa shoqe dilte nëpër farefisën aty afër dhe duke qarë si kërkohej me zakon i përshëndeste të gjithë. Po ashtu shkonte edhe nëpër vende ku kishte qëndruar si vajzë me shoqet e saja. Zakoni e kërkonte që nga e ënjta e deri të shtunën, pra, tri ditë me radhë, çdo mëngjes të shkonte nëpër shtëpitë e kushërinjve duke qarë të përshëndetej me ta. Gjithashtu pasdite vazhdonin ceremonitë tjera. Ceremonitë zhvilloheshin në oborrin e shtëpisë së vajzës. Në shtëpinë e vajzës pasdite mblidhej gjinia femërore nga i gjithë fshati, gra, nuse e vajza. Vajza – nuse, sipas zakonis ishte e detyruar që çdo kush që vije të del para edhe ta përshëndes duke qarë ashtu si e donte zakoni. Aty ishin nusët e veshura me veshje tradicionale. Vajzat këndonin këngë për nusët që ishin prezent ndërsa nusët vallëzonin. Vajza e cila të nesërmen bëhej nuse, pasi i përshëndeste gratë që vinin për nder të saj, rrinë ulur, dhe e heshtur shikon nën shami. E bën të pikëlluar fakti se pas martesës ajo më nuk do ti ketë disa privilegje vajzërore. Koha më e ndjeshme për vajzën gjatë kësaj dite ishte, mbrëmja e asaj nate. Në mbrëmje pas darkës, përsëri mblidhen gratë. Kësaj radhe i vihet “këna” vajzës. Gjatë këtij rituali vajza këndohet nga shoqet e saj. Atmosfera e kësaj ceremonie është pak a shumë më e dramatike. Vajza këndohet me këngë të cilat e prekin atë emocionalisht. Ajo qan dhe njëkohësisht duhet t’u bindet kërkesave të këngëve të vajzave. Për fillim vajzat e këndonin me këngë më të lehta :

Ngjitet kana pika - pika t’ka pas nana bajrak nder qika

Ngjitet kana me pika t'kuqe t'ka nana bajrak nder nuse

Ndërsa gjate kohës kur i vihet këna në ora para dymbëdhjetë të natës, shoqet e saj e këndonin:

Kaj lulije ndimi te bardha , kush i del bijave përpara

Po ia le motrës amanet, le tu del sikur jam ane vet

Pasi që vajza e vë kanën më nuk rri në të njëjtën dhomë ku janë gratë tjera, por hy me një dhomë tjetër. Aty është dashur të flejë me një djalë të vogël.

E diela në shtëpinë e nuses

Atmosfera e ditës së diel në familjen e dhëndrit ishte e gëzuar. Ndërsa në atë të vajzës ishin të dy ndjenjat. Nga njëra anë vajza ndiqej nga kujtimet për kohën e vajzërisë, nga ana tjetër atë e priste krijimi i familjes së saj të re, çfarë e dëshiron çdo vajzë.

Vajzën si nuse e përgatiste Telakja. Veshja e nuses ishte me dimi të kuqe dhe mitan ose ndryshe thuhej “e veshur me kumashe”. Mbi kokë kanë pasur të vendosur dy metra material, apo siç thotë zonja në fjalë, se duhej të ishin, “*dy metra basmë i mëndafshet*”.

Në shtëpinë e vajzës gratë të cilat duhej të pritnin renditeshin njëra pas tjetrës edhe i uronin mirëseardhje duke ua uruar e martesën e djalit. Shërbeheshin me lëng ose ujë, ndërsa me kalimin e viteve, filluan të shërbeheshin edhe me lëng ose ujë, llokume ose ndonjë ëmbëlsire tjetër, nga nuset e reja.

Nusja para se të dilte nga shtëpia e saj e vente një penj të kuq rreth krahëve, dhe në momentin që i shihte “gratë e kerrit” (gra të kerrit quheshin ato gra të cilat vinin ta merrnin për nuse), ajo duhej që me forcën e saj penjtin e kuq ta këpusë. Dhe nga ai moment ajo më nuk fliste, deri sa të hynte në dhomë me burrin e vet. Gjithashtu ajo

duhej ta vente një para në gojë edhe kur takonte diku ndonjë lum, ndaleshin e hidhte aty.

Kur nusja shkonte ti përshëndeste gratë e kerrit, gruaja më e vjetër apo Plaka e kerrit siç e quanin, i ka sjellë sheqer gur tri herë rreth kokës, me besimin se nga ai moment do ti shkoj jeta ëmbël nuses. Dhe, më pastaj i ka marrë me grusht dhe i ka hedhë aty nëpër gra.

Përshëndetja nga ana e vajzës me ata të shtëpisë ishte momenti më i vështirë për vajzën. Nusen e re, deri tek qerrja ku hipte ajo, e sillte në krahë babai i saj. Pastaj ajo para se të hipte në “kerrin e nuses” duhej të sillej tri herë rreth kerrit. Vendi i nuses në qerre ishte i caktuar, nuses i kanë vënë një jorgan prapa edhe aty është dashur të ulej. Në kerrin e nuses kanë qenë plaka e kerrit, djali i kerrit, një vajzë e kerrit edhe kënd e ka dashur e zonja e shtëpisë ta nderoj e ka vënë në kerrin e nuses.

Nga informatat që mora, Seksane e quanin Kalin i cili mbante dy sandaket me çejz të cilat i kanë vendosur në dy anët e kalit, e mbi të edhe qilimin e jahnin. **Jahni** – ishte si një lloj tepie që duhej të vendoset në dhoma. Kerri i kuq me nuse nisej pas. Kerri i nuses ndryshe quhej edhe si “Kerri i kuq”. Kerri ka qenë me kuaj ose në viset malore ishte edhe me kije (qe). Kerri ishte i mbuluar me qilim të kuq me motive folklorike, dhe arsyeja ishte që qerrja të zbu-kurohej me qilim kuq e zi me ngjyrat e flamurit tonë kombëtar.

Vajza llogaritej si nuse vetëm pasi hynte në kerrin e nuses dhe me këtë rast bëhej për hajr nga babai i nuses tek miku, ose siç thuhet nga ne, në Anamoravë, “Të bëhet teslim”. Babai i nuses ose vëllai i zgjatnin dorën mikut edhe si fjalë urimi për mikun ishte “Robi është i yti, gjaku është i imi”, për çfarë ka lënë të kuptohej se sipas zakoneve kanunore vajza është martuar edhe është llogaritur fuqi punëtore e asaj shtëpie, por po ti ndodhte diçka e padrejtë, familja

e saj do të kërkonin gjak për të. Pasi është bërë teslim, kanë gjuajt me armë.

Tani vajza nisej për tek shtëpia e burrit, por rrëfimi nuk mbaron këtu. Ajo do të rinisë një jetë prej gruaje, dhe jeta e saj do merr tjetër drejtim, atë të krijimit të familjes.

E diela në shtëpinë e dhëndrit

Krushqit kanë ecur në këmbë nga shtëpia e dhëndrit deri tek ajo e nuses. Flamurtari ose siç quhej ndryshe atëherë **Bajraku** i printe krushqive gjatë udhëtimit për te nusja. Gjatë kthimit gjenin një fushë të caktuar ku bënë lojëra të ndryshme, si vrapime në mes vete, vrapime me kuaj, etj. Kur vinte radha të zbriste nusja nga kerri, tash atë e merrte në krahë vjehrrin. Para se të zbriste nusja, vjehrrin kujdesej që sipas zakonit, t'ia lë nuses para një kulet, të cilën nusja duhej ta vendosë në këmbë aty mbi kuletë, me qëllimin që ajo pastaj më vonë ta zëvendësojë të zonjën e shtëpisë. Pas këtij rituali, kur nusja është zbritur nga kerri i kuq, njëri nga shtëpia e dhëndrit ka gjuajtur përsëri me armë.

Me qëndrim në këmbë dhe të drejtë nusja është dashur që të qëndroj njëherë në oborr pa u ulur një kohë të gjatë. Tani ishte radha që aty ku ka qëndruar nusja e paluar, kanë marrë një thes, dhe në thes e kanë vendosur një kandar e një tepsi. Nusja ka qëndruar mbi tepsi me kandarin brenda. Kur është dashur të ulej të pushoj pak, para se të ulej bëhen një ritual tjetër. U merrnin tre plisa të bardhë meshkujve edhe i vendosnin te karrigia e nuses. Ajo është dashur të ulej e të ngrihej tri herë, pastaj hiqeshin plisat edhe ulej nusja. Arsyeja e kësaj ishte të lindë fëmijë djem nusja. Nusja kur zbriste nga kerri i kuq, bënte temena, ishte kjo si një lloj përshëndetje për njerëzit aty dhe shtëpisë së saj të re. Kjo ishte mënyra e përshëndetjes së nuses pastaj me të gjithë ato gra të cilat ishin aty. Temenaja edhe marrja dorë besohet që ka mbetur nga sundimi i

gjatë turk. Kur vinte koha që nusja të hyjë në shtëpinë e saj të re, pra në shtëpinë e burrit, asaj i përgatitej sherbet me një pjatë. Ajo duhej që tri herë të lyej gishtat me sherbet edhe të prek derën e hyrjes si nga ana e parme ashtu edhe nga ana e prapme. Ky ritual duhej te behet edhe kur hynte në dhomën e saj.

Këngët të cilat këndoheshin në këto momente ishin me subjekt lëvdues për nusen por edhe për vjehrrin e vjehrrën e saj:

O lumja toka o që e shkel me kamë

O lumja vjehrra që e thirr oj nanë

Pastaj me këngë vazhdonin t'ia uronin edhe vjehrrit ardhjen e nuses:

Te dera oborrit një qeze me jaj,

agaj baba reja te koftë përhap

Reja të koftë për hajrë e me nafak

Ke marre një sy zezë e një qafë gjatë.

Ose, kur vajzat donin që familjen e dhëndrit ta lëvdonin për pasuri, atëherë vajzat këndonin këngën:

Sa ka mall e sa ka mall turkia knena , na lulijes a lulijes o do ti blejna

Sa ka mall e sa ka mall e turkie e shkup e, na lulijes, na lulijes ia vnojna ne trup e

Flamuri me shkabën e zezë dykrenore, ka qenë gjithnjë shenjë simboli e identifikimi kombëtar. Në këtë rast është shenjë simboli për familjen në zë për të mirë:

Kena vnu flamurin përmbi shpie

me tregu o se jena zoteni

zotri jena kanë edhe jena

Drugzan (përmend mehallen prej cilës është dhëndri) jena,

zanin lart e kena

Dita e hëne- Të hënën në mëngjes ndahej kulaçi. Kulaçi ishte i përgatitur që nga dita e mërkurë. Mblidheshin burra e gra e hynin në dhomën e dhëndrit e nuses. Nusja për t'i përshëndetur ata, si fillim ua merr dorën. Dhëndëri me nusen tani duhej që ta ndajnë kulaçin në mes tyre, dhe pastaj ua ndajnë nga një pjesë secili që ishte aty. Të hënën paradite nusja është njoftuar me oborrin. Është e veshur me veshje tradicionale, dymija të bardha edhe mitan. Si për fillim ajo duhet të dal tek bunari (pusi) dhe duke i bërë temena edhe e përcjellë me këngët e vajzave, ajo mbush ujë në pus. Në këtë rast pasi mbush ujë disa herë, për ta ngacmuar i hedhin barë në ujë. Nusja e re duhet ta derdhë atë ujë të mbush prapë, deri sa të mos i hedhin asgjë. Në këtë ritual, duhet që së pari të pijë ujë një djalë. Vajzat e kanë kënduar me këngë të ndryshme edhe duke e lëvdur atë edhe në mënyrë mjaft shpotitëse. Përmes këngëve, vajzat kërkojnë nga nusja që tu bëj temena bunarit, oborrit hamba-rit e plot gjërave tjera që gjendeshin në oborr dhe nusja është dashur të bëj temena, si një lloj përkulje dhe respekti. Vajzave defatore u kanë dhënë para, për mundin që bënë për të kënduar. Njëra nga këngët me subjekt ngacmues në këtë rast ishte:

*Nusja jonë o sytë po i palon,
Po e këqyr vellaun tonë nga vjen e nga shkon,
nga vjen e nga shkon nga xhamia,
kryet njërën ane nga lulija.*

Kishte edhe këngë tjera të cilat ishin me subjekte të ndryshme, si nga ata lavdërues edhe nga ata ngacmues. Këngët të cilat ishin me subjekt më ngacmues janë kënduar nga bijat me plaka.

*Nena nuses po maron leftyra
Po ia mbajna qiken me shtylla.*

Ose tjetra ishte:

*Për inat te nenës tende, qit mindilin në tokë,
Për hatër te vjehrrës merre shtine në shokë*

Dhe, meqë këto të dyja gratë janë të rëndësishme në jetën tënde, të dhënat e marra nga zonja ajo thotë se *“për ti respektuar të dyja edhe nënën edhe vjehrrën, unë mindilin nuk e lëshoja në tokë, por në shokë e vëja”*, kjo e dyta për hatër të vjehrrës.

Po ashtu përmes këngëve, vajzat kërkonin nga nusja që t’i njoftojë nëse di të gatuj. Nusja për këtë rast është dashur që ta qëndisë një pecetë me formë të rrumbullakët, të duket forma e një pete të pitës. Pastaj nusja, gratë me plaka me qëllim që t’i respektoje ato, ia dhuron nga një shami për ta vënë në kokë, shamijat të cilat ishin të përgatitura për to. Magjetoreve- gratë të cilat kanë përgatitë bukën është dashur tu dhuronin **kecele** (përparëse të qëndisura nga vet dora e nuses), vajzave defatore **bashllika** (një lloj shamie) për kokë ose nga një mindil të qëndisur.

Të hënën pasdite ishte **Dita e Grave**. Pas orës katër mbledheshin gra nga i gjithë fshati dhe të veshura bukur mbledheshin në shtëpinë ku ishte nusja. Nuset ishin të veshura me dimija e jelek tradicionale, dhe ishin të renditura ku kohën më të madhe rrinin në këmbë. Vajzat i këndojnë nuset e ato kërcejnë. Nusja më e re rri më larg nuseve tjera, edhe ajo në këmbë rri, pa u ulur. Pasi të kërcejnë të gjitha me rend, hallat, pastaj bijat më të reja e disa gra nga fshati u vije rendi nuseve. Në fund fare del edhe nusja e re, edhe ajo kërcen pak edhe me këtë ritual të fundit mbaron dasma. Po këtë ditë është zakon që çejzi që ka sjell nusja të renditet në dhomën e saj të nusërisë edhe të shikojnë vajzat e reja, e edhe ato të fejuarat, ku shpeshherë frymëzoheshin nga ndonjë model që kishte aty.

Organizimi i lojërave gjatë ditës së dasmës

Meqë flasim për dasmën e para gjashtëdhjetë vitesh në rajonin e Anamoravës, natyrisht se në këtë punim do ceken edhe lojërat që i zhvillonin meshkujt në gara me njeri-tjetrin. Por gjatë tërë kësaj kohe, nga koha kur nisen të marrin nusen me kuaj, përpara u prin

një djalë i ri i cili e mbanë flamurin. Flamuri ishte gjithnjë flamuri ynë kombëtar. Pasi merrnin nusen edhe atij duhej t'i dhurohej diçka nga nusja. P.sh. zakonisht ishin këmisha të pëlhurës ose Maramë, një lloj peshqiri i punuar nga nusja me vek. Po ashtu, gjatë ardhjes së nuses, krushqit ndaleshin me një vend të përshtatshëm dhe meshkujt bënin gara me kuajt e tyre më të mirë. Nëna ime më shpjegon për babanë e saj se, kur kishte dasma dhe që vendoste babai i saj të merrte pjesë në gara, ata kuaj disa ditë më parë u jepnin për të ngrënë më mirë, me qëllim që atë ditë të zë vendin e parë ose "të merr maramën" si i thoshin fitores. Dhuratën ose këmishën e pëlhurës me të cilën shpërblehet ai që fiton garën është dashur nusja ta ketë me vete. Veshja e burrave ishte me tirqit ngjyre kafe të mbaruara me vek me gajtanë, këmisha të pëlhurës, mirëpo kishte edhe nga ata që vishnin pantallona .

Përgatitja e pajës ose "çejzit" nga ana e nuses

Pajës së nusërisë populli shqiptarë i ka dhënë rëndësi mjaft të madhe. Pasi merrej dora e nuses, d.m.th. bëhej fejesa, familja e djalit duhej të përgatitej për dasmë, po ashtu edhe ajo e vajzës, por në masë më të pakët. Koha e fejesës tek anamoravesit njihej me shprehjen "është ndër unazë", si për djalin ashtu edhe për vajzën dhe vajza ishte ajo që gjatë kësaj kohe përgatiste vet "çejzin". I gjithë çejzi punohej me dorë pavarësisht se ndodhte të kalonin një vit e edhe dy deri sa ishin të gatshëm familja e djalit për martesë. Në pajën e nusërisë të vajzave anamoravesë, hynë përveç të qëndisurat e shumta të cilat në popull njihen me shprehjen "tentene" edhe qilimat, maramat, **jahni** (ishte si një lloj tepih që duhej të vendohet në dyshemenë e dhomës). Po ashtu kanë punuar këmisha të cilat njiheshin në popull me emrin "pëlhura" si për burrin ashtu edhe për vete e për njerëz të tjerë të shtëpisë, pastaj *pshallake*, *qarshafe*, *postava për jorgana*, *jastëk*, *dyshekë*, *dysHEME*. Të gjitha

këto janë të punuara nga leshi i deles i cili është përpunuar nga vet gratë e shtëpisë.

Tentenet përdoreshin si zbukurime si për tabakanë e kafes edhe për atë te çajit, përdoreshin edhe për zbukurimin e orendive të ndryshme shtëpiake. Çejzi duhej të shtrohej në ditën e shtunë me një dhomë në shtëpinë e vajzës, ndërsa në ditën e hënë shtrohej në dhomën e shtëpisë së burrit, ku pastaj vajzat e reja vinin ta shikonin punën e çejzit të nuses.

Përgatitja e ushqimit gjatë ditëve të dasmës

Gjatë ditëve të dasmës ushqimi ishte më me bollëk. Edhe për përgatitjen e ushqimit në kohërat e më hershme kishte rregulla. Qysh në ditën e enjte, nga i zoti dhe zonja e dasmës, janë caktuar organizatorët e dasmës edhe te gratë edhe tek burrat. Aty janë caktuar me emra se cili ose cila, varet se ku do shërbej, do përgatisë bukën, cili ose cila do e shërbej çajin, kush do i laj enët dhe kush do i ndihmoj asaj. Për të përgatitur bukën zakonisht zgjedhshin gratë më në moshë, ndërsa për shërbim të lëngjeve, ujit apo edhe çajit zgjidheshin nuset e reja.

Kur të caktonte dikush të përgatiteshe bukën, ndiheshe e privilegjuar- thotë zonja e moshuar. Edhe pse ishte një obligim dhe punë mjaft e madhe, arsyeya pse ajo ndihej e privilegjuar ishte se asaj ia besonin një punë të madhe, dhe zakonisht për punë si në këso raste, merreshin gratë të cilat e bënë punën e mirë edhe që ishin të zonjat. Kjo e tregon edhe zemërgjerësinë e njerëzve që kishin atëherë, nuk ishin egoistë. Edhe pse brezi i tashëm do e sheh me ironi këtë veprim për atë kohë, dhe do na duket kjo gjë shumë primitive, ajo kohë nuk ishte kohë e pandjeshme sikur tash, por kohë simbol i mbështetjes dhe solidarizimit me njëri tjetrin. Po të ndodhte të martohej vajza diku larg, krushqve që vinin ta marrin nusen u është dhënë bukë me vete.

Përfundim

Dasmat me ritualet dhe ceremonitë e tyre vazhdojnë me bashkërrjedhjen e kohës. Dhe nëse dikush mund të pyes se ç'risi kanë sjellë kohërat në dasmat tona? Përgjigjja do të ishte se, gjatë disa dekadave të fundit, pa u ndjerë fare, në si shoqëri përfshihemi nga moderniteti. Evolucioni i dasmave është një fakt të cilin nuk mund ta injorojmë, duam apo s'duam ne. Prandaj, me kalimin e kohës dhe me bërjen gjithnjë e më shumë të dukshme gjurmët e modernizmit, ndryshuan edhe ritet e ceremonitë e dasmës. Tani një dasmë e para gjashtë dhjetë vitesh me një dasmë të vitit 2019 ndryshon pothuajse krejtësisht. Edhe pse në vitet e më hershme ambienti ishte me i rendë dhe atmosfera me e ashpër, nuk do të thotë që një dasme e para gjashtë dhjetë vitesh ka vlerë më pak, sepse edhe dasmat e viteve të 50' në mënyrën e tyre gëzonin jetë të lumtur.

Literatura:

Krasniqi, Mark. (1979). *Gjurme e Gjurmime*. Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë;

Lajçi, Bashkim. (2007). *Gjurmime Etnologjike*. Muzeu Etnologjik. Pejë;

Vaqarri, Sabina. (2014). *Rite doke dhe zakone të martesës*. Tiranë;

Xhemaj, Ukë. (2005). *Shtresime Kulturore*. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.

Informatorë:

1. Nazlije Ymeri, 63 vjeçe, Sllatinë, amvise
2. Kumrije Ymeri, 70 vjeçe, Sllatinë, amvise
3. Mejreme Ymeri, 74 vjeçe, Terpezë, amvise
4. Tevide Ymeri, 45 vjeçe, Smirë, amvise
5. Hatixhe Ymeri, 40 vjeçe, Prishtinë, farmacistë
6. Metije Ymeri, Gjilan, amvise.

MUSTAFË HAZIRI

Lidhja e Historianëve të Kosovës "Ali Hadri"

–Dega në Mitrovicë

RITET E DASMËS TRADICIONALE NË DRENICË TË KOSOVËS

Dukë marrë parasysh së ceremonia e dasmës, si pjesë e pandashme e kulturës popullore shqiptare, në memorien tonë ka mbetur si një shprehje e kënaqësisë shpirtërore së popullit, si tregues i drejtpërdrejt i mbijetesës së kësaj kulture nëpër shekuj kanë ruajtur me xhelozi në rajonin e Drenicës.

Punimi bazohet duke çmuar karakterin ceremonial të dasmës në Drenicë, si pjesë natyrale dhe po aq specifike e kulturës shqiptare në përgjithësi dhe duke e shikuar si entitet shpirtëror rajonal gjithëpërfshirës dhe duke e konceptuar atë në ecurinë dhe rrjedhën e kohës dhe mënyrën e përshtatjes së saj.

Ky punim është një kontribut modest në fushën e kulturës popullore shqiptare, duke vlerësuar se dasma me të gjitha ritet që e shoqërojnë atë në hapësirën shqiptare shfaqet si një dukuri antropologjike identitare.

Duke u konsultuar me literaturë të shumëllojshme, lënde të mbledhura nga dorëshkrime, fotografi dhe veshje origjinale, kemi synimin për ta bërë të njohur më gjithanshëm trashëgiminë tonë kulturore, në veçanti dasmën dhe elementet përbërëse të saj. Vetë me ka rastisur të shoh dhe të përjetoj momente të ndryshme të dasmes drenicase si cikël jetësor.

Objekt i studimit të këtij punimi shkencor është:

-struktura organizative dhe përmbajtësore e ceremonialit të dasmës

-fejesa dhe fazat kalimtare nëpër të cilën ajo kalon
 -dasma në shtëpinë e vajzës dhe në shtëpinë e djalit dhe përcjellja me rite që e karakterizojnë ceremoninë në fjalë
 -roli i këngës dhe valles gjatë ceremonisë së dasmës.

Përveç metodës analitike kam bërë krahasime ndërmjet dasmës tradicionale dikur dhe sot në kohën kur po flasim. Jam i vetëdijshëm se ky punim nuk do t'i shterojë të gjitha çështjet e ngritura.

Vështrim historiografik

Në vetëdijen e çdo shoqërie njerëzore kultivimi dhe përqafimi i vlerave universale mendohej se ka qenë objekti parësor. Nisur nga këndvështrimi i tashëm, vlerat kombëtare duken shumë të rrezikuara, sepse e gjithë struktura e shoqërisë shqiptare është mbërthyer nga ethet e përfitimit, duke injoruar dhe spostuar në periferi vlerat e shëndosha.⁹¹

Drenica përfshin një territor kodrinor ndërmjet Fushës së Kosovës në lindje prej Goleshi e Çiçavicës, maleve të Caraleves në jug, malit Mokna në veri dhe Rrafshit të Dukagjinit në perëndim.⁹²

Karakteristikat më të shquara të shqiptarit shfaqen me dimensione më të jashtëzakonshme në Drenicë, prandaj ky vend është quajtur djepi i trimërisë shqiptare.⁹³ Emri Drenicë lidhet me antroponimin Dreni,⁹⁴

Kurse studiuesi i njohur i folkloristikës shqiptare, Dr.Mehmet Rukqi, mendon se emri Drenicë rrjedh prej drerit, ngase ishte trevë e pasur me drerë e kaproj, jetën e së cilëve e ndihmonte klima e

⁹¹ “Katundi Ynë”, revistë arbëreshe për kulturë dhe aktualitet, nr 143, 2003, fq.9.

⁹² Mark Krasniqi, Regjionet etnografike të Kosovës, Gjurmime albanologjike, folklori-etnologji, nr.3 Prishtinë, 1976, f.12.

⁹³ Fazli Hajrizi, Drenica dhe Lutanët e Turiçevcit, Mitrovicë, 2016.

⁹⁴ Rexhep Doci, Onamistika Drenicës - I, Prishinë, 2005, f.209-225.

përshtatshme, kullotat përkatësisht relievi kodrinor-malor, uji etj.⁹⁵ Mendim tjetër, që na del më bindës është ai i historianit Hamdi Thaçi, i cili emrin e Drenicës e lidh me Drinica apo Drinisa, emrin që e ka ruajtur lumi Drenica si degë e Drinit.⁹⁶

Rreth 107 fshatra paraqesin një territor kompakt, si një tërësi gjeografike, kurse në pikëpamje administrative Drenica është copëtuar edhe sot në disa qendra komunale.⁹⁷

Sipas ndarjes administrative zona e Drenicës ndahet në dy qendra administrative, në atë të Skënderajt me 53 fshatra dhe atë të Drenasit të Ri me 38 fshatra. Drenica posedon një sipërfaqe prej rreth 665 km². Kjo krahinë ka qenë vazhdimisht burim frymëzimi për të gjithë popullin shqiptar, në luftën e tij për liri.

Ritet e dasmës tradicionale shqiptare në Drenicë të Kosovës, si pjesë e pandashme e kulturës popullore shqiptare kanë qenë dhe mbeten shprehje e pastër e kënaqësisë së një populli, tregues i drejtpërdrejt i mbijetesës së kësaj kulture nëpër shekuj, e ruajtur me xhelozë nga banorët e rajonit të Drenicës.

Martesa është njohja ligjore apo kanunore e një marrëdhënie bashkëshortore. Është nyja midis gjendjes paramartësore dhe asaj pasmartësore, ku në prani të bashkësisë familjare, familjes, fisit dhe miqve zyrtarizohet një marrëdhënie e çiftit, që është një moment gëzimi dhe hareje në shtëpinë e djalit.

Martesa është faza e dytë shoqërore e jetës, pas lindjes dhe akti më i vetëdijshëm dhe me i përjetuar nga rrethi familjar dhe shoqëror.

⁹⁵ Memet Rukiqi, Krijues dhe bartës të tregimeve popullore në Drenicë, Prishtinë, 1998, fq.22.

⁹⁶ Hamdi Thaçi, Drenica epiqender e Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare, Prishtinë, 2016, fq.32.

⁹⁷ Bedri Tahiri, Kamer e Murat Loshi, sh.b. 'Lena Graphic Dising', Prishtinë, 2019, fq.17.

Dasma ka karakter historik, pasi ndjek hap pas hapi ndryshimet e jetës shoqërore dhe cilësohet si një nga ngjarjet më të rëndësishme të jetës së njeriut.

Martesa si kontratë i ka rrënjët në të drejtën romake dhe ka qenë e sanksionuar shprehimisht me legjislacion fetar.⁹⁸

Në realitet martesa nuk është vetëm një lidhje vetëm në mes dy personave, por edhe mes dy familjeve dhe për këtë arsye gjithnjë i është kushtuar shumë rëndësi se në çfarë familje do të shkojë vajza dhe cila do të jetë e zgjedhura e familjes që marton djalin.

Martesa, pra si ngjarje e rëndësishme në jetën e njeriut është baza e krijimit të familjes, si të jenë parimet dhe motivet e saj, ashtu do të jetë marrëdhënia familjare e saj në përgjithësi.⁹⁹

Dasma është festa më e madhe familjare që kremton populli ynë, që i kushton mjaft nga ana ekonomike. Por populli thotë: "Njëhere martohet njeriu".

Shoqëria jonë njihet si një shoqëri konservatore, që ka kultivuar vlerat e veta morale, fetare, fisnike, edukative e përgjithësisht humane. Por pavarësisht epiteteve, dasma në Drenicë të Kosovës mbetet njëra prej krenarive më të mëdha në këtë rajon, edhe pse në pjesën më të madhe të rasteve ka humbur origjinalitetin e saj, duke u njehsuar me ceremonitë e zhvilluara, kudo në Kosovë.

Sipas Kanunit të Leke Dukagjinit martesa ndikon në shtimin e familjes dhe forcimin e ekonomisë. "Me u martu me kanun do me

⁹⁸ Legjislacioni kishtar, Codex turis kannisi, Canon 36.

⁹⁹ Yllka Selimi, Jeta familjare, Akademija e shkencave, Institutii i Kulturës Popullore, Tiranë, 2007, f.77.

thënë mu ba shpi, me ja shtu shpis një rob ma tepër, sa për krahë të punëve, sa për të shtume të fëmive.¹⁰⁰

Fejesa dhe ceremonia e dasmës ne Drenicë

Paradasma

Në të kaluarën i pari i shtëpisë preokupohej për të ardhmen e fëmijëve të vet që në moshën e tyre fëmijërore, prandaj edhe lindi si fenomen institucioni i fejesës si një marrëveshje paraprake.

Sipas kanunit, me u feju d.m.th kur dy shpi i kanë dhanë fjalën njaja-tjetrës, me anë te shkusit, për me ba miq, kur njana palë premtton me i dhan çiken palës tjetër për me u martu me vone.¹⁰¹

Në rajonin e Drenicës fejesat bëheshim me shkuesi, ku më vone fillojnë diskutimet në familje dhe merrej edhe mendimi i dajallarëve, xhaxhallarëve dhe në fund merrej një vendim. Baba i vajzës mbledhte njerëzit e tij për të diskutuar për këtë punë ku atyre ju bënte një nder dhe respekt.¹⁰²

Pasi kërkuesi shkonte të babai i vajzës dhe ju drejtohej në emër të Zotit, familja e vajzës duhej të kthente një përgjigje pas disa ditëve.

Kur familja e vajzës nuk pranonte miqësi me atë që e kërkonte për nuse, zakonisht kthente një përgjigje diplomatike, si për shembull "E kemi të re vajzën e nuk e ka ende kohën për martesë", ose "E kemi në fjalë në vend tjetër dhe jemi duke pyetur".

¹⁰⁰ Shtjefën Gjeçovi, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Lezhë 1998, Kuvendi, kreu II Nye 11, fq.10.

¹⁰¹ Krenar Doli, Dasma në qytetin e Gjakovës, Prishtinë, 2015, f.41.

¹⁰² Faredin Tafallari, Fat Lumbardhi dhe Struzha e tij, Tiranë, 2008, sh.b. Klean, fq..31.

Edhe në rajonin e Drenicës, sikurse edhe gjetiu ekzistonin katër lloje të fejesave: fejesë me shkuesi, fejesë me grabitje, fejesë me shkëmbim të vajzave dhe fejesë me të folur ballë për ballë.¹⁰³

Fejesa me shkuesi, ndodhte kur një person i caktuar me besim të plotë nga dy familjet ndërmjetësonte për lidhje miqësie si mënyrë e fejesës që vazhdon të zbatohet pjesërisht edhe sot. Burri zakonisht bën propozimin e familjes së djalit, pastaj aprovohet dhe kalon në mes të burrave të shtëpisë, pasi fjala e burrit kishte tjetër peshë.

Fejesa me grabitje ndodhte kur familjet për shumë arsye nuk binin dakord për lidhje miqësie ose krushqie. Në këtë rast grabitej vajza dhe kjo bëhej kur familja e vajzës nuk pranonte që vajza e tyre të fejohej për djalin e një familje të caktuar.

Fejesa me shkëmbim të vajzave bëhej duke e dhënë vajzën dhe në vend të saj nga familja e djalit merrej nuse për djalin nga familja e vajzës. Kjo bëhej për me shumë për të mos paguar asnjëra palë.

Fejesa me të folur ballë për ballë bëhej jo në shtëpinë e vajzës por në një shtëpi tjetër apo në ndonjë vend tjetër jashtë shtëpisë. Kur dy baballarë janë miq ose të njohur të afërm për të ruajtur respektin për njëri tjetrin lidhin miqësi.

Fejesa nuk ka vade ose kohë, ajo zgjat sa e shohin të udhës dy palët, thuhet në kanun. Shpesh përdoret shprehja për të marrë vajzë pyet një herë për të, pastaj të afërmit e vajzës apo të djalit niseshin nga parimi për të zgjedhur shtëpi me emër të mirë.¹⁰⁴

Parapërgatitja për dasmën

¹⁰³ Kenar Doli, po aty, fq.42-43.

¹⁰⁴ Po aty, fq.45.

Pas fejesës së djalit, babai i të fejuarit pas një motmoti ose herë – herë edhe më herët apo edhe më vonë shkon të miku për të marrë masën ose pëlqimin që të bëhet dasma. Pas darke hapet biseda duke thënë "unë miku i mirë jam ardhë me ju vetë a muni me na dhanë qat rob sivjet, dhe pasi që i zoti i shtëpisë i përgjigjet se di çka me të thanë bre mik, pasojnë bisedat. Ka pasur raste kur që prej momentit kur prindërit e djalit kanë shprehur dëshirën që të behët martesa dhe derisa është dhënë pëlqimi kanë shkuar disa vite, por në fund mikut të ri i jepet peri dhe një jelek si masë, si shenjë që është dhënë pëlqimi¹⁰⁵. Ditën që bëhej prerja e rrobave, merr pjesë edhe babai i nuses ose dikush tjetër nga familja. Më parë babai i nuses zgjidhte dugajxhiun, kurse babai i dhëndrit paguante. Por tani kanë ndryshuar gjërat, kështu nga familja e vajzës fare nuk marrin pjesë, por nëse marrin pjesë nuk ndërhyjnë fare, prandaj edhe thonë se çka të bleni, bleni për shtëpi.¹⁰⁶.

Rrobat e blera dërgohen te rrobaqepësi për tu qepur, ku të dërguarit e rrobave bëjnë caktimin e datës së dasmës. Pasi hyjnë në shtëpinë e vajzës, babai i djalit këmben cigare me babanë e vajzës, pinë kafe dhe rrobat e gjësendet tregohen në praninë e të gjithëve. Babai i dhëndrit e nis bisedën me fjalët "Tash mik kemi qef me ditë vadën" dhe ia bën me dije se do të bëjë dasmë apo vetëm gazmend. Në dasmë thirret një rreth më i gjerë i njerëzve, ndërsa në gazmend thirret rrethi më i ngushtë, pastaj i tregon se me çka do ta merr nusen dhe me sa krushq.

Kthimin e njerëzve të tyre, njerëzit e shtëpisë e prisnin me padurim që tu kumtohej se kur është caktuar dita e dasmës.

Kanagjeqi- dita e parë e kanagjeqit karakterizohet me këto rite:

-Vaji i vajzës që shkon nuse,

¹⁰⁵ Bafti Krasniqi, Revista "Galloapi", nr. 6, 2010, fq.26.

¹⁰⁶ Po aty, f.26

-Qarja e bistekut dhe

-Vënia e kanës.

Ditën e tretë të kanagjeqit e karakterizojnë: shtrirja e pajës dhe lënia e shenjave të kujtimit. Në aspektin etno-social në të kaluarën vajzat e fejuara vetë e kanë përgatitur pajën, duke punuar gjësende tjera për tu dhuruar anëtarëve të familjes së burrit.¹⁰⁷ Sipas traditës qerija e nuses mbulohej me qilim të kuq, ndërsa arkat me pajën e nuses mbuloheshin me sixhade. Kur nusja arrin në shtëpinë e dhëndrit, një djalë të vogël 3-5 vjeç, me prindër të gjallë, e fusin nën duvakun e nuses me dëshirë që ajo të lindë djem.¹⁰⁸ Deri sa dëshira e femrës, por edhe e bashkëshortëve ishte lindja e meshkujve, sot te pjesa e madhe e prindërve është dëshira për të pasur fëmijë të gjinisë së kundërt.¹⁰⁹

Dasma fillonte të enjten he zgjaste deri të dielën, kurse të hënën hiqej duvaki nga një fëmijë i familjes ose farefisit. Pastaj fillojnë vallet e burrave, të kultivuara dhe zhvilluara në vendet rurale ku janë luajtur me shoqërim instrumental në përbërje të surleve dhe tupanëve. Por në rajonin e Drenicës për dallim nga krahinat tjera, kultivohej edhe folklori shqiptar me çifteli dhe violinë me këngëtarë të njohur që u këndonin heronjve tanë si Azem Bejtës, Hasan Prishtinës, Selman Kadrisë, Kadri Bistrices e shumë të tjerë që edukonin brezat e tërë në frymën kombëtare.

Ndërsa vallet e grave janë zhvilluar dhe kultivuar në vende rurale dhe janë shoqëruar tradicionalisht me përcjelljen e defave, këndim të këngëve dhe me të rrahur të shuplakave. Vallet e përziera janë zhvilluar dhe kultivuar kryesisht në vendet urbane, ku kanë dominuar emancipimi, civilizimi dhe arsimimi i popullatës. Vallet e

¹⁰⁷ Revista 'Sharri', nr-6-61, dhjetor-janar, 2009-2010, fq.39.

¹⁰⁸ Po aty, fq. 41.

¹⁰⁹ Po aty, f.30.

përziera shoqërohen kryesisht me formacione më të kompletura orkestrale.

Përfundimi

Në fund konsiderojmë se ritet e dasmës tradicionale në Drenicë nuk mund t'i shkëpusim nga ritet e dasmave tradicionale të krahinave tjera shqiptare, përkundër specifikave të ndryshme që ka nga e kaluara e saj.

Duke marrë parasysh se materiali i mbledhur i referohet periudhës së fillimit të shekullit XX e deri në ditët tona, jam munduar të nxjerrë në pah faktin se dasmat në Drenicë është tepër e pasur me rituale dhe këngë e valle.

Kënga e dasmës është pjesë e kulturës shpirtërore, ajo kryen funksionin praktik dhe simbolik.

Mbetemi të bindur se një studim i vetëm i çfarëdo lloji nuk mund t'i shtjellojë të gjitha çështjet e ngritura. Shpresojmë që studimi të mbetët i hapur për të vazhduar më tej nga studiuesit tjerë, të cilat do t'i paraqesin tezat e tyre dhe do të ndalën edhe në çështjet e tjera që nuk kanë qenë objekt i këtij studimi.

Bibliografia:

1. Doci, Rexhep. Onamistika e Drenicës, I, Prishinë, 2005;
2. Doli, Krenar. Dasma në qytetin e Gjakovës, Prishtinë, 2015;
3. Gjecovi, Shtejfen. Kanuni i Lekë Dukagjinit, Lezhë, 1998, Kuvendi, kreu II Nye 11;
4. Hajrizi, Fazli, Drenica dhe Lutanet e Turicevcit, Mitrovicë, 2016;

5. Krasniqi, Mark. Regjionet etnografike te Kosoves, Gjurmime albano-logjike, folklor-etnologji, nr.5, Prishtinë, 1976;
6. Revista "Gallapi", nr,6, 2010;
7. Revista arbëreshe "Katundi yne", nr.143, 2003;
8. Rukiqi, Mehmet. Krijues dhe bartës të tregimeve popullore në Drenicë, IAP, Prishtinë, 1998;
9. Tafallari, Faredin. "Fat Lumbardhi dhe Struzha tij", sh.b. Klean, Tiranë. 2008;
10. Tahiri, Bedri. "Kamer e Murat Loshi", sh.b, 'Lena Graphic Dising', Prishtinë, 2019;
11. Thaqi, Hamdi. "Drenica, epiqender e Levizjes Nacional Demokratike Shqiptare", Prishtinë, 2016;
12. Legjislacioni kishtar, Codex turis kannisi, Canon 36;
13. Selimi, Yllka. "Jeta familjare", Akademia e Shkencave - Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 2007;
14. Revista "Sharri", nr-6-61, dhjetor-janar, 2009-2010.

BESNIK RAMETI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore
të Shqiptarëve- Shkup*

RITET DHE CEREMONITË E DASMAVE NË RAÇE TË SHKUPIT

Fshati Raçe i takon krahinës së Dervenit të Shkupit, ndërsa sot është pjesë e territorit të Komunës së Sarajit. Ndodhet në veri-perëndim të Shkupit, në largësi prej 18km.¹¹⁰ Afër fshatit Raçe ndodhet mali Zheden, ku edhe buron burimi Dufla, ndërsa në fushën pjellore kalon lumi Vardar.¹¹¹

Fshati Raçe është vendbanim i lashtë, ndërsa për këtë dëshmojnë dy tumat e fshatit që janë gjurmë momentale që dëshmojnë ekzistimin e vendbanimit të lashtë.¹¹² Për lashtësinë flasin edhe shumë lokalitete arkeologjike të pazbuluara si në Hurdha, Kalanë e Shkozës te vendi i Kishës, etj. Sot fshati Raçe ka mbi 800 shtëpi dhe afër 4.000 banorë.

Dasma është një akt i rëndësishëm i jetës së njeriut, sepse lidhen familjet, bëhet shtimi i familjes dhe shoqërisë njerëzore.¹¹³ Martesa është një kusht i domosdoshëm për jetën e njeriut, pasi me anë të saj ai shton vazhdimësinë e jetës.¹¹⁴

Martesa e fëmijëve në Raçe të Dervenit të Shkupit, por edhe në të gjitha trevat shqiptare tradicionalisht ishte në duart e prindërve. Në çdo familje në fshatin Raçe por edhe në gjithë krahinën e Dervenit

¹¹⁰ Baki Bakiu, *Kujtime*, Shkup, 2018, f.7.

¹¹¹ Po aty.

¹¹² Abedin Krosi, *Gjurmët e të kaluarës shqiptare në Derven*, Shkup, 2005, f.11.

¹¹³ Nebi Dervishi, *Etnokultura e fushëgropës së Ohrit*, Tetovë, 2005, f.314.

¹¹⁴ Ibrahim Krosi, *Lirika popullore në Maqedoni*, Shkup, 1992, f.53.

të Shkupit, në të kaluarën djemtë dhe vajzat nuk e kishin asnjë të drejtë të zgjidhnin fatin e tyre.

Martesa e vajzave dhe djemve në fshatin Raçe, por edhe në Derven ka qenë për vajzat 17-22 vjet, ndërsa për djemtë 20-25 vjet.¹¹⁵

Dasmat në fshatin Raçe në të kaluarën kanë zgjatur një javë, ndërsa pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, diku kah vitet 1950 dasmat në Raçe dhe në Derven kanë filluar nga e mërkura dhe kanë përfunduar ditën e diel. Nusja është marrë ditën e diel për shkak se njerëzit kanë qenë të lirë dhe nuk kanë qenë në punë të shtetit¹¹⁶. Kjo traditë në fshatin Raçe ka zgjatur deri në vitin 2001, kur nga ky vit deri më sot kanë ndryshuar ditët, ndërsa faktor për këtë janë ardhja e gurbetçarëve që kanë afat të caktuar të pushimit dhe ditët e lira të restoranteve.¹¹⁷

Shkusi (Mesiti)

Në fejesën e dy të rinjve në Raçe të Shkupit rol të rëndësishëm kishte shkusi, të cilin e dërgonte babai i djalit për të kërkuar nga prindi dorën e vajzës. Shkusi kishte kujdes që vajza që e lypte mos të jetë gjak ose fis me djalin, sepse kjo në Raçe por edhe te të gjithë shqiptarët nuk lejohet.¹¹⁸ Shkusi është ndërmjetësuesi kryesor i cili merr përsipër për të kryer këtë punë, duke treguar të vërtetën dhe etikën e familjeve. Pasi pajtohet familja e vajzës shkusi merrte nishanin (çorapet) dhe i çonte tek familja e djalit, si

¹¹⁵ Nebi Dervishi, *vep e cit*, f.314.

¹¹⁶ Ibrahim Krosi, *Vep e cit*, f.62.

¹¹⁷ Për keto të dhëna na ka informuar edhe arsimtari Fari Rameti, i cili thotë se dasmat në Raçe më heret janë zhvilluar nga një javë, ndërsa më vonë kanë filluar nga e mërkura deri në të dielën, gjithashtu sot dasmat e kanë humbur traditën e vetë për shumë arsye të tjera.

¹¹⁸ Baki Bakiu, *Derveni i Shkupit ndër shekuj*, Shkup, 2011, f.130; Ibrahim Krosi, *Vep e cit*, f.54,55.

dëshmi se janë pajtuar për miqësi. Shkusi nga familja e djalit merrte edhe dhurata (myzhde) për punën e shkusllëkut.¹¹⁹

Fejesa

Në të kaluarën në fshatin Raçe fejesa ka qenë traditë, andaj kjo është edhe një akt i rëndësishëm familjar. Fejesa fillonte kur shkusi e sillte dhuratën (myzhden) në familjen e djalit, në atë moment fillon kënga me dahire (def) ku vajzat këndojnë. Në Raçe pas myzhdes disa ditë më vonë nga ana e djalit organizohet ceremonia e fejesës, ose bëjnë siç e quajnë në këtë rajon donom, ku nga ana e vajzës vijnë disa mysafirë, të afërmit e familjes (pesë deri në shtatë veta), ndërsa pak më vonë edhe nga ana e djalit të afërmit e familjes shkojnë një numër i caktuar ku çojnë nishanin dhe dhurata të tjera.¹²⁰

Pas kësaj pason periudha që quhet ndër-nishane, prej kur vajza bën përgatitjen e pajës së nusërisë apo çejzin për të shkuar nuse deri në ditën e dasmës.¹²¹

Vada (caktimi i kohës në mes dy familjeve për ditën e dasmës)

Vada është caktimi i i ditës së dasmës nga të dy anët e familjes, që njihet edhe si marrja e masës. Kjo kohë caktohet nga tre deri shtatë javë para dasmës, ku duhet të përgatiten fustanet e nusërisë.

¹¹⁹ Baki Bakiu, *Vep e cit*, f.130, Nebi Dervishi, *Vep e cit*, f.315; Ibrahim Krosi, *vep e cit*, f.55; Nga kujtimet e Shaban Rametit dhe Ajredin Rametit, të cilët na kanë treguar për rolin dhe rëndësinë që ka pasur shkuesi apo ndërmjetsuesi në të kaluarën në fshatin Raçe gjatë gjithë periudhës së shekullit XX, gjithëashtu periudha më e vështirë ka qenë e viteve 1950-1970, ku në fshatin tonë ishte problem martesë nga shpërngulja e madhe që shkonin për në Turqi dhe shumë njerëz u shpërngulnin edhe për martesë. Kjo ishte një pasojë e madhe për shtimin e popullatës në Raçe.

¹²⁰ Baki Bakiu, *vep e cit*, f.130,

¹²¹ Po aty, I.Krosi, *vep e cit*, f.55.

Caktimi i ditës së dasmës pritej me gëzim të madh nga ana e djalit, ndërsa vajzat nga ana e djalit këndojnë kenge për vadën si për shembull:

*Ori nause lule ori saj aspër
Ago baba te ka marur masën
Po këndon bilbili përmbaj mashën,
Ngrau oj nause epe masën
Ene epen masën me lule
Për taj ina najs oj fodulle.*¹²²

Gjithashtu këndohen edhe shumë këngë tjera për masën.

Ditët e dasmës në Raçe

Para se të fillojë dasma, dasmori fton familjen dhe të afërmit e familjes dhe farefisën, të cilët i njoftonte për ditën e dasmës dhe nga ata kërkonte angazhim për organizimin dhe realizimin e saj. Në këtë takim caktohej se kush do t'i ftojë mysafirët, në cilat shtëpi do të jenë odat, caktoheshin shërbyesit, caktohej kush do të bëjë biseda në oda, caktohej edhe pritja e mysafirëve. Gjithashtu në këtë takim caktohej kuzhinieri (asçaj) si dhe ndihmësi i tij. Nëpër kohë dasmat bëheshin me tupan dhe surle, të cilët ishin të pranishëm deri në përfundimin e dasmës.

Dasma në Raçe ka filluar ditën e mërkurë, ndërsa ajo natë njihet edhe si nata e kulaçit¹²³

Nata e kulaçit

Ditën e mërkurë tubohen të afërmit e familjes, vajza të reja për të zënë kulaçin. Ai zihet nga mbesa, nëse nuk ka mbesë, atëherë kjo

¹²² Baki Bakiu, *vep e cit*, 131 ; Merhide Kovaçi, 67 vjeçare e cila na e ka treguar këtë këngë gjithashtu edhe këngët tjera të cilat i kemi shkruar në këtë punim.

¹²³ Baki Bakiu, *vep e cit*, f.132-133; Ibrahim Krosi, *vep e cit*, f.56.

detyrë i jepet vajzës së xhaxhait ose ndonjë të afërmeje të dhëndrit. Vajza e cila do ta zë brumin e kulaçit e mbanë një monedhë të hekurt në gojë, si shenjë të mos flasë deri sa të thyhet kulaçi. Vajzat këndojnë këngë për kulaçtoren:

Ori kulaçtore ç'i lun me lira
Mo ma le kulaçin me bira
Mori kulaçtore ç'i lun me pare
T`na zoshë kulaçin oj qibare
Ori kulaçtore komet si pul
Mo ma le kulaçin brenda cull
Ori kulaçtore komet si lejlek
Mo ma le kulaëin brenda pa qek.

Pasi zihet kulaç i zoti i shtëpisë në ato moment kris me pushkë, shenjë kjo që tregon se dasma ka filluar dhe vajzat këndojnë këngën si vijon:

Ma e para pushkë që na krajsi,
Në zemër të babo derit batajsi
Ma e para pushkë ç'i na çiti tajm
*A e çite taj ore Ali trajm.*¹²⁴

Kurorëzimi ose niqahi i çiftit

Kurorëzimi ose niqahi në fshatin Raçe është një ceremoni fetare e çiftit para martesës. Kjo bëhet ditën e enjte dhe atë ditë dërgohen teshat e nusërisë (petkat), ndërsa ky organizim bëhet në shtëpinë e vajzës. Kurorëzimin e bën hoxha, i thirrur nga ana e vajzës, ndërsa gjatë vënies së kurorës nga të dy prindërit caktohet nga një dëshmitar ose veqil dhe nga dy zëvendës ose anëtarë.

¹²⁴ Po aty, f.61, Baki Bakiu, *vep e cit*, f.135.

Kurora ose niqahi bëhet me ari (lira). Së pari dëshmitari ose veqili i vajzës kërkon shumën e kërkuar, pastaj jep propozim edhe dëshmitari ose veqili i djalit, ndërsa ofertat dhe kërkesat nga të dy palët maksimalisht zgjasin tre herë. Te ne ka qenë e preferuar nga 9 deri 17 ari ose lira. Kurorëzimi sipas te drejtës islame bëhet për arsye të divorcit ose ndarjes dhe djali është i detyruar të paguajë për atë marrëveshje. Gjatë kësaj dite merren vesh për ardhjen e krushqive në ditën e dasmës dhe për çështje tjera.¹²⁵

Nata e dimive edhe e pulave

Nata e dimive në Raçe është organizuar ditën e premtë në mbremje. Në këtë natë janë tubuar të gjitha gratë, nusët e reja dhe vajzat. Nusët e reja këtë natë vishen me dimi të bardha, me jelekë të punuar me fije si të arrit dhe me këmisha të mëndafshita. Vendosi ari në qafë dhe në dorë, ndërsa vajzat i kanë kënduar me dahire (def) nusët e reja, të posamartuara, që kanë qenë të pranishme atë natë:

Kush e lunë vallen me mindil të bardhë

Nasja e Ali Agës ma e mira në mahalle

Kush e lunë vallen me mindil të kuqe

Nasja e Ali Agës ma e mira nder nuse

Në të njejtën natë më vonë vajzat e reja dalin në muhallë lipin pula ku këndojnë nëpër shpija si:

Hajde oj Hasiqe mere udhen

Hajt shkojm koshare ta zamë pulen

Nak pulen se do voje

Nak gjelin se do kendoje

¹²⁵ Ahmed Hoxha, ish-hoxhë i fshatit Raçe në Xhaminë e Epërme, i cili na ka njoftuar rreth niqahit ose kurorëzimit sipas rregullave të Islamit dhe si është respektuar nga çdo dasmor i Raçes; Baki Bakiu, *vep e cit*, f.133-134.

*Ene ket dahire na e sajdisë ta kthefshim
Ne donom te Hasonit frajk do ja bojm donomin
Do ja bojm donomin pa rena llafet e majra i kena.*¹²⁶

Pritja e mysafirve (odat) dhe nata e kanës

Pritja e mysafirëve bëhej ditën e shtunë në mbrëmje, kur fillojnë të mbushen odat. Oda të posaçme u caktoheshin dajallarëve, nipave, djemve të tezes, dajallarëve dhe prindit, nipave të prindërve, shokëve etj. Secila odë kishte nga 10 deri 15 veta dhe pjesëtarët e saj vinin me një shkop me pare, apo sillnin peshqesh për dasmorin.

Mëhalla ishte e detyruar t'i lëshojë odë mysafirëve. Ata që kanë qenë nga larg kanë bujtur me net. Pas ardhjes së odave, dasmori me një grup pleqsh dhe të rinjsh i vizitonin odat. Më vonë i dërgonin daulllexhinjtë dhe luanin valle në secilën odë. Dasmori therte një kafshë të madhe dhe i zë kuzhinierët për ta përgatitur ushqimin për të shtunën, por edhe për të dielën në mëngjes.¹²⁷

Gjatë natës së të shtunës, të afërmit e djalit shkojnë i marrin teshat dhe dhuratat të shtëpia e nuses.

Kjo natë është edhe “nata e kanës”, në të cilën shoqet dhe vajzat e reja nga ana e nuses e vendosin kanën. Shoqet e nuses e këndojnë me disa këngë si:

*Kaj moj shoqe me mindil në sy
Se sontë jemi mledhë për ty
Jemi mbledhë për ty me ngjitë kanën
Mer në gryk babën dhe nënën
Meri në gryk shkall për shkall
Se të kan çikë për mall*

¹²⁶ B.Bakui, *vep e cit.*, f.135-136; Fikrije Ismani dhe Resmije Kovaçi, kënduan këtë këngë në natën e dimijave.

¹²⁷ Informator: Nafi Kovaçi, 90 vjeçar; B.Bakui, *vep e cit.* f.136-137.

*Po ta ngjesim kanën pika pika
Taj do të jesh ma e majra ndër çika.*¹²⁸

Caktimi i krushqive dhe marrja e nuses

Të dielën, në ditën e dasmës përgatiten krushqit. Kur niseshin ecnin në rresht nga dy, kurse katër të parët ishin me flamuj (bajrakë). që zakonisht ishin më të afërmit e familjes, në të shumtën e rasteve dajallarët e nipat. Para flamurit vendoseshin dy burra të familjes më të vjetër, ndërsa pas flamujve radhiteshin njerëzit sipas moshës. Për kujdesin e krushqve nga dasmori ishte i caktuar çausi, i cili në krah mbante të lidhur një marhamë ose peshqir. Ndërsa tek gratë, për marrjen e nuses ishin caktuar inxhet (gra në moshë), të cilat shkonin për të marrë nusen me veturë.

Në Raçe ka qenë traditë që para krushqve të cakttoheshin të ashtuquajturit muskullçaj, që ishin dy të rinj, që kishin detyrë lajmërimin e palës së nuses se po vijnë krushqit dhe u jepnin dhuratë një palë çorape.

Krushqit priteshin nga prindi dhe të afërmit e familjes, ndërsa traditë ka qenë shërbimi i një cigareje ose një pije me një ëmbëlsirë.

Kur gjithçka ishte gati për të marrë nusen, krushqit kërkonin leje dhe përcilleshin nga prindi dhe të afërmit e familjes së nuses. Kur ktheheshin krushqit në shtëpinë e dhëndrit ndërronin rugën, ndërsa poashtu dy të rinj lajmëronin dhëndrin për kthimin e krushqve dhe rrjedhimisht edhe ardhjen e nuses. Edhe ata dy të rinj marrin dhuratë për dhënien e lajmit. Momenti më i gëzuar është kur në oborr vjen vetura e nuses, dhëndri del dhe hedh leblebia dhe bonbone mbi veturën dhe këndohet si vijon:

¹²⁸ Ibrahim Krosi, *vep e cit*, f.58; Këtë këngë e këndojnë edhe sot vajzat e SHKA "Duflla" Raçe.

*Oj nusja jon hin ka dera
Të mbulon Ali aga me sheqera
Oj nusja jon hin ka avlija
Te mbulon Ali aga me leblebija*

Ose:

*Na vajn nausja reth sokakit
Tjetër nur na i ra çardakit,
Vajn nausja reth avlijes
Tjeter nur o na i ra shtepies*¹²⁹

Nusen nga vetura e zbret babai i dhëndrit dhe ja vendosin këmbët në tepsi, e afrojnë një djalë të vogël, që është simbolikë që nusja të lind djalë dhe këndohen më shumë këngë të nusërisë.

Dhëndri përcillet deri te krushqit, siç thuhet del dhëndër para gjithë njerëzve dhe mysafirëve, daullexhinjtë i rrotullohen rreth e rrotull disa herë, deri sa t'i marrin të holla dhe në fund të gjithë mysafirët dhëndrit i urojnë martesën.

Pas kësaj ngjarje disa të rinj dalin në vrapim, kërcejnë me tre hapa dhe hedhin gurë. Të gjithë atyre që e merrnin vendin e parë u jepej nga një dhuratë, qoftë këmishë ose peshqir.

Në mbrëmje ftohet hoxha i fshatit dhe të afërmit e familjes së dhëndrit. Pasi hanë darkën, hoxha bën lutjen (duanë) dhe dhëndri është i detyruar tua marrë dorën hoxhës dhe babait, me vrap ik drejt dhomës te nusja, por disa të rinj tentojnë ta godasin me grusht nga shpina, që ishte simbolikë (adet) i martesës.¹³⁰

¹²⁹ I.Krosi, *vep e cit*, f.62; B.Bakui, *vep e cit*, f.137-138.

¹³⁰ Po aty.

RINI USEINI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore
të Shqiptarëve- Shkup*

VËSHTRIM ANTROPOLOGJIK I ÇËSHTJEVE EKONOMIKE TË DASMAVE BASHKËKOHORE SHQIPTARE

Ritualet janë pjesë e rëndësishme e kohezionit shoqëror. Ato shprehin lidhshmërinë në mes njerëzve të një përkatësie familjare, fisnore apo edhe kombëtare. Janë pikërisht ritualet të cilët e kanë mbajtur nën kontroll sistemin shoqëror.¹³¹

Sistemi shoqëror është i ndërtuar mbi bazat e përbashkëta jetësore, me elemente tradicionale, të cilat njeriut i japin përkatësinë e tij familjare, lokale apo edhe rajonale. Si i tillë njeriu ka nevojë t'i takojë shoqërisë që e rrethon duke iu bindur normave të pashkruara ku edhe vetë si individ ndikon për të krijuar ndryshime, të cilat vijnë si rezultat edhe i evolucionit njerëzor.¹³²

Durkheim ka argumentuar se nëpërmjet të ritualeve qofshin ato edhe me baza ekonomike njerëzit projektojnë rendin sociopolitik sekular në të cilin ato jetojnë, në një planifikim kosmologjik. Kjo tregon se nëpërmjet ritualeve njerëzit simbolizojnë sistemin e aprovuar social dhe atë pikërisht në relacionin mes individëve dhe grupeve.¹³³

¹³¹ David I. Kertzer, *Ritual, Politics and Power*, Yale University Press, Stable URL: <http://www.jstor.org/stable/j.ctt32brpc>

¹³² David I. Kertzer *Ritual, Politics, and Power*; Yale University Press, (September 1989) Stable URL: <http://www.jstor.org/stable/j.ctt32brpc>.

¹³³ Maurice Barres, *The rites of power*, 1902, f.181

Për ta shikuar se si ritualet janë pjesë e rëndësishme në jetën shoqërore të individit do të bazohemi kryesisht në dasmën shqiptare, praktikat e saj rituale edhe deri te shpenzimet e nevojshme që duhet të bëhen për to.

Dasmat shqiptare edhe pse u themi moderne përsëri kanë tendencë që në vetvete të kenë edhe norma të pashkruara të cilat në mënyrë indirekte vijnë nga një traditë që ka evoluar me shekuj, mbijetojat e së cilës ende janë të pranishme tek kujtimet e njerëzve. Ato jo vetëm që e ngrenë lart dinjitetin personal të njeriut por edhe më gjerësisht edhe të familjes dhe fisit përballë kontrollit shoqëror i cili edhe pse në modernitet ka metodat e veta të ndërhyrjes. Ndoshta askush nuk e di saktë se flet për norma që rrjedhin direkt nga përdorimi i hershem i rendit shoqëror të përcaktuar nga kanunet, por kjo fjalë është zëvendësuar me fjalën “*kështu e do rendi*” apo “*kështu e kemi traditë*”. Secili rajon në Maqedoni, tek shqiptaret, ka veçoritë e veta se si zbatohen disa gjëra, se si duhet të tregohen rendet para të tjerëve me qëllim që të tregohet edhe pozita e tyre në shoqëri.

Kjo tregon se edhe teoria e Durkheimit për kohezionin shoqëror mund të merret në konsideratë. Teoria që e parashtroi Durkheim mund të zhvillohet më shumë në këtë aspekt. Në të ai argumenton se praktikat rituale ekonomike gjenerojnë besueshmëri dhe përkatësi tek pjesëmarrësit duke i aktivizuar mekanizmat e shumëfishtë social psikologjik që krijojnë në mënyrë interaktive rezultatet karakteristike të ritualit. Posaçërisht elementet dalluese të praktikës rituale janë të shfaqura të shpërfaqin gjendje alternuese subjektive si dhe sjellje të plotësueshme dhe anomale.¹³⁴

Dasmat shqiptare sikurse edhe ceremoni të tjera apo rituale të jetës, karakterizohen nga tipare krahinore, tipare disa herë aq të ndrysh-

¹³⁴ Michael J. Kolb, Ritual Activity and Chiefly Economy at an Upland Religious Site on Maui, Hawaii'I, Journal of Field Archaeology, Vol. 21, No. 4 (Winter, 1994), pp. 417-436

me, saqë përbëjnë habi tek krushqit e tjerë. Por, martesat e të rinjve nga krahina të ndryshme si dhe lëvizjet e shumta të popullsisë kanë bërë që ritualet e tyre të afrohen gjithnjë e më tepër, të japin dhe të marrin. Porosia e “prindërve” se “vajza duhet të mësojë zakonet e shtëpisë së burrit që të mos turpërohet”, e kanë një fillesë që në mënyrën e nisjes së jetës së përbashkët bashkëshortore, madje, që kur nusja “bën këmbë”. Por, nga ana tjetër, shqiptarët që nuk janë karakterizuar si popull liberal në pranimin e zakoneve të mikut, gjithnjë e më tepër po e humbasin këtë tipar dhe po “tolerojnë” mes tyre. Zakoni i tjetrit gjithnjë e më pak shkakton rrudhje buzësh, e gjithnjë e më shumë, buzëqeshje e kureshti. Sepse, jemi më interesant duke qenë të ndryshëm dhe ia vlen të mbetemi të ndryshëm..

Nga sa kuptojmë nëse i vështrojmë këto qasje antropologjike edhe në aspektin ekonomik apo i kryqëzojmë njëra me tjetrën disa rituale ekonomike qofshin këto të vjetra apo tradicionale apo me të reja të shtresëzuara mbi të vjetrat kanë tendenca të thella ekonomike.¹³⁵ Së pari nëpërmjet dasmës tregohet edhe statusi dhe pozita ekonomike dhe sociale e familjes në shoqëri apo diçka e tillë edhe imponohet. Jo aq lehtë është e pranueshme një dasmë luksoze nga dikush që deri vonë ka qenë një njeri i thjeshtë dhe tashmë ka bërë një dasmë luksoze, për të flitet edhe në mënyrë pezhorative sepse ai nuk e ka menduar se çka do të ndodh nesër me jetën e tij, çka do të haj për dasmë. Varësisht nga krahina ku jeton çifti që do martohet harxhimet janë në vlera të ndryshme. Duke filluar nga martaesa apo dasma me niqa siç thuhet në popull e deri në ceremoninë e fundit të mbylljes së çiftit, çdo gjë ka çmimin e vetë. Këtu ka fitues dhe humbës, varësisht se si e sheh veten gjithkush. Por, këto fitues nga ana tjetër mund të jenë fitues moral por humbës ekonomik.

¹³⁵ Mary douglas, Baron Isherwood, The world of Goods, Basic Books, New York, 1979, f.18

Fitues moral ndihen zakonisht të zotët e dasmës, sepse ato kanë arritur që fëmijën e tyre ta shohin nuse apo dhëndër, ashtu siç e do zakoni edhe pse kostoja që është dashur për këtë gjë e nxjerr humbës moral. Fitues ekonomik nga ana tjetër janë të gjithë ato të cilët rreth dasmës kanë hapur shumë lloje të furnizimeve ceremoniale, si shërbimet hotelerie, shërbimet muzikore, shërbimet kozmetike dhe deri tek shërbimet e pastrimit. Ndonjëherë këto shërbime arrijnë që ta ndryshojnë krejt rrjedhën e pasqyrës së dasmës sepse me inovacionet e tyre ato bëhen më moderne dhe më interesante për konsumatorin i cili për të treguar vetveten i bënë të gjithë llojet e sakrificave personale, ekonomike dhe shoqërore.

Dasma ndoshta ka qene nxitëse e shumë të rinjve dhe burrave për të ndjekur edhe rrugën e kurbetit, për të hyrë në borxhe apo për të marrë kredi në shërbimet e ndryshme bankare. Pra, për të arritur qëllimin që dasma e fëmijës të jetë sa më e mirëqenë apo të paktën ti ketë dekorimet e një dasme janë detyruar që të shkojnë për disa muaj të punojnë jashtë shtetit dhe në këtë mënyrë duke marrë përvojë dhe duke parë leverdinë financiare që ka krijuar ky fitim një pjesë e këtyre personave kanë krijuar një jetë të tyren jashtë vendit dhe njëkohësisht duke e marrë me vete edhe familjen e tyre. Për të gjithë të tjerët zgjidhja ka qenë të marrin hua me ose pa kamatë, nga ndonjë i afërm, të cilën e kanë shlyer gjatë një pjese të mirë të jetës së tyre, dhe e cila ka krijuar edhe tensione ndër-familjare pasi kostot e mëdha kanë qenë të papërballueshme duke e ndërlidhur edhe me harxhimet mujore familjare. Së treti ofertat e shërbimeve të ndryshme bankare për kredi për banesë dhe për çiftet e reja i kanë futur brenda sistemit të tyre shumë çifte të reja, të cilët janë detyruar të marrin kredi në mënyrë që të dalin faqebardhë para të tjerëve.

Çështjet e kostove ekonomike të dasmës fillojnë që nga fejesa e çiftit, duke marrë parasysh që thuhet ne popull e do rendi të bëhen

disa harxhime. Tek shumica absolute e shqiptareve ne Maqedoni janë te pranishme blerjet e domosdoshme si disa fustane për nusen, nga 5 e sa me shume të jetë e mundshme, ari ku përfshihet unaza, byzyliku i dorës, vathet, qaforja por diku edhe më shumë. Shuma minimale këtu fillon nga 1000 e shkon deri mbi 10000 euro, është e preferuar zgjidhjen e arit ta beje nusja vete.

Paramendoni një nuse që do të jetë më luksozja. Pastaj vazhdojnë edhe dhuratat e familjes së djalit për nusen, të cilën kryesisht janë të dedikuara për nusen. Të gjithë këto realisht janë pasuri e nuses dhe është e drejta e saj t'i përdor si të dojë, t'i ruajë apo t'i harxhojë në ndihmë të familjes. Një përfitim tjetër i nuses është edhe e drejta e mehrit, apo martesë religjioze apo me niqah. Vlera e përfitimit te saj matet me euro ose me napolona ne varësi prej regjioneve te ndryshme. Një napolon ka vlerën e 250 euro dhe minimum shkohet në mbi 30 napolona, kjo kryesisht për krahinën e Shkupit dhe Tetovës, por edhe ne rajone të tjera. Kurse, në pjesën e Strugës, Dibrës atje ku zbatohet ky ligj shuma minimale është 3100 euro, e mund të arrijë në një shumë derisa të dakordohen të dy palët, si ajo e nuses ashtu edhe e dhëndrit.

Çështjet ekonomike të dasmave janë ndër aspektet që kanë një impakt në shumë studime të cilët mund të shihen nga një spektër më i gjerë, si nga ai psikologjik, social nga e drejta popullore dhe shumë çështje të tjera. Kjo është veç një vështrim përmbajtësor dhe kuptimor i asaj që ka efekt dasma në jetën e përditshme, në rregullimin dhe përmbysjen e rendit shoqëror me norma të pashkruara.

Bibliografi

1. David I. Kertzer, *Ritual, politics and Power*, Yale University Press, Stable URL: <http://www.jstor.org/stable/j.ctt32brpc>;
2. Muurice Barres, *The rites of power*, 1902;

3. Michael J. Kolb, *Ritual Activity and Chiefly Economy at an Upland Religious Site on Maui*, Hawai'i, Journal of Field Archaeology, Vol. 21, No. 4, 1994;
4. Mary Douglas, Baron Isherwood, *The world of Goods*, Basic Books, New York, 1979.

BEKIM RAMADANI

Universiteti i Tetovës

AHENGU I BRISHTË I DASMAVE TË SOTME SHQIPTARE

“Se çfarë niveli të qytetërimit ka arritur një popull duhet t’ia shikosh ceremonialin e dasmës dhe atë të vdekjes.”

Fjalë e urtë kineze

Dasma është një ngjarje e veçantë, si në kuptimin laik ashtu edhe në atë religjioz. Bashkëshortësia dhe krijimi i pasardhësve është nevojë thelbësore e çdo individi dhe një hap i madh në jetë. Në këtë drejtim, nuk është për t’u habitur që dita e dasmës festohet dhe përgatitet me kujdes. Vlen të festohet me njerëz të afërt dhe të krijojhet një atmosferë kremtimi dhe gëzimi ashtu që ky hap i rëndësishëm të jetë sa më i suksesshëm dhe sa më i frytshëm. Se sa e sa rrëfime të jashtëzakonshme, veçori kulturore dhe zakone specifike janë krijuar gjatë historisë për këtë akt ceremonial të martesës flasin libra, video dhe audio-incizime, gjurmë materiale dhe jomateriale, si dhe dëshmi të tjera të panumërta. Shumëkush nga ne nuk mund ta imagjinojë se sa e veçantë ka qenë në të kaluarën kjo ditë për familjet që thurnin miqësi dhe për çiftet e reja që datën e dasmës e caktonin sipas një marrëveshjeje të ndërsjellë. “Në kohën tonë, nga kërkesa të shumta për lokale dhe muzikantë, caktimi i datës së dasmës detyrohet nga këto dy mundësi: sipas orarit që caktojnë muzikantët dhe pronari i lokalit.” (Sopjani, 2011) Dasmat e ditëve tona bartin praktika të reja, të paarsyeshme dhe të pakuptueshme, duke i shkelur “për vdekje” vlerat tradicionale. P.sh. fustani i bardhë i cili që nga koha viktoriane ka simbolizuar pastërtinë

dhe virgjërinë, sot ka marrë forma, ngjyra e pamje të përcudnuara “me lloj-lloj zbukurimesh dhe modifikimesh: i shkurtër para - i gjatë pas, me një krah, me lule, me ngjyra, me fjongo në mes...” (Dasmat moderne, 2010). Me kalimin e kohës dhe mënyrën e re të të jetuarit, njerëzit e kanë ndryshuar edhe kuptimin për martesën dhe vetë aktin e dasmës. Në këtë orvatje studimore nuk dua që të flas as për ceremonialin e dasmës si eksperiencë jete apo si hallkë e zinxhirit shoqëror, as si ritual, si domosdoshmëri, si origjinë, si traditë dhe as si ngjarje, por vetëm si praktikë e cila kohëve të fundit ka pësuar shmangie nga parimet kombëtare, ikje nga ajo që deri vonë quhej pasuri e madhe e kulturës popullore.

* * * * *

Sipas shpjegimit të fjalorit të gjuhës së sotme shqipe dasma është festë që bëhet me rastin e martesës, e shoqëruar me një ceremoni të gëzueshme. Dasmë e madhe (e thjeshtë). Dita (java) e dasmës. Zakonet e dasmës. Këngë dasme. Ftesë dasme. I zoti i dasmës etj.

Nga pikëpamja sociolinguistike dasma është një ngjarje që shënon krijimin e një familjeje të re dhe njëkohësisht kjo shënon edhe ndarjen nga “qeliza mëmë” dhe zënie apo krijimin e një “qelize” të re, pra të një familjeje të re. Dhe dita e dasmës shënon simbolikisht ndarjen nga familja prindërore të çiftit dhe kjo te fjala dasëm shprehet me dasëm, ku **da** do të thotë ndarje dhe **sëm** (zëm) do të thotë zënie (Dalipaj, 2012). Te gegët, pra edhe në zonat ku jetojmë ne, përdoret fjala darsmë që sipas disave nënkupton bashkimin e dy shkurtesave të dy fjalëve dar (darkë) dhe sëm (zëm – zëmë) që shpjegohet si akti i shtrimit të darkës me rastin e asaj që është zënë, që është marrë, pra darkë me rastin e ardhjes së nuses.¹³⁶

¹³⁶ E pa vërtetuar nga pikëpamja shkencore.

Nuk është qëllimi që të merret përsipër shpjegimi i fjalës dasëm apo darsëm, por ky fakt përmendet që në fund të këtij shkrimi të bëhet një ndërlidhje me këtë sqarim.

Në pjesën më të madhe të trojeve ku flitet shqip, dasmat e ditëve tona bëhen nëpër restorante, ku paraprakisht realizohen edhe ceremonitë që i paraprijnë martesës si: prurja e dorës, fejesa, kanagjgjji, nata e fundit e beqarisë së dhëndrit, etj. Dasmat nëpër restorante kanë filluar të mbahen aty këtu në fundvitet e 70-ta të shek. XX nga një shtresë e zgjedhur e shoqërisë, për t'u përhapur së shpejti edhe mes njerëzish reformues, ndërkaq nga fundvitet e 90-ta ato marrin karakter masiv. Numri i madh i restoranteve të ngritura nëpër qendra urbane e periferike sidomos këto vitet e fundit është një dëshmi e fuqishme për braktisjen e skemës tradicionale të dasmës shqiptare. Duhet të jesh me fat nëse ftohesh në ndonjë dasmë "vakti", në ndonjë ceremoni martesore që do të zhvillohet në shtëpinë e pronarit, mes rapsodësh, pa altoparlantë, pa sintisajzerë, pa këngëtare, pa "tallava", në ndonjë dasmë ku së pari do të shtrohej darka e pastaj do të behej ahengu. Sot është e pamundur të jesh pjesëmarrës në një dasmë ku të ftuarit do të ishin njerëz të afërt, njerëz të një gjaku, të një fisi, mysafirë që e njohin mirë njëri-tjetrin. Sot nuk e ke fatin që ta ruash në kujtesë për një kohë pak më të gjatë dasmën e mikut, të flasësh me të tjerët për ndjesinë e këndshme, për lojërat e kapuçave, të filxhanëve, për muhabetet e pafundme të netëve të gjata, për respektin që të tjerët tregojnë ndaj teje duke ta dhënë herë pas here fjalën, duke ta ofruar surlexhiun aty afër e ti duke u bërë dëgjues i vëmendshëm i nibetit, apo duke dëgjuar ndonjë ezgi të interpretuar me kavallo, pastaj duke kërcyer vallen e Mehmetit, vallen e Rugovës, vallen e Karadakut, vallen e rëndë... Shumë rrallë ndodh që sot të takosh vajza që bëjnë aheng duke u rënë dajreve, të dëgjosh përjetimin e bijave që kanë kërcyer me ritmin e kësaj vegle muzikore membranofone. Sot nuk e ke

fatin që më në dasmën e shqiptarit të jesh shikues i mundjeve mes të rinjsh, i kërcimit me tre hapa, i vrapimit, i hedhjes së gurit, të jesh vështrues i gjyqtarit fisnik e të drejtë që ndan për fituesit para, këmisha, marama e çorape, të jesh pjesë e natyrës së bukur, të pastër, të virgjër mes njerëzish bujarë, të dashur, të urtë, të thjeshtë, të mrekullueshëm. Sot nuk mund të jesh më dëshmitar i një cikli ku dominon kombinimi i harmonishëm i të gjitha komponentëve përcjellëse si: masiviteti, dashamirësia, natyra optimiste, hareja, gëzimi dhe karakteri i theksuar sinkretik.

Në ditët tona, nëpër dasma ndodhin gjëra që nuk mund t'i shohësh as në ëndërr. Gjithçka bëhet vetëm për hir të publikut, asgjë për veten. Fjalja më e qarkullueshme nëpër familjet që përgatiten për martesën e të birit apo së bijës është: "Ta bëjmë dasmën si askush tjetër". Nga kjo ide nisin pastaj devijimet dhe shtrembërimet. Fillojnë shpenzimet marramendëse që nuk përkojnë me buxhetin real. Ftohen mysafirë shumë të largët vetëm pse ushtrojnë funksione publike e politike dhe anashkalohen njerëzit e trungut, të gjakut, të fisit. Kam parë që dhëndri pasi të përshëndetet me ndonjë të ftuar, kthen kokën dhe pyet të afërmit: kush ishte ky? Nusja bën harxhime të mëdha për t'u rregulluar në mënyrë që të mos duket vetvetja dhe kur e shohin të tjerët pyesin: kush është kjo? Në dasmat bashkëkohore çifti i ri nuk është i disponuar që t'i dëgjojë këshillat dhe propozimet e prindërve apo të atyre që gjatë jetës kanë mësuar jo vetëm nga gabimet e të tjerëve, por edhe nga gabimet e veta. Që nga përzgjedhja e restorantit dhe e bandës muzikore, e fotostudios, pastaj përpilimi i listës së të ftuarve, i menysë së ushqimit, i skenarit të dasmës e deri te fillimi i ahengut, çifti i ri përjeton një periudhë përpjekjesh, dilemash, ethesh, vështirësish dhe peripecish të shumta. Ata nuk duan që dasma e tyre të jetë e ngjashme me dasmat e tjera. Shpeshherë duan diçka që as vetë nuk e dinë, sepse nuk e bëjnë për vete, për shijen dhe qejfin e tyre, por

për të tjerët. Andaj nuk janë të rralla rastet kur drejtohen edhe te zyrat e specializuara për organizim manifestimesh, atje ku mendja të bëhet shoshë nga propozimet alla amerikane, alla italiane, alla turke, gjithçka përpos asgjë alla shqiptare. Jo rrallë ndodh që nusja me dhëndrin i presin vetë mysafirët te hyrja e restorantit ku mbeten me orë të tëra për t'i nderuar edhe të ftuarit që vonohen pa ndonjë arsye. Nuk janë të paktë ata që përkundër ftesës, nuk vijnë në dasmë dhe as që e konfirmojnë mosardhjen e tyre. Brenda lokalit ka nga ata që nuk janë të kënaqur me vendin ku janë ulur, kurse disa të tjerë as me njerëzit që i kanë në tavolinë. Dikujt i pengon kondicioneri, dikujt era e parfumit, dikujt tymi i duhanit, dikujt programi pa shije i bandës muzikore. Ka plot nga ata që mbajnë pambuk nëpër veshë, kurse ata që nuk janë përgatitur për t'u mbrojtur nga zhurma, fusin në veshët e tyre letra higjiene që i marrin nga tavolina. Buçet "tallavaja"! Saksofonisti është futur në mes të valles, kurse këngëtarja josh të pranishmit me miset e saj, andaj "vlon bakshishi", kurse herë pas herë dëgjoen thirrmat në formë refrenesh: "jasha", "digje", "kalle", "hopa", "zjarr"... me ç'rast vëmendja përqendrohet më shumë te ata që hedhin para pa kontroll sesa te personazhet kryesorë të mbrëmjes. Një fjalë e urtë thotë: "Kur dy vetë martohen, 200 të tjerë tërbohen". Teksti i këngëve zhvillohet sipas improvizimit momental, ndërkaq ritmi thuajse gjatë tërë mbrëmjes zhvillohet në 4/4 apo në 7/8. Kështu, pa ndonjë ndryshim thelbësor në rrjedhën e ceremonialit, kërcëhet deri në mesnatë kur është planifikuar darka që për pjesën më të madhe të të ftuarve konsiderohet e vonuar. Sapo të hahet ushqimi, boshatiset salla dhe mbeten vetëm ca familjarë që e shoqërojnë prerjen e tortës dhe hedhjen e kurorës me lule. Vijon vallja e pinguinëve, pajdushka dhe së fundi ndonjë valle orientale si didem, mezdeke apo çoçek.

Ka edhe të tilla dasma ku çifti i ri e përcakton edhe repertorin e formacionit muzikor apo "play listën" e DJ-it. Ka nga ata që në dasmën e tyre nuk duan të këndohet shqip. Këngët duhet të jenë kryesisht në gjuhën angleze, ndërkaq mund të shkojnë edhe disa italiane, spanjolle dhe latino-amerikane. Në ca dasma ka rastisur që të dominojnë pjesët e muzikës klasike, në ca të tjera "rockandrolli", në ca të tjera "hip-hopi", kurse në një dasmë shqiptare para disa muajsh më shumë u kënduan shlagerët dalmatinas (këngët e Misho Kovaçit dhe Oliver Dragojeviqit) se sa krijimet e bukura të thesarit të larmishëm shqiptar. Por edhe atëherë kur në dasmat shqiptare këndohet kryesisht shqip, vërehet insistimi i dasmorëve apo edhe i vet çiftit të ri që përmes urimesh të plotësohen dëshirat e të pranishmëve me ç'rast këngëtarët më shumë merren me lexim se sa me këndim. Në këto situata ndodh që brenda natës të këndohet me dhjetëra herë e njëjta këngë. Ndodh që gjatë ahengut mysafirët të kërkojnë edhe këngë epike, historike, pastaj balada, bile jo rrallë edhe këngë vaji. Imagjinoni se si në vrullin e gëzimit dhe të harresë duhet të dëgjosh "Këngën e Rexhës" apo "Këngën e Minires"! Në ca zona shqiptare dasma shërben si vend shumë i përshtatshëm për t'u bërë gara mes valltarëve që luajnë bukur e që insistojnë të jenë vazhdimisht në krye të valles. Ka edhe raste kur derisa gratë luajnë valle në mes të sallës, burrat e tyre me raki në dorë qëndrojnë ulur në dysheme mu afër skenës duke mos e larguar shikimin nga këngëtarja me famë e estradës shqiptare.

Nëse, "atmosfera tejet festive e një dasme zgjon tek secili dëshirën për të kënaqur vetveten, për të thyer monotoninë e ditëve të zakonshme dhe për të gëzuar së bashku me të afërmit e të njohurit", (Dibra, 2004, f. 3) kjo nuk i lejon askujt që të shkelë mbi normat etike, morale, tradicionale dhe etno-kulturore.

Përdhunimi i mendjes përmes pamjesh të huaja filmike ka sjellë deri te situata të palakmueshme ku të rinjtë duan ta bëjnë dasmën e

tyre si ata të Holivudit, si ata të pallateve mbretërore, si në Dubai, si në Tokio, si në Amsterdam, si në ëndrra. Dhe ja dasmat shqiptare në plazhe, në rërë, në anije, në tren. A nuk jemi të gjithë ne dëshmitarë të ardhjes së sa e sa nuseve shqiptare me helikopter. Të gjithë jemi të një zëri se ne shqiptarët e kemi shumë qejf qejfin, por të mos harrojmë se çdo gjë duhet bërë me karar, me shije, me kup-tim. Dasma bëhet për vete dhe jo për t'ua treguar të tjerëve. Nëse martohesh ti, përse duhet të çmendet njerëzia. Përse me javë të tëra duhet ta trazosh komshiun, lagjen, qytetin; përse të duhet gjithë ajo breshëri armësh; përse rrezikon jetën e atyre vajzave të ulura mbi veturat që lëvizin me shpejtësi, përse lejon që vozitësit t'u bien borive në mes të natës; përse do që nusja jote të mos prihet nga flamuri kombëtar, përse nuk lejon që në dasmën tënde të këndohet e të vallëzohet shqip; përse je larguar kaq shumë nga tradita...?

Nëse tradita nuk do të ringjallet pikësëpari në ngjarje të tilla të shënuara familjare, kremtime popullore a shëtitje turistike, në ditët e tjera ajo është në muze. (Dedaj, 2013)

Sado që neve të mos na pëlqejë mënyra e zhvillimit të ceremonialit të dasmës bashkëkohore, ajo ka evoluar përmes rrugësh e formash të ndryshme duke iu përgjigjur përmbajtjes së realitetit të ri sho-qëror. Një realitet i ri, por i hidhur është edhe zhvillimi i dasmës shqiptare në restorant ku përmes perdeshe të trasha ndahen gratë nga burrat, pra në njërën anë të lokalit vendosen meshkujt, ndërkaj në anën tjetër femrat, kurse mes tyre pëlhura e trashë prej mëndafshi ose roletat e improvizuara. Dasmori ka vendos që ta ndajë burrin nga gruaja, motrën nga vëllai, dhëndrin nga vjehrra, nipin nga gjyshja. Ky quhet aheng familjar, por dasmorët nuk guxojnë të ulen me familjarët e tyre. E njëjta bandë muzikore, brenda një lokali të njëjtë, në të njëjtën kohë duhet të krijojë dy shtimunge të ndryshme, këngë epike për burrat që rrinë ulur dhe

këngë lirike për gratë që vallëzojnë pa ndalur. Thjesht e pa-realizueshme...

Pra, në kuptimin muzikor brenda dasmës ndodhin larmi stileshe, mënyra të ndryshme interpretimi e ekzekutimi, struktura të larmishme ritmike e melodike, forma të ndryshme të shoqërimit të momenteve të veçanta të ceremonialit me mjete të ndryshme të shprehjes muzikore, të kombinuara, të huazuara apo të improvizuara.

Dasma shqiptare e ditëve tona nuk tingëllon shqip për faktin se gjuha muzikore që përbën tiparin themelor në folklorin muzikor, ka ndjekur rrugën e nënshtrimit duke mos u rezistuar fare ndikimeve të huaja. Kjo bie në sy përmes një sërë komponentësh që nuk janë karakteristike për muzikën shqiptare as në kuptimin e melodisë, as të modeve, as të larmisë ritmike, as të dinamikës, as të bashkëtingëltimeve polifonike, as të formacioneve instrumentale dhe as të timbrikës së tyre (Daja, 1980). Sot mungon bukuria e origjinalitetit të krijimit, e tingëllimit të pastër të gjuhës poetike-muzikore nëpërmjet interpretimit të natyrshëm, përmes interpretimit shqip.

Është e pakuptimtë të jesh kundër zhvillimeve bashkëkohore, kundër risive në jetën shoqërore, kundër përpjekjeve për kërkime të reja në fushën e artit, por të mos harrojmë se e reja nuk mund të qëndrojë e shkëputur nga konteksti, nga përvoja, nga rrethanat sociologjike, psikologjike, antropologjike dhe historike. “E reja duhet të ndërtohet mbi themelet e sigurta të së kaluarës”, thoshte kompozitori rus Igor Stravinski. Si mund të tingëllojë shqip një dasmë ku anashkalohen modet diatonike me karakteristika të minorit dhe maxhorit (duke krijuar kontraste të bukura emocionale brenda një kënge), minori natyral, modet pentatonike (karakteristike për këngët polifonike të krahinave të Jugut) jo rrallë me prirje drejt diatonikës, pastaj tipe të thjeshta të shkallëve kromatike e

kështu me radhë. Si mund të tingëllojë shqip dasma që anashkalon gjuhën muzikore shqiptare, stilin muzikor shqiptar.

Pjesa dërmuese e dasmave të sotme shqiptare nuk tingëllojnë shqip, nuk frymojnë shqip. A nuk do ta quanit banale shndërrimin e mikpritjes në xheloz, të gëzimit dhe harresës në eufori, të dëfrimit në marrëzi, të muzikës në neveri, të ushqimit në vrer e zi, të vetë dasmës në pakënaqësi!

Shumëkush mund të akuzojë për theksimin e këtyre elementëve shthurëse gjatë ceremonialit të dasmave shqiptare, por e vërteta është pikërisht kjo. “Jemi edukuar të flasim vetëm për të mirat e popullit, luftërat për liri, besën unike, folkun brilant. Pa dyshim që populli është gjenerues në vlerat e tij krijuese. Ama është po ai që në tranzicion ka krijuar një aheng skandaloz në dasma dhe ca rituale banale dasmorësh”. (Dedaj, 2013)

Duke u bazuar në sa u tha më sipër konsiderojmë se duhet një angazhim shumë i madh në ngritjen e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit të popullit shqiptar përmes formash të ndryshme. Duhet të përpilohen këshilla të drejta për një dasmë dinjitoze qoftë përmes manualësh, qoftë përmes broshurash, qoftë përmes librash të përgatitur nga sociologë, psikologë, ekonomistë, antropologë, etnologë e etnomuzikologë. Duhet që së paku një semestër t’u flitet absolventëve (që në fakt janë bashkëshortët e ardhshëm potencialë) për etikën dhe estetikën e ceremonialit të dasmës, për aspektet financiare të realizimit të saj. Shumë të dobishme do të ishin edhe debatet televizive që do t’i trajtonin të gjitha aspektet e zhvillimit të një dasme, pastaj realizime video-klipesh ku do të viheshin në pah të gjitha mangësitë dhe përparësitë e një dasme bashkëkohore. Përse të mos i sensibilizojmë të rinjtë për racionalitetin e shpenzimeve të tyre gjatë një dasme duke marrë për shembull studimin e bërë nga ekonomistët e njohur Andrew Francis dhe Hugo Mialon se “sa më e shtrenjtë të jetë martesë, aq më e shkurtër është bashkëjetesa” (Kuriozitet,

2018), një përfundim që do të ishte në kundërshtim me vet kuptimin dasmë për të cilin u dha sqarim në fillim të këtij shkrimi. Një hap i rëndësishëm për rikonceptimin e dasmës bashkëkohore do të ishte edhe ndihma e muziktarëve të shquar dhe krijuesve të njohur të muzikës shqiptare në realizimin e disa video-modeleve me muzikë të mirëfilltë, të përzgjedhur, me muzikë të bukur, sepse në fund të fundit “*E bukura do ta shpëtojë botën*” thoshte poeti i madh argjentinas Jorge Luis Borges.

Bibliografia:

Daja, F. (1980). Ceremoniali i dasmës në skenën e festivalit folklorik (1978). Probleme të zhvillimit të folklorit bashkëkohor, f. 135.

Dalipaj, A. (2012, 5 29). Eqerem Çabej shenjtori apo djalli i gjuhës shqipe. Gjetur në Studim etimologjik rreth shqipes: <http://paratethata.blogspot.com/2012/05/studim-etimologjik-rreth-shqipes.html>

Dasmat moderne. (2010, 9 17). Gjetur në Shqipëria.com: <https://www.shqiperia.com/Dasmat-moderne.8703/>

Dedaj, N. (2013, 8 18). Ahengu vulgar i dasmave. Gjetur në Shqip: <http://www.gazeta-shqip.com/2013/08/18/ahengu-vulgar-i-dasmave/>

Dibra, M. (2004). Ceremoniali i dasmës në qytetin e Shkodrës. Tiranë: Akademia e shkencave të Shqipërisë Instituti i kulturës popullore.

Kuriozitete. (2018, 12 4). Sa më e shtrenjtë dasma, aq më pak zgjat martesë! Gjetur në Direkt Lajme: <http://direktlajme.live/sa-me-e-shtrenjte-dasma-aq-me-pak-zgjat-martesa/>

Sopjani, I. (2011, 9 15). Martesat dikur dhe sot. (Islam Gjakova.net) Gjetur në <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=2865>

BOTUES:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

SCUPI, vëllimi 26 – 2019

Kryeredaktor: Dr. Sefer Tahiri
Përgjegjës i botimit: Dr. Sevdail Demiri
Redaktor teknik: Naser Fera

Shtypi: **xxxxxxx**
Tirazhi: 500 copë

Ky vëllim i ‘Scupi–t’ botohet me vendimin e Këshillit të
ITSHKSH–Shkup, nr. 0201-09/2, të datës 14.01.2019, Shkup.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

392.51(=18:497)(082)

DASMA në trevat shqiptare : (konferencë shkencore - 03.05.2019)
/ [kryeredaktor Sefer Tahiri]. - Shkup : Instituti i trashëgimisë
shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, 2019. - 192 стр. : илустр. ; 21
см. - (Biblioteka Scupi ; v 26)

Фусноти кон текстот. - Библиографија кон трудовите

ISBN 978-608-4653-97-4

а) Свадба - Обичаи - Албанци во Македонија - Зборници
COBISS.MK-ID 110889482